



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 492 Akti

Nr. 665 Vendimi  
Tiranë, më 25.5.2023

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Alma Faskaj</b>	Kryesuese
<b>Etleda Çiftja</b>	Relatore
<b>Suela Zhegu</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Resilda Bilaj, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datën 23.5.2023, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Elvana Çiçolli**, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet A, B, C, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisioneren Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Elvana Çiçolli dhe, pasi shqyrtoi çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, e cila në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Elvana Çiçolli është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Elvana Çiçolli, bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 15.6.2020 me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Suela Zhegu dhe Alma Faskaj.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (aktualisht Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin datë 22.6.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisioneren Alma Faskaj. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 8.7.2020, përmes postës elektronike<sup>1</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe mbi përbërjen e trupit gjykues, si dhe i kërkoi të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni gjithashtu i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
6. Trupi gjykues, me vendimin datë 2.5.2023, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Elvana Çiçolli, bazuar në relativimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, sipas ligjit nr. 84/2016 dhe të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta.
7. Në datën 3.5.2023, përmes postës elektronike<sup>2</sup>, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën jo më vonë se data 16.5.2023; (iii)

<sup>1</sup>Email datë 8.7.2020: “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

<sup>2</sup>Email datë 3.5.2023: “Komisioni – Njoftim mbi rezultatet e hetimit kryesisht mbi procesin tuaj të rivlerësimit”.

njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

8. Në datën 16.5.2023, subjekti paraqiti me anë të postës elektronike<sup>3</sup> dhe pranë Komisionit<sup>4</sup> pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues, bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht.

9. Më tej, Komisioni njoftoi subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike<sup>5</sup> se trupi gjykues me vendimin e datës 19.5.2023 vendosi ta ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në datën 23.5.2023, ora 10:00, bazuar në nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Kodin e Procedurave Administrative.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

10. Në datën 23.5.2023 u zhvillua seanca dëgjimore në prani të subjektit të rivlerësimit dhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht në seancë.

11. Relatorja e çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryera mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.

12. Znj. Elvana Çiçolli, pasi dëgjoi relacionin e paraqitur nga ana e relatores së çështjes, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.

13. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 23.5.2023, subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli kërkoi konfirmimin në detyrë.

14. Seanca dëgjimore e datës 23.5.2023 u ndërpre, për të rifilluar në datën 25.5.2023 për shpalljen e vendimit.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

15. Subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

## **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

16. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016.

17. Sipas krerëve IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) AKSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të

<sup>3</sup>Email datë 16.5.2023: "Shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit".

<sup>4</sup>Shpjegime me shkrim mbi rezultatet e hetimit (nr. \*\*\* prot., datë 16.5.2023, në Komision).

<sup>5</sup>Email datë 19.5.2023: "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore lidhur me procesin tuaj të rivlerësimit".

rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit; (iii) KLGJ-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

**18.** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>6</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

### **A/1. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja**

**19.** ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Elvana Çiçolli, e cila është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2006, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar.

**20.** Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave privatë për vitet 2006 – 2016 dhe në datën 26.1.2017, referuar ligjit nr. 84/2016, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë së rivlerësimit kalimtar *Vetting*. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar: (i) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklaram të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

### **A/2. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni**

**21.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting* 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI të viteve 2006 – 2016; (ç) provat shkrese/dokumentet e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh)

---

<sup>6</sup> “Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5 të nenit 179/b të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, ndërsa sipas nenit 4/2 të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore, që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezultojnë se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore; (e) deklaramet në seancë dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**22.** Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameteve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarameteve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesit.

### **Personat e lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit që janë hetuar**

**23.** Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon: A. Sh., ish-bashkëjetues (nëntor 2013 – maj 2016), konsiderohet person i lidhur; V. Sh., e bija e subjektit të rivlerësimit, konsiderohet person i lidhur.

### **Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur**

#### **1. Huapërdorje automjeti tip “Ford”, në pronësi të babait të subjektit P. Ç.**

**1.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Huapërdorje e përkohshme e pasurisë automjet tip “Ford Fiesta”, autoveturë me nr. shasië \*\*\*, vit prodhimi 2003, i regjistruar në DPSHTRR, me targë \*\*\*, pasuri e babait P. Ç.. Vlera: 0 (zero) lekë (pa kundërshpërblim), zotëroj 0%*”. Për vërtetimin e deklarametit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>7</sup>.

**1.2.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017 (të administruar dhe nga DPSHTRR-ja<sup>8</sup>), rezulton se shtetasi P. Ç./babai i subjektit me kontratën nr. \*\*\*, datë 11.2.2014, ka blerë nga shtetasi R. S. dhe A. B. automjetin tip “Ford Fiesta”, vit prodhimi 2003, me targë \*\*\*, me çmim blerjeje 2.700 euro. Në kontratë parashikohet se çmimi është likuiduar 100%. Më pas, rezulton se me prokurën nr. \*\*\*, datë 15.10.2016, shtetasi P. Ç. i ka dhënë të drejtë vajzës së tij/subjektit të rivlerësimit të përdorë për një periudhë kohe pa afat brenda dhe jashtë vendit automjetin e mësipërm<sup>9</sup>.

**1.3.** Për të shteruar çdo dyshim<sup>10</sup>, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1<sup>11</sup>, i kërkoi subjektit të deklarojë burimin e krijimit të kësaj pasurie nga babai i saj, si dhe të paraqesë dokumentacionin provues. Në përgjigje<sup>12</sup>, subjekti deklaroi se ky automjet është blerë me

<sup>7</sup> Prokurë e posaçme (për përdorim mjete) nr. \*\*\*, datë 15.10.2016; kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.2.2014.

<sup>8</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2023.

<sup>9</sup> Rezulton se shtetasi P. Ç. e ka shitur automjetin e mësipërm me kontratë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.1.2018, kundrejt vlerës 3.000 euro.

<sup>10</sup> Kolegji i Posaçëm i Apelimit, lidhur me trajtimin dhe përkufizimin e marrëdhënies së përdorimit, ka mbajtur qëndrimin se kjo marrëdhënie është e verifikueshme prej organeve të rivlerësimit në çdo drejtim që ato do e vlerësojnë të nevojshme dhe të arsyeshme rast pas rasti, por ajo nuk është një marrëdhënie e cila duhet të përkufizohet sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të së cilës subjekti i lind detyrimi i provimit të burimeve të ligjshme të krijimit prej zotëruesit të saj [vendimet nr. 7, datë 24.6.2020; nr. 24, datë 28.7.2021 (JR)].

<sup>11</sup> Email datë 15.12.2022.

<sup>12</sup> Përgjigje pyetjeve shtesë protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2023, në Komision.

kursimet dhe të ardhurat e familjes. Babai i saj ka filluar të punojë që në moshën 15-vjeçare dhe, pavarësisht të dhënave në regjistrat publikë, ka vijuar të punojë si shofer i makinerive të rënda (kamion, buldozer etj.), vijoi subjekti, dhe se nga periudha 2009 e në vijim, për shkak të kërkesave të punëdhënësit, ka qenë i detyruar që për shkak të nevojave ekonomike të kryejë dy punë shpërblymshme, të cilat nuk janë pasqyruar saktësisht në regjistrat publikë.

**1.4.** Komisioni, bazuar në vërtetimin e lëshuar nga DRSSH Vlorë<sup>13</sup>, konstaton se pagat e përfituara nga babai i subjektit të rivlerësimit gjatë periudhës 2008 – 2010 kanë qenë në një vlerë totale prej 398.537 lekësh<sup>14</sup>. Po kështu, Komisioni vëren se babai i subjektit ka përfituar ndër vite interesa nga depozitat e tij bankare, të krijuara që prej vitit 2002, me një vlerë totale prej 827.911 lekësh<sup>15</sup>, e mjaftueshme për blerjen e automjetit me vlerë 379.026 lekë (2.700 euro).

**1.5.** Sa më sipër, referuar situatës faktike dhe gjetjeve nga hetimi administrativ, nuk konstatohen apo krijohen dyshime për të drejta të tjera të subjektit të rivlerësimit, të ndryshme nga ajo e përdorimit. Si pasojë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin.

**1.6.** Gjithashtu, Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit R. S. dhe A. B. dhe nuk rezultoi të ishte në kushtet e konfliktit të interesit me këta shtetas<sup>16</sup>.

**1.7. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

## **2. Apartament 1+1 me qira në Tiranë**

**2.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Posedim të pasurisë me qira, një banesë 1+1 me adresë pallat pranë rezidencës “\*\*\*”, rruga “\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë, në bazë të kontratës datë 1.5.2016, me qiradhënësit z. D. G. (përfaqësuar nga z. M. G.). Vlera është 20.000 lekë në muaj (çmimi i qirasë). Zotëron 0%*”. Për vërtetimin e deklaramentit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>17</sup>.

**2.2.** Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti në deklaratën *Vetting* 2017, rezulton se ndërmjet subjektit dhe shtetasit D. G., të përfaqësuar nga shtetasi M. G., është lidhur kontrata e datës 1.5.2016 për dhënie me qira, në të cilën parashikohet se shtetasi D. G. i jep me qira subjektit apartamentin 1+1, me adresë “Pallat pranë rezidencës \*\*\*, Tiranë”, që është i mobiluar dhe ka si destinacion banimin, kundrejt çmimit 20.000 lekë/muaj. Në këtë kontratë parashikohet afati i kohëzgjatjes së kontratës për një periudhë prej 1 viti, nga data 1.5.2016 deri në datën 1.5.2017.

**2.3.** Gjithashtu, subjekti ka paraqitur kontratën e sipërmarrjes nr. \*\*\*, datë 15.10.2014, të lidhur ndërmjet shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. në cilësinë e sipërmarrësit dhe palës investitore, me shtetasin D. G. në cilësinë e propositësit, ku parashikohet se sipërmarrësi do të ndërtojë për

<sup>13</sup> Paraqitur nga subjekti në pyetësorin nr. 1.

<sup>14</sup> Përllogarit pagat neto sipas legjislacionit në fuqi të kohës.

<sup>15</sup> Të paraqitura të detajuara në aneksin nr. 1, faqja me emërtim “Gjendjet e llogarive bankare”.

<sup>16</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2023 e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2023 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>17</sup> Kontratë dhënieje me qira datë 1.5.2016, me palë qiradhënëse D. G. dhe palë qiramarrëse Elvana Çiçolli.

Ilogari të palës porositëse dy apartamente, konkretisht me sip. 84.13 m<sup>2</sup> dhe 61.05 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 55.100 euro<sup>18</sup>.

**2.4.** Nga informacioni i administruar nga UKT-ja<sup>19</sup> dhe FSHU-ja<sup>20</sup> nuk rezulton që në emër të subjektit të figurojë ndonjë kontratë furnizimi<sup>21</sup>.

**2.5.** Me anë të pyetësorit nr. 4<sup>22</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit të sqarojë mënyrën e pagesës së qirasë për apartamentin e mësipërm (pagesë *cash* në dorë apo në bankë), si dhe të shpjegojë se kush i paguante detyrimet e konsumit të energjisë elektrike dhe ujit të pijshëm, vënien në dispozicion të numrit të kontratës, duke specifikuar se në emër të kujt janë lidhur dhe të paraqesë librezat e energjisë dhe ujit apo çdo dokumentacion që provon konsumin mujor për periudhën 1.5.2016 – 31.12.2017.

**2.6.** Në përgjigje<sup>23</sup>, subjekti shpjegoi se objekti pallat ka qenë i paregjistruar pranë ZRPP-së, apartamentet dhe pronarët nuk kanë qenë të pajisur me kontrata individuale të konsumit të ujit të pijshëm dhe energjisë elektrike. Në dijeninë e saj dhe me sa i është shpjeguar në atë kohë, detyrimet faturoheshin në total aforfe në emër të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k. për të gjithë objektin. Për këtë arsye, me personin i cili arkëtonte qiranë (i afërm i z. D. G., i cili jetonte në Angli) kanë rënë dakord që t’i paguajë në dorë një vlerë të përafërt detyrimi për ujin e pijshëm dhe energjinë elektrike në masën 3.000 lekë/muaj, si dhe detyrimin mujor për qiranë në shumën 20.000 lekë. Kjo mënyrë shlyerjeje detyrimesh kushtëzohej nga fakti që porositësi banonte në Angli dhe nuk ishte dakord që të kryente pagesën nëpërmjet bankës. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës<sup>24</sup>.

**2.7.** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit D. G., M. G. dhe nga hetimi administrativ nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit<sup>25</sup>.

**2.8.** Më tej, Komisioni krahasoi çmimin e parashikuar në kontratë me çmimin referues të qirasë për efekt fiskal, sipas VKM-së nr. 469, datë 3.6.2015, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”<sup>26</sup> dhe rezultoi se vlera e qirasë e përlogaritur sipas këtij akti është 19.597 lekë/muaj, që është e përafërt me çmimin e paguar nga subjekti.

---

<sup>18</sup> Në përgjigje të pyetësorit standard, subjekti deklaroi se prej datës 1.6.2020 e në vijim jeton në të njëjtën banesë të marrë me qira në vitin 2016, në rrugën “\*\*\*”, në pallatin e ndërtuar nga “\*\*\*” sh.p.k., duke lidhur kontratë qiraje me përfaqësuesin e pronarit të apartamentit, z. M. G., si dhe sqaron se në këtë periudhë ka ndryshuar pronari nga z. D. G. tek z. A. L. Për vërtetimin e deklaramit subjekti ka paraqitur kopje të kontratës së qirasë së datës 1.6.2020 dhe fotokopje të kontratës për kalim të drejtash porosie dhe premtim shitjeje, nr. \*\*\* (numër rep. i padallueshëm qartësisht), datë 16.9.2019, midis z. D. G. dhe z. A. L..

<sup>19</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2020.

<sup>20</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2020.

<sup>21</sup> Ndërsa në emër të bashkëjetuesit të subjektit, shtetasit A. Sh., FSHU-ja informon se identifikohet një abonent me kontratë furnizimi nr. \*\*\*, të lidhur në datën 30.4.2010, në instancë në Vlorë. Nga sistemi i ASHK-së është administruar dokumentacioni i apartamentit në Vlorë në pronësi të bashkëjetuesit të subjektit, ku rezulton se këtë pasuri e ka blerë me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 3.6.2009.

<sup>22</sup> Email datë 5.4.2023.

<sup>23</sup> Email datë 20.4.2023.

<sup>24</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2023, e FSHU-së, bashkë me kërkesën e datës 12.4.2023 drejtuar OSHEE-së; kërkesë e datës 12.4.2023 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të UK-së, bashkë me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2023, të UKT-së.

<sup>25</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2023, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>26</sup> Në këtë VKM parashikohet se vlera minimale mujore për metër katror sipërfaqe ndërtese të dhënë me qira është e barabartë me 0.3 për qind të çmimit të shitjes së saj, e përcaktuar në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive”. Në rastin konkret, vlera e qirasë përlogaritët në këtë mënyrë 0,3% x (61,05 m<sup>2</sup> x 107.000 lekë) = 19.597 lekë/muaj.

**2.9.** Në vijim, Komisioni paraqiti në analizën financiare të vitit 2016 shumën e qirasë së paguar nga subjekti për periudhën 1.5.2016 – 31.12.2016, në vlerën totale 160.000 lekë.

**2.10.** Sa më sipër, Komisioni çmon se nuk krijohen dyshime për të drejta të tjera të subjektit, të ndryshme nga ajo e përdorimit.

**2.11. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se për këtë pasuri nuk konstatohen problematika lidhur me procesin e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016.

### **3. Llogari rrjedhëse e pagës pranë BKT-së**

**3.1.** Në deklaratën *Vetting* 2017, subjekti ka deklaruar: “*Llogari rrjedhëse e pagës pranë BKT-së, vlera është 274 lekë, zotëroj 100%*”. Si burim krijimi subjekti ka deklaruar pagën. Për vërtetimin e deklarimit subjekti ka paraqitur dokumentacionin ligjor provues<sup>27</sup>.

**3.2.** BKT-ja<sup>28</sup> konfirmon se subjekti ka llogari rrjedhëse në lekë pranë kësaj banke, e cila është çelur në datën 7.11.2014 dhe balanca e saj në datën 26.1.2017 ka qenë në vlerën 274 lekë.

**3.3.** Nga shqyrtimi i lëvizjeve rezulton se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat si gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**3.4. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin justifikues.

## **KONSTATIME TË TJERA PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT**

### **4. Adresat e banimit**

**4.1.** Komisioni shqyrtoi dhe hetoi deklaratimet e subjektit lidhur me adresat e banimit, me qëllim shuarjen e çdo dyshimi lidhur me të drejta të tjera reale mbi pasuritë e paluajtshme të deklaruara si banesë.

**4.2.** Lidhur me adresat e banimit të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore<sup>29</sup> dhe në përgjigje të pyetësorit standard<sup>30</sup>, nga hetimi administrativ rezultoi si më poshtë:

**4.3.** Lidhur me adresën e banimit gjatë periudhës tetor 2006 – korrik 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar me disa shoqe në një banesë me qira të ndodhur në një pallat në rrugën që lidh Rrugën e \*\*\* me Rrugën e \*\*\*<sup>31</sup>. Lidhur me këtë banesë nuk disponon dokumentacion, pasi aty ka banuar me disa shoqe të universitetit dhe nuk ka qenë e lidhur një kontratë formale qiraje, kjo dhe për shkak të faktit se ka pasur lëvizje të vazhdueshme të

<sup>27</sup> Verifikim i llogarisë nga BKT-ja në vlerën 274 lekë, në datën 23.1.2017.

<sup>28</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2020.

<sup>29</sup> Subjekti ka deklaruar këto adresa të gjendjes civile: (i) për periudhën 2006 – 2007, adresën: “lagjja “\*\*\*”, rruga “\*\*\*”, nr. \*\*\*, Vlorë”; (ii) për periudhën 2008 – 2016, adresën “lagjja “\*\*\*”, rruga “\*\*\*”, pallati \*\*\*, Vlorë”. Ndërsa si adresa banimi ka deklaruar: (i) për vitin 2006, adresën rruga “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Tiranë”; (ii) për periudhën 2007 – 2008 nuk ka deklaruar adresë banimi; (iii) për periudhën 2009 – 2015, adresën rruga “\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë”; (iv) për vitin 2016, adresën pallati pranë rezidencës “\*\*\*”, rruga “\*\*\*”, Tiranë”.

<sup>30</sup> Protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2020, lidhur me adresat e banimit subjekti ka deklaruar: (i) për periudhën tetor 2006 – korrik 2007 ka jetuar me disa shoqe në një banesë me qira të ndodhur në një pallat në rrugën që lidh Rrugën e \*\*\* me Rrugën e \*\*\*<sup>30</sup>; (ii) prej vitit 2007 (në të cilin është caktuar gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë) deri në nëntor 2013 ka jetuar së bashku me prindërit e saj në qytetin e Vlorës, konkretisht në vitin 2007, në banesën që ndodhet në lagjen “\*\*\*”, rruga “\*\*\*” nr. \*\*\*, Vlorë dhe prej vitit 2009 në banesën e ndodhur në rrugën “\*\*\*”, lagjja “\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Vlorë; (iii) për periudhën nëntor 2013 (datë në të cilën ka lindur vajzën V. Sh.) deri në maj 2016 ka jetuar së bashku me bashkëjetuesin, z. A. Sh., në adresën rruga “\*\*\*” përballë fondacionit “\*\*\*”, tashmë rruga “\*\*\*”; (iv) për periudhën maj 2016 – nëntor 2017 ka banuar në banesë me qira në \*\*\*, në rrugën “\*\*\*”, në pallatin e ndërtuar nga “\*\*\*” sh.p.k.

<sup>31</sup> Me shoqe të universitetit (E. D., E. M. dhe J. M.) dhe pagesa e saj me sa mban mend ka qenë 25.000 lekë/muaj.



vajzave me të cilat ka banuar. Gjithashtu, shpjegon se nuk mban mend se cila nga shoqet ka kontraktuar verbalisht me pronarët dhe nuk kujton emrat e tyre. Pagesa personale e subjektit ka qenë 5.000 lekë/muaj.

**4.4.** Komisioni vëren se subjekti ka banuar në këtë adresë përpara marrjes së emërimit në detyrë dhe se adresa e deklaruar në pyetësin standard përkon me atë të deklaruar në DIPP-të përkatëse<sup>32</sup>.

**4.5.** Lidhur me adresën e banimit gjatë periudhës 2007 – 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar së bashku me prindërit në qytetin e Vlorës, konkretisht në vitin 2007, në banesën që ndodhet në lagjen “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Vlorë. Për vërtetimin e deklarimit, subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 1<sup>33</sup> paraqiti dokumentacion provues<sup>34</sup>.

**4.6.** Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se sipas vërtetimit të pronësisë së datës 13.11.1992 dhe vërtetimit nga dokumenti hipotekor i ZRPP-së Vlorë të datës 20.1.2006, babai i subjektit të rivlerësimit P. Ç. figuron pronar i një shtëpie banimi të përbërë nga një dhomë, një kuzhinë, banjë, korridor, me sip. 28 m<sup>2</sup>, me adresë: Vlorë, lagjia “\*\*\*\*”. Më pas rezulton se ndërmjet shtetasit P. Ç., në cilësinë e pronarit të truallit dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, është lidhur aktmarrëveshja nr. \*\*\*, datë 23.10.2006<sup>35</sup>, ku parashikohet se shtetasi P. Ç. vë në dispozicion të palës sipërmarrëse pasurinë e mësipërme, me qëllim që mbi të dhe mbi një sipërfaqe tjetër sipërmarrësi të ndërtojë një objekt shumëkatësh kundrejt përfitimit të një apartamenti banimi<sup>36</sup> me sipërfaqe 75-80 m<sup>2</sup>.

**4.7.** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., administratorin/ortakun R. M. dhe ortakët E. M. dhe N. M.. Nga informacioni i administruar nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit<sup>37</sup>.

**4.8.** Sa më sipër, nuk konstatohet ndonjë rrethanë apo e dhënë që lidhet me gëzimin e ndonjë të drejte reale të subjektit mbi pasurinë e mësipërme.

**4.9.** Lidhur me adresën e banimit gjatë periudhës 2009 – nëntor 2013, subjekti ka deklaruar se prej vitit 2009, kur filloi ndërtimi i objektit sipas aktmarrëveshjes me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., së bashku me prindërit kanë jetuar në banesën e ndodhur në rrugën “\*\*\*\*”, lagjia “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, Vlorë, e blerë në atë kohë nga prindërit.

**4.10.** Referuar dokumentacionit të administruar nga sistemi elektronik i ASHK-së, të paraqitur edhe nga subjekti, rezulton se me kontratën e shitjes nr. \*\*\*, datë 27.11.2004, shtetasi P. Ç. ka blerë nga 9 bashkëpronarë të familjes \*\*\* një apartament banimi<sup>38</sup> 2+1, me sip. 63 m<sup>2</sup>, Vlorë, kundrejt çmimit 2.000.000 lekë. Në kontratë parashikohet që ky çmim është paguar jashtë zyrës noteriale.

<sup>32</sup> Nga verifikimi në *Google Maps*, rruga “\*\*\*\*” ndodhet midis Rrugës së \*\*\* dhe Rrugës së \*\*\*.

<sup>33</sup> *Email* i datës 5.1.2023.

<sup>34</sup> Praktika e kontratës së shitjes miratuar me vendim të Komitetit Ekzekutiv Pluralist të Qytetit nr. \*\*\*, datë 27.9.1991, vërtetim pronësie datë 20.1.2006 nga ana e ZVRPP-së Vlorë.

<sup>35</sup> Paraqitur nga subjekti në pyetësin standard.

<sup>36</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka deklaruar se objekti ka përfunduar dhe në dispozicion të prindërve të saj është vendosur një apartament me sip. 80 m<sup>2</sup>, por, për shkak të problematikës së ndërtimit të këtij objekti, konfliktit gjyqësor dhe mosrespektimit të lejes së ndërtimit nga ana e shoqërisë ndërtuese, ky objekt nuk rezulton të jetë regjistruar pranë ASHK-së Vlorë.

<sup>37</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>38</sup> Nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*.

**4.11.** Sa më lart, konstatohet se prindërit e subjektit e kanë blerë këtë pasuri, si dhe kanë paguar çmimin e blerjes në vitin 2004, vit në të cilin subjekti ende nuk ishte emëruar si gjyqtare<sup>39</sup> e, për rrjedhojë, nuk vërtetohet ndonjë lidhje e subjektit lidhur me të drejtën reale mbi këtë pasuri dhe me pagimin e çmimit të blerjes.

**4.12.** Lidhur me adresën e banimit gjatë periudhës nëntor 2013 – maj 2016, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka jetuar me bashkëjetuesin z. A. Sh. në adresën: rruga “\*\*\*\*”, përballë fondacionit “\*\*\*\*”, tashmë rruga “\*\*\*\*”.

**4.13.** Fillimisht, Komisioni konstatoi një mospërputhje të deklarimeve të subjektit lidhur me adresat ku ka banuar gjatë viteve 2009 – 2012. Konkretisht, në përgjigje të pyetësorit standard<sup>40</sup>, subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës gusht 2007 – nëntor 2013 ka banuar me prindërit në qytetin e Vlorës, ndërkohë që në DIPP-të e viteve 2009 – 2012 ka deklaruar si adresë banimi: rruga “\*\*\*\*”, \*\*\*, Tiranë. Subjekti i rivlerësimit e ka sqaruar paraprakisht këtë situatë po në përgjigje të pyetësorit standard, ku ka shpjeguar se në disa nga deklaratat e pasurisë ka pasqyruar si vendqëndrim tjetër adresën “\*\*\*\*”, \*\*\*, e cila është në pronësi të bashkëjetuesit A. Sh.. Gjithashtu, ka sqaruar se kjo banesë nuk është përdorur nga ana e saj, përveç periudhës së bashkëjetesës nëntor 2013 – maj 2016.

**4.14.** Në vijim, ka sqaruar se pasqyrimi i kësaj adrese në deklaratimet e mëparshme të pasurisë është bërë për dy arsye: (i) për shkak të përpjekjeve për t’u transferuar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, pasi ishte praktikë e të gjithë magistratëve të deklaronin një adresë në qytetin e Tiranës, në mënyrë që kërkesa e tyre (për transferim) të shihej me prioritet nga KLD-ja; (ii) për efekt të një adrese korrespondence alternative dhe komunikimi në qytetin e Tiranës, duke qenë se banonte dhe punonte në Vlorë. Gjithashtu, thekson se periudha e bashkëjetesës së saj me z. A. Sh. ka qenë nëntor 2013 – maj 2016.

**4.15.** Për të shteruar çdo dyshim lidhur me këtë pasuri, Komisioni hetoi lidhur me kohën dhe mënyrën e fitimit të pronësisë nga ana e bashkëjetuesit të subjektit dhe kohën e pagesës së çmimit të blerjes. Nga hetimi administrativ rezultoi se shtetasi A. Sh. e ka fituar këtë pasuri, si dhe ka paguar çmimin e blerjes së saj në vitin 2005, vit në të cilin subjekti ende nuk ishte emëruar si gjyqtare<sup>41</sup> e, për më tepër, ky shtetas ende nuk e kishte statusin e bashkëjetuesit të subjektit<sup>42</sup>. Gjithashtu, nga analiza financiare e kryer në paragrafët 11.2.7-11.2.8 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kryesisht, rezulton se bashkëjetuesi dhe prindërit e tij kanë pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e këtij apartamenti.

**4.16.** Adresa e banimit ku subjekti ka banuar me qira gjatë periudhës maj 2016 – nëntor 2017, në \*\*\*, në rrugën “\*\*\*\*”, në pallatin e ndërtuar nga “\*\*\*\*” sh.p.k., është trajtuar në pikën 2 të vendimit.

**4.17. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me adresat e banimit është i mbështetur në dokumentacionin justifikues; (ii) nuk konstatohen

---

<sup>39</sup> Nëntor 2007.

<sup>40</sup> Email datë 24.7.2020.

<sup>41</sup> Nëntor 2007.

<sup>42</sup> Nga dokumentacioni i administruar nga noter E. H., të paraqitur dhe nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 1, rezulton se me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*, datë 17.9.2005, shtetasi A. Sh. ka blerë nga shtetasi A. M. apartamentin me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me vendndodhje në \*\*\*, Tiranë, me sip. 120,69 m<sup>2</sup> kundrejt çmimit prej 4.225.000 lekësh, i paguar tërësisht nga shitësi jashtë zyrës noteriale. Sipas kartelës së pasurisë së paluajshme, ky apartament është regjistruar në ZVRPP, në datën 24.10.2005.

rrethana apo të dhëna që lidhen me gëzimin e ndonjë të drejte tjetër reale nga ajo e banimit mbi pasuritë e deklaruar si adresa banimi nga subjekti i rivlerësimit.

## **5. Administrimi i depozitës në emër të gjyshes V. M., pranë NBG Bank (sot ABI Bank), në vlerën 31.000 euro**

**5.1.** Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Administrim i depozitës në euro pranë NBG Bank, Vlorë, në emër të familjares V. M. (gjyshja), për shkak të largimit jashtë shtetit, në Greqi (administrimi nënkupton të drejtën për të kryer veprime të tërheqjes në këtë llogari të tipit “join” në emër dhe për llogari të pronares V. M.). Vlera: 31.000 euro.*

**5.2.** Në përgjigje të pyetësorit standard<sup>43</sup>, subjekti i rivlerësimit sqaron se fillimisht kjo shumë ka qenë e depozituar në bankë në Greqi<sup>44</sup> e, më pas, sipas deklarimeve të gjyshes, është depozituar pranë Alpha Bank dhe, më tej, në vitin 2009, pranë NBG Bank në degën Vlorë. Më tej, subjekti shpjegon se kjo depozitë është krijuar shumë kohë përpara se të fillonte detyrën dhe ka pasur si bazë të saj pensionin si minoritarë që përfitonin si gjyshja V. M. (me baba grek), ashtu dhe i ndjeri, gjyshi M. M., të cilët zgjodhën të përfshijnë në këtë depozitë emrin e subjektit dhe të shtetasës M. M. Xh. (vajza e tyre/tezja e subjektit)<sup>45</sup>.

**5.3.** Në vijim, subjekti i rivlerësimit sqaron se qëllimi i përfshirjes së emrit të saj në këtë depozitë ishte për përdorim në rast emergjence ose nevoje familjare dhe për shkak të besimit të plotë që kishin ata lidhur me mosabuzimin e këtyre fondeve nga ana e saj. Gjithashtu, shpjegon se kjo depozitë është mbyllur me vullnetin e gjyshes dhe shuma është përdorur për të ndihmuar anëtarët e tjerë të familjes dhe për rikonstruksionin e shtëpisë së vjetër ku jeton aktualisht. Për vërtetimin e deklarimeve ka paraqitur dokumentacionin provues nga NBG Bank<sup>46</sup>.

**5.4.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të administruar nga ABI Bank<sup>47</sup>, rezulton se subjekti dhe tezja e saj kanë qenë bashkëmbajtëse në llogarinë depozitë të shtetasës V. M..

**5.5.** Nga analizimi i lëvizjeve në llogari u konstatua se në datën 9.6.2009 është kryer një depozitim në vlerën 30.000 euro nga shtetasja M. Xh.<sup>48</sup> Më pas, në datën 10.6.2009, kjo shumë ka kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar dhe është maturuar në datën 10.6.2010 dhe në të njëjtën datë janë kredituar edhe interesat e fituar në vlerën neto prej 1.318 euro. Më tej janë kryer dy tërheqje nga ana e subjektit, konkretisht 10.000 euro në datën 15.6.2010 dhe 21.315 euro në datën 16.6.2010<sup>49</sup>. Vlera e mbetur prej 3,19 euro është mbajtur si komision bankar gjatë periudhës 2018 – 2019 dhe përfundimisht kjo llogari është mbyllur në datën 17.4.2019.

**5.6.** Referuar jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>50</sup>, Komisioni vëren se përdorimi i pasurisë nuk është një ndër marrëdhëniet juridike të parashikuara nga neni 32, pika

<sup>43</sup> Protokolluar me nr. \*\*\* prot., datë 24.7.2020, në përgjigje të pyetjes nr. 7.

<sup>44</sup> Subjekti ka shpjeguar se pas vdekjes së gjyshit të saj M. M., gjyshja V. M. u largua përkohësisht për të jetuar në Greqi tek i biri P. M., në qytetin \*\*\*.

<sup>45</sup> Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 25.2.2023, të shtetasës V. M..

<sup>46</sup> (i) Marrëveshje për depozitë me afat datë 9.6.2009; (ii) mandat depozitimi në NBG Bank, datë 9.6.2009; (iii) mandatpagesë (tërheqje) në NBG Bank, datë 15.6.2010; (iv) dokumentacion në gjuhën greke, në emër të gjyshes V. M.; (v) kontratë nr. \*\*\*, akt për depozitim trashëgimie datë 3.5.1999 (në greqisht dhe i përkthyer).

<sup>47</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2020.

<sup>48</sup> Referuar mandatin të depozitimit datë 9.6.2009, emri i depozituesit M. Xh..

<sup>49</sup> Konfirmuar nga ABI Bank me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.11.2022.

<sup>50</sup> Shtjelluar në vendimet e Kolegjit në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit Sh. K. (JR nr. 7/2020) dhe në çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit F. I. (JR 10/2022).

4 e ligjit nr. 84/2016, që krijon cilësinë e personit tjetër të lidhur (si dhurues, huadhënësit ose huamarrësit), të shtetases V. M., në emër të së cilës figuron e hapur llogaria. Megjithatë, referuar pikës 14<sup>51</sup> të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që parashikon se “persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror, si dhe nën dritën e detyrimeve që rrjedhin për institucionet e rivlerësimit për të hetuar për pasuritë në përdorim, sipas pikave 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, në drejtim të verifikimit të rrethanave që mund të ngrenë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, Komisioni me anë të pyetësorit nr. 2<sup>52</sup> dhe 4<sup>53</sup> i kërkoi subjektit që, ndër të tjera, të paraqesë dokumentacion për të provuar ekzistencën e këtyre fondeve në bankat në Greqi dhe në Alpha Bank, të paraqesë dokumentacion për të provuar të ardhurat e përfituara nga ana e gjyshes dhe të ndjerit gjyshit të saj nga pensioni në Greqi (për periudhën përpara vitit 2009), të paraqesë dokumentacion lidhur me deklarinimin se “shuma është përdorur për të ndihmuar anëtarët e tjerë të familjes dhe për rikonstruksionin e shtëpisë së vjetër ku aktualisht jeton”.

**5.7.** Lidhur me ekzistencën e këtyre fondeve në banka të tjera, në përgjigje të pyetësorëve nr. 2<sup>54</sup> dhe nr. 4<sup>55</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se pas bisedës me gjyshen dhe verifikimet në bankat e tjera rezultoi se kursimet e gjyshërve kanë qenë të depozituara në Raiffeisen Bank në vitet 2003, 2005 dhe 2006 dhe se referimi që gjyshja i kishte bërë fillimisht për Alpha Bank nuk ka qenë i saktë, për shkak të kohës së gjatë që ka kaluar dhe moshës së gjyshes. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti lëvizjet e llogarive bankare në emër të gjyshes pranë Raiffeisen Bank që nga viti 2005. Gjithashtu, shpjegon se një pjesë të kursimeve gjyshërit fillimisht i kanë pasur të depozituara në institucione bankare në Greqi, por nuk e kanë ruajtur dokumentacionin e plotë të depozitave dhe llogarive të tyre në shtetin grek dhe, duke qenë se gjyshi ka ndërruar jetë në vitin 2009, një pjesë e mirë e dokumentacionit në emrin e tij nuk është ruajtur nga familjarët e tjerë dhe nuk është menduar nga ana e tyre se mund të nevojitej në vijim. Nga kërkimet në shtëpi kanë mundur të gjejnë disa mandatpagesa origjinale, konkretisht një mandatar-këtimi pranë \*\*\*, datë 22.6.2001, në emër të gjyshit M. M.<sup>56</sup>.

**5.8.** Në vijim të analizimit të dokumentacionit të paraqitur, Komisioni vëren se gjyshja e subjektit ka pasur disa depozita në monedhën euro pranë Raiffeisen Bank, të cilat datojnë së paku që prej vitit 2005. Konkretisht, në datën 29.12.2006, vërehet maturimi i një depozite me vlerë 23.242 euro, e cila, pasi është shtuar me shumën prej 6.456 euro, të depozituar në vitin 2007<sup>57</sup>, ka kaluar për krijimin e një depozite të vetme. Pas maturimit të kësaj të fundit, në datën 9.10.2008, gjyshja e subjektit, shtetasja V. M., ka tërhequr nga llogaria një shumë prej 30.202 euro, pra rreth 8 muaj përpara kryerjes së depozitimit pranë NBG Bank, në datën 9.6.2009.

**5.9.** Sa më lart, Komisioni vëren se fondet e depozituara nga tezja e subjektit në llogarinë e gjyshes në NBG Bank në vitin 2009 (fondet objekt hetimi), janë tërhequr nga llogaria e gjyshes

---

<sup>51</sup> Ligji nr. 84/2016, neni 3: “14. Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.

<sup>52</sup> Email datë 22.2.2023.

<sup>53</sup> Email datë 5.4.2023.

<sup>54</sup> Email datë 3.3.2023.

<sup>55</sup> Email datë 20.4.2023.

<sup>56</sup> Faturë arkëtimi nga \*\*\*, M. M. i, datë 22.06.2001, përkthyer, noterizuar, si dhe origjinali.

<sup>57</sup> Gjyshja e subjektit ka depozituar 4.756 euro në datën 4.1.2007 dhe 1.700 euro në datën 13.7.2007, ndërsa në datën 13.2.2006 ka tërhequr 458.457 lekë nga dy depozita të maturuara në vitin 2005.

së subjektit pranë Raiffeisen Bank rreth 8 muaj përpara depozitimit në NBG Bank dhe pjesa më e madhe e tyre është krijuar të paktën që prej vitit 2005.

**5.10.** Lidhur me të ardhurat e gjyshit dhe të gjyshes, që kanë shërbyer si burim për krijimin e depozitës, konkretisht dokumentacionin lidhur me të ardhurat nga pensioni si minoritarë, fillimisht subjekti i rivlerësimit në përgjigje të pyetësorit nr. 2<sup>58</sup> shpjegon se gjyshërit nuk kanë ruajtur dokumentacion të plotë të depozitave dhe llogarive të tyre në shtetin grek, pasi, duke qenë pasuri familjare, nuk është menduar nga ana e tyre se ky dokumentacion mund të nevojitej në vijim. Më pas, në përgjigje të pyetësorit nr. 4<sup>59</sup>, shpjegon se gjyshërit kanë pasur kursime të jetës së tyre të përbashkët, të cilat u rritën në mënyrë të konsiderueshme për shkak të përfitimit të pensionit si minoritarë nga ana e tyre në masën 300-350 euro/muaj për secilin nga Instituti i Sigurimeve Agrare OGA, fakt që ka qenë i njohur publikisht dhe është bërë mediatik për shkak të ndërprerjes së tij në vitet 2012 – 2013. Në këtë periudhë, vijon shpjegimin subjekti, ky trajtim u ndërpre edhe për gjyshen (gjyshi tashmë kishte ndërruar jetë), pasi u vendos si kusht vendbanimi në Greqi për 40 vitet e fundit.

**5.11.** Në cilësinë e provës, në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4, subjekti paraqiti: (i) çek pagesë të pensionit OGA - Instituti i Sigurimeve Agrare, për vitet 2009 – 2011, për gjyshen V. M.<sup>60</sup>; (ii) artikull të publikuar në portalin “\*\*\*\*” të datës 1.9.2013, pasqyrohet se OGA ndërpret pensionet për 12.792 të pargjistruar dhe se OGA prej vitesh jep pensione 360 euro/muaj tek të gjithë ata persona që mbajnë statusin e “homogjenit”, d.m.th. që vërtetojnë ligjërisht se janë shtetas grekë ose me prejardhje greke; (iii) disa njoftime për gjyshen lidhur me taksa të një toke të trashëguar në shtetin grek prej babait të saj<sup>61</sup>; (iv) kopje të pasaportës së shtetases V. M. të lëshuar në datën 14.11.1995, në të cilën pasqyrohet dhënia e vizës greke për periudhat 25.9.96 – e palexueshme; 26.11.1997 – 26.11.1998; 11.9.1999 – e palexueshme; 31.12.2001 – 31.12.2002. Gjithashtu, subjekti shpjegoi se nuk mund të sigurojë dokumentacion shtesë, për shkak se të afërmit e saj në Greqi u është bërë me dije verbalisht se nuk mund të jepet informacion lidhur me të dhënat për llogari bankare për shkak të tejkalimit të afatit 10-vjeçar.

**5.12.** Lidhur me përdorimin e shumës 31.000 euro, në përgjigje të pyetësorëve nr. 2 dhe nr. 4, subjekti shpjegoi se gjyshja e saj është rikthyer nga Greqia në Shqipëri për të jetuar së bashku me familjen e dajës në qytetin e Vlorës, në vitin 2013 dhe kjo shumë është përdorur për të vijuar jetesën normale të familjes dhe për rikonstruksionin e shtëpisë së tyre. Më pas sqaron se nga ana e gjyshes dhe dajës i janë vendosur në dispozicion disa fatura të thjeshta të mbajtura me furnizuesit e lëndës së parë apo specialistëve që kanë bërë rregullimin e çatisë, dyerve, dritareve, tualetit etj., së bashku me foto të gjendjes së shtëpisë së gjyshes, me vendndodhje: lagjja “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, Vlorë, dokumente të cilat i paraqiti në Komision si dokumente provuese.

**5.13.** Gjithashtu, shpjegon se një pjesë e shumës së mësipërme është përdorur për të përballuar shpenzimet për ndërhyrjen dhe trajtimin e sëmundjes së bashkëshortes së dajës, znj. Dh. M., shpenzime të cilat janë kryer pranë Spitalit \*\*\* dhe për blerjen e medikamenteve në vlerë të konsiderueshme, trajtim i cili vijon. Përballimi i shpenzimeve prej kursimeve të gjyshërve, lidhet me gjendjen financiare të dajës, i cili së bashku me bashkëshorten kanë qenë pa punë

<sup>58</sup> Email datë 3.3.2023.

<sup>59</sup> Email datë 20.4.2023.

<sup>60</sup> Vërtetime origjinale pensioni për periudhën 2009 – 2011, të përkthyer nga përkthyes zyrtar.

<sup>61</sup> Dokumente në gjuhën greke 6 fletë, të cilat nuk janë në formën e kërkuar ligjore (me vule apostile, të përkthyer dhe të noterizuara).

për një periudhë të gjatë, vijoi subjekti. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti dokumentacion për të provuar shpenzimet pranë Spitalit \*\*\* dhe situatën e punësimit të dajës dhe bashkëshortes së tij<sup>62</sup>. Në vijim, sqaron se gjyshja dhe daja ka bërë me dije se një pjesë e këtyre kursimeve disponohet ende prej tyre në gjendje *cash* në vlerën 12.000 euro dhe nuk është depozituar nga ana e tyre në bankë për përballimin e nevojave të përditshme dhe për shkaqet e mësipërme.

**5.14.** Subjekti i rivlerësimit në shpjegimet e saj thekson se nuk ka pasur ndonjëherë të drejta përdorimi apo disponimi mbi këtë shumë dhe nga ana e saj janë kryer veprime vetëm me porosi të gjyshes. Për vërtetimin e këtij deklarimi ka paraqitur veprime të tjera të kryera nga ana e saj për llogari të gjyshes, të tilla si mandatpagesa e datës 16.8.2011 për procedurën e rivlerësimit të shtëpisë, ku pasqyrohet nënshkrimi i saj për llogari të gjyshes<sup>63</sup>.

**5.15.** Në përfundim, shpjegon se shpenzimet e saj janë përballuar personalisht dhe nuk ka përdorur apo disponuar kursimet e gjyshërve, duke sjellë në vëmendje se në gusht 2013 ka aplikuar për kredi pranë “Union Bank” në masën 500.000 lekë, për të përballuar shpenzimet e ardhjes në jetë të vajzës së saj.

**5.16.** Komisioni konstatoi se referuar dokumentacionit të paraqitur shpenzimet për rikonstrukcionin e shtëpisë dhe mjekimit arrinin një shumë totale rreth 12.060 euro<sup>64</sup>.

**5.17.** Më tej, sipas deklarimit të subjektit, rreth 12.000 euro të tjera janë mbajtur *cash* nga gjyshja dhe daja i saj për përballimin e shpenzimeve të mjekimit të bashkëshortes së dajës, për shkak të gjendjes financiare të familjes së dajës, për shkak se rezultoi se daja i subjektit është punësuar në datën 6.7.2021 me një pagë bruto prej 40.000 lekësh<sup>65</sup>, bashkëshortja e dajës prej vitit 2008 ka qenë pa punë<sup>66</sup> dhe se gjyshja e subjektit/shtetasja V. M. trajtohet me pension pleqërie, me masë mujore 24.260 lekë<sup>67</sup>.

**5.18.** Nga verifikimi në sistemin elektronik të ASHK-së, nuk figuroi ndonjë pasuri e paluajtshme në emër të shtetasës V. M.

**5.19.** Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime të tjera në lidhje me konstatimin se: *Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar në mënyrë të qartë përdorimin e shumës 31.315 euro të tërhequr nga llogaria bankare e shtetasës V. M. në vitin 2010.*

**5.20.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>68</sup>, subjekti i rivlerësimit sqaron se sikurse ka shpjeguar në pyetësorët nr. 2 dhe nr. 4, shuma prej 31.315 euro e tërhequr në vitin 2010 është

<sup>62</sup> Fatura tatimore shitjeje nga subjekti Spitali \*\*\* për periudhën 29.7.2015 – 2.2.2016 për shtetasen Dh. M.; karta e kimioterapisë e pacientit e Spitalit \*\*\*; librezë kontributësh për sigurim shoqëror dhe shëndetësor të shtetasës Dh. A.; librezë pune e shtetasës Dh. A.; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 6.4.2023, i subjektit “\*\*\*” sh.a; vërtetim page i DRT-së Vlorë nga sistemi elektronik për shtetasin P. M.; vërtetim për masë pensioni i datës 7.4.2023 për shtetasen V. M. nga sistemi elektronik.

<sup>63</sup> Formular aplikimi për vlerësimin e pasurisë së paluajtshme, faturë arkëtimi, datë 21.7.2011, mandatarëtim datë 16.8.2011. Në këtë të fundit pasqyrohet pagesa në emër të shtetasës V. M. me përshkrimin “ZVRPP Vlorë, Zyrat e Regjistrimit V, tatim nga rivlerësimi” dhe në emrin e klientit pasqyrohet shënimi: “Elvana Çiçolli, P. V. M.”.

<sup>64</sup> Shpenzime për rikonstrukcion në shumën 1.054.445 lekë (rreth 7.520 euro) dhe shpenzime për mjekimin në shumën 614.224 lekë (rreth 4.540 euro).

<sup>65</sup> Vërtetim “\*\*\*” sh.a. i datës 6.4.2023, sipas të cilit shtetasi P. M. është punësuar në këtë shoqëri që nga data 6.7.2021 me pagë bruto 40.000 lekë.

<sup>66</sup> Në dokumentin librezë pune pasqyrohet se shtetasja Dh. A. është larguar nga puna në datën 1.7.2008 nga subjekti Ujësjiellës \*\*\*.

<sup>67</sup> Vërtetim i ISSH-së datë 7.4.2023.

<sup>68</sup> Email datë 16.5.2023.

përdorur: (a) për rikonstrukcionin e shtëpisë së tyre (rregullimin e çatisë, dyerve, dritareve, tualetit etj.); (b) për përballimin e shpenzimeve të jetesës për nevojat e përditshme, pasi që pas vdekjes së gjyshit në vitin 2009 gjyshja e saj jeton me familjen e dajës P. M., e lidhur dhe me gjendjen financiare të familjes<sup>69</sup>; (c) për përballimin e shpenzimeve mjekësore për ndërhyrjen kirurgjikale dhe kurimin e trajtimin e sëmundjes së familjares së tyre<sup>70</sup>; (ç) shuma prej 12.000 euro disponohet ende prej tyre në gjendje *cash* për përballimin e nevojave të përditshme dhe, për këtë arsye, nuk është depozituar nga ana e tyre në bankë.

**5.21.** Në vijim, shpjegon se nuk rezulton asnjë e dhënë nga DIPP-të vjetore dhe nga hetimi administrativ që të ketë krijuar pasuri apo të ketë kryer shpenzime, të cilat mund të kenë pasur si burim krijimi të ardhurat nga kjo depozitë. Gjithashtu, shpjegon se ajo dhe personi i lidhur gjatë periudhës së deklarimit nuk ndodhen në kushtet e një marrëdhënieje dhurimi apo huaje me gjyshen e saj e, për rrjedhojë, gjyshja nuk mund të konsiderohet person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit.

**5.22.** Gjithashtu, pyetjes së vëzhguesit ndërkombëtar gjatë seancës dëgjimore se pse gjyshja e subjektit ia dha të drejtën e administrimit të kësaj depozite bankare subjektit dhe jo djalit të saj, që ishte edhe shumë më afër me të, subjekti, ndër të tjera, iu përgjigj se: *“Është pikërisht për shkak të kësaj mungese besimi tek djali i saj që gjyshja së pari ia ka kaluar të drejtën e përdorimit tezes dhe pastaj edhe subjektit[...]”*.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm**

**5.23.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklaratimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë:

**5.24.** Sa më lart, nga hetimi administrativ rezulton se: (i) subjekti e ka shpjeguar administrimin e shumës 31.000 euro në emër të gjyshes V. M. në DIPP-në e vitit 2010, vit në të cilin ka kryer tërheqjen; (ii) depozitimi nuk është kryer nga subjekti, por nga personi tjetër bashkëmbajtës i llogarisë (tezja e subjektit/vajza e titullarit të llogarisë); (iii) rreth 8 muaj përpara këtij depozitimi, gjyshja e subjektit (titullarja e llogarisë) e ka tërhequr këtë shumë nga depozita bankare pranë Raiffeisen Bank, të cilat datojnë që prej vitit 2005; (iv) subjekti e ka kryer tërheqjen e depozitës në një periudhë në të cilën tezja e subjektit/bashkëmbajtësja tjetër e llogarisë ishte larguar nga Shqipëria<sup>71</sup>; (v) gjyshërit e subjektit kanë përfituar pension si minoritarë në shtetin grek; (vi) nuk rezulton asnjë e dhënë e dalë gjatë deklaratimeve në deklaratat periodike dhe as nga shpjegimet gjatë hetimit administrativ se subjekti i rivlerësimit i ka përdorur shumat e tërhequra si burim krijimi për ndonjë pasuri apo për kryerjen e ndonjë shpenzimi në emër të saj.

<sup>69</sup> Subjekti deklaroi se prej vitit 2008 bashkëshortja e dajës ka qenë pa punë, daja P. M. është punësuar në datën 6.7.2021 me një pagë minimale, ndërsa gjyshja e saj përfiton një pension modest.

<sup>70</sup> Shpenzime për bashkëshorten e dajës, të kryera pranë Spitalit \*\*\* dhe, në vijim, për blerjen e medikamenteve në vlerë të konsiderueshme, në kushtet kur është ende duke u trajtuar.

<sup>71</sup> Referuar sistemit TIMS, rezulton se shtetasi Y. Xh. (bashkëshorti i shtetasës M. Xh.) ka dalë nga territori shqiptar në datën 25.3.2010 dhe është rikthyer në datën 5.7.2011 (për shtetasen M. Xh. të dhënat në sistemin TIMS nuk janë të plota).

**5.25.** Nga analizimi i këtyre rrethanave, Komisioni çmon se: (i) shuma 30.000 euro e depozituar nga tezja e subjektit në datën 9.6.2009 në NBG Bank nuk është pasuri e subjektit të rivlerësimit, por e shtetas V. M.; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur vetëm të drejtën për të kryer veprime në këtë depozitë; (iii) subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm arsyen e dhënies në administrim të llogarisë nga ana e gjyshes; (iv) subjekti ka dhënë shpjegime të mjaftueshme të bazuara në dokumentacionin justifikues për përdorimin e kësaj shume nga shtetasja V. M. dhe familjarët e saj.

**5.26. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm arsyet e të drejtës së administrimit dhe përdorimit të kësaj shume nga ana e gjyshes dhe familjarëve, si dhe se nuk konstatohen problematika lidhur me administrimin nga subjekti i rivlerësimit të shumës 31.000 euro në emër të shtetas V. M., që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

## **6. Administrimi i depozitave në emër të familjares M. Xh. (tezja e subjektit)**

**6.1.** Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: administrim të depozitës në euro dhe lekë pranë Tirana Bank, Vlorë, në emër të familjares M. Xh. (tezja) për shkak të largimit jashtë shtetit, në Norvegji (administrimi nënkupton të drejtën për të kryer veprime të tërheqjes në këtë llogari të tipit “*join*” në emër dhe për llogari të pronares M. Xh.). Vlera: 19.930 euro (llogaria e parë në vlerë 15.717 euro dhe llogaria e dytë në vlerë 4.209 euro).

**6.2.** Më pas, në përgjigje të pyetësorit standard<sup>72</sup>, subjekti ka deklaruar se tezja e saj, M. M. Xh., në mars 2010 është larguar për të jetuar jashtë shtetit, në \*\*\*, Norvegji, ku banon aktualisht edhe sot së bashku me bashkëshortin Y. Xh.. Në depozitat e saj bankare pranë Tirana Bank në lekë dhe euro, në vlerën totale 19.930 euro<sup>73</sup>, në të cilat ishin investuar kursimet e jetës, zgjodhi të përfshinte edhe emrin e saj. Në vijim, shpjegon se kjo depozitë është krijuar shumë kohë përpara se të fillonte detyrën dhe ka pasur si bazë të saj fitimet e krijuara nga puna në emigracion në Greqi, së bashku me bashkëshortin Y. Xh. dhe punën disavjeçare si person fizik “fotograf” në qytetin e Vlorës. Përfshirja e emrit të saj në këtë depozitë, shpjegon subjekti, ka qenë e tipit “*join*” dhe qëllimi ishte që në rast emergjence apo nevoje të familjarëve të kishte mundësi të kryejë veprime në këtë llogari dhe, për shkak të besimit të plotë që ata kishin, për mosabuzim të kësaj depozite nga ana e saj. Kjo depozitë, shpjegon subjekti, është mbyllur në bazë të vullnetit të tezes dhe bashkëshortit dhe shuma përkatëse u përdor për blerjen me kredi të një banese në \*\*\* të Norvegjisë, ku ata banojnë aktualisht. Për vërtetimin e këtij deklarimi subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin provues<sup>74</sup>.

**6.3.** Tirana Bank<sup>75</sup> konfirmon se subjekti ka pasur të drejtë veprimi në llogarinë në euro të shtetas M. Xh. që prej datës 23.5.2005<sup>76</sup>, pra që në kohën që ishte duke ndjekur Shkollën e Magjistraturës.

---

<sup>72</sup> Email 24.7.2020.

<sup>73</sup> Llogaria e parë në vlerën 15.717 euro dhe llogaria e dytë në vlerën 4.209 euro.

<sup>74</sup> Lëvizjet e llogarisë në euro të shtetas M. Xh. në Tirana Bank për periudhat 1.1. 2010 – 31.12.2010; 15.3.2010 – 7.3.2011; certifikatë depozite me afat në emër të shtetas M. Xh. për periudhën 30.9.2010 – 30.12.2010. Më tej, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, paraqiti deklaratën noteriale nr. \*\*\*, datë 27.7.2021, të shtetas M. Xh..

<sup>75</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 4.8.2020.

<sup>76</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 20.2.2023.



**6.4.** Komisioni analizoi llogaritë bankare të shtetases M. Xh.<sup>77</sup>, ku konstatoi se kjo shtetase ka kryer veprime të shumta në llogaritë e saj që nga viti 2005 deri në mars 2010<sup>78</sup>, të tilla si depozitime, tërheqje, transfertat në dalje dhe në hyrje, për/nga palë të treta. Përfundimisht, shtetasja M. Xh. e ka tërhequr shumën 11.604 euro nga llogaria e saj në datën 18.7.2013, shumë e cila, sipas deklaramentit të subjektit, është përdorur për blerjen e apartamentit në Norvegji nga ana e tezes dhe bashkëshortit të saj.

**6.5.** Nga këqyrja e llogarisë së shtetases M. Xh. rezulton se subjekti ka kryer këto veprime në rend kronologjik: (i) në datën 30.3.2010 ka tërhequr 930 euro; (ii) në datën 2.6.2010 ka tërhequr 2.000 euro; (iii) në datën 19.7.2010 ka depozituar 5.000 euro; (iv) në datën 30.9.2010 ka tërhequr 1.000 euro.

**6.6.** Komisioni me anë të pyetësorit nr. 2<sup>79</sup> i kërkoi subjektit të deklarojë burimin financiar të krijimit për shumën e depozituar prej 5.000 euro në datën 19.7.2010, të paraqesë dokumentacion lidhur me të ardhurat që kanë shërbyer si burim, si dhe të deklarojë destinacionin e përdorimit të shumave të tërhequra.

**6.7.** Në përgjigje<sup>80</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se të gjitha veprimet që ka kryer, janë urdhëruar dhe autorizuar nga teza e saj, nuk e kujton arsyen specifike të tërheqjes së shumave të lartpërmendura, por siguron se këto shuma janë tërhequr dhe dorëzuar menjëherë te familjarët sipas udhëzimeve të tezes për arsye shëndetësore, shpenzime udhëtimi apo detyrime financiare të mëparshme të tyre.

**6.8.** Lidhur me burimin e shumës së depozituar prej 5.000 euro, subjekti i rivlerësimit shpjegon se kjo vlerë është tërhequr nga ana e vjehrrit të tezes së saj, shtetasi S. Xh., në datën 19.7.2010. Kjo sasi me shumë mundësi është tërhequr në atë kohë për shkak të përgatitjeve të kryera prej tij (garanci bankare), për të kryer një udhëtim në shtetin italian tek djali i tij, A. Xh.. Subjekti paraqiti llogarinë bankare të shtetasit S. Xh., ku vërehet se në këtë llogari në datën 22.6.2010 janë transferuar 5.000 euro nga llogaria e shtetases M. Xh.. Kjo shumë është tërhequr në datën 19.7.2010, ora 11:49, nga shtetasi S. Xh. dhe, më tej, është depozituar nga subjekti në të njëjtën datë, ora 16:02, në llogarinë e shtetases M. Xh..

**6.9.** Komisioni, referuar pikës 14<sup>81</sup> të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që parashikon se persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, që rrjedh nga një interes pasuror, si dhe nën dritën e detyrimeve që rrjedhin për institucionet e rivlerësimit për të hetuar për pasuritë në përdorim, sipas pikave 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 e 45 të ligjit nr. 84/2016, në drejtim të verifikimit të rrethanave që mund të ngrenë dyshime për fshehjen apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive në përdorim të subjekteve të rivlerësimit, me anë të pyetësorit nr. 4 i kërkoi subjektit të paraqesë dokumentacion justifikues lidhur me: (i) të ardhurat e realizuara nga teza e saj, të cilat kanë shërbyer për depozitimet e kryera në Bankën e Tiranës gjatë periudhës që

<sup>77</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 10.11.2022.

<sup>78</sup> Periudhë në të cilën është larguar nga Shqipëria. Referuar sistemit TIMS, rezulton se shtetasi Y. Xh. (bashkëshorti i shtetases M. Xh.) ka dalë nga territori shqiptar në datën 25.3.2010 dhe rikthyer në datën 5.7.2011 (për znj. M. Xh. të dhënat në sistemin TIMS nuk janë të plota).

<sup>79</sup> Email datë 22.2.2023.

<sup>80</sup> Nr. \*\*\* prot., datën 3.3.2023.

<sup>81</sup> Ligji nr. 84/2016, neni 3: “14. Persona të tjerë të lidhur” janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi”.

subjekti ka qenë në detyrë, 17.1.2007 – 9.10.2009<sup>82</sup>; (ii) përdorimin e shumës 3.930 euro të tërhequr nga ana e saj; (ii) përdorimin e shumës së tërhequr nga tezja e saj në vitin 2013 për blerjen e shtëpisë në Norvegji (sipas deklaramit të saj).

**6.10.** Në përgjigje<sup>83</sup>, subjekti, pasi shpjegoi dhe një herë se tezja e saj në mars të vitit 2010 është larguar për të jetuar në Norvegji dhe se depozita e saj në shumën 19.930 euro është krijuar shumë kohë përpara se ajo të fillonte detyrën dhe emri i saj është në këtë depozitë të tipit “join”, me qëllim që në rast emergjence apo nevoje familjare të kishte mundësi të kryente veprime, sqaron se:

**6.11.** Për sa i përket të ardhurave të realizuara nga tezja e subjektit, të cilat kanë shërbyer si burim për depozitimet e kryera, subjekti shpjegoi se ato janë krijuar si rrjedhojë e punës së kryer prej saj dhe bashkëshortit Y. Xh. në emigracion në Greqi dhe se ky i fundit ka qenë i regjistruar si biznes i vogël me aktivitet në fushën e fotografisë në qytetin e Vlorës. Në lidhje me depozitimet e kryera nga ana e tezes së saj për periudhën e kërkuar (17.1.2007 – 9.10.2009), subjekti shpjegoi se mendon se ato kanë qenë të ardhurat e realizuara nga biznesi i lartpërmendur. Më tej, shpjegoi se referuar historikut të kësaj llogarie rezulton se ajo është hapur në datën 23.5.2005, me depozitimimin e shumës fillestare 4.000 euro. Pasi përshkruan historikun e depozitimeve dhe tërheqjeve, subjekti shpjegoi në mënyrë të përmbledhur se: (i) krijues të kësaj llogarie kanë qenë tezja dhe bashkëshorti i saj në vitin 2005, pra përpara fillimit të detyrës nga ana e saj; (ii) depozitimet dhe tërheqjet në llogaritë e tyre kanë qenë për shkak të aktivitetit biznes i vogël që ata kanë ushtruar në qytetin e Vlorës; (iii) kjo llogari është përdorur për të kryer veprime të ndryshme financiare me familjarë të tyre.

**6.12.** Në vijim, Komisioni analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, konkretisht vërtetimin nr. \*\*\* prot., datë 7.4.2023, të Bashkisë Vlorë, sipas të cilit personi fizik “Y. Xh.”, përveç taksave të biznesit, ka paguar tatim të thjeshtuar mbi biznesin, në vlerën 24.000 lekë për vitin 2007, në vlerën 43.000 lekë për vitin 2008 dhe në vlerën 43.000 lekë për vitin 2009.

**6.13.** Në kushtet kur mungon informacioni për shumën e të ardhurave të realizuara, Komisioni iu referua ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, ku në nenin 11, “Kategoritë e bazës dhe nivelet e taksës vendore mbi biznesin e vogël”, konkretisht në pikat 1 dhe 5 parashikohet se: *“1. Kategoritë minimale të bazës së taksës vendore mbi biznesin e vogël dhe nivelet treguese të taksës, për çdo kategori, jepen në aneksin 5, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij... 5. Këshilli bashkiak ose komunal vendos për nivelin e taksës, që do të zbatohet për çdo kategori minimale të bazës së taksës, të parashikuar në aneksin 5 të këtij ligji, në kufijtë plus 10/minus 30 për qind të nivelit tregues të taksës për kategorinë përkatëse dhe për çdo interval të qarkullimit, në përputhje me udhëzimet përkatëse”.*

**6.14.** Më tej, Komisioni analizoi të dhënat e pasqyruara në aneksin 5, me emërtim “Tabela e taksimit të subjekteve të biznesit të vogël”<sup>84</sup> dhe, duke u nisur nga vlera e tatimit të paguar, vërehet se ky subjekt është kategorizuar në nivelin e xhiros në fashën deri në 2.000.000 lekë, ndërsa për vitet 2008 dhe 2009 në fashën 2.000.000 lekë – 3.000.000 lekë.

<sup>82</sup> Datë 17.1.2007 – 2.000 euro; datë 26.1.2007 – 2.000 euro; datë 27.6.2007 – 5.000 euro; datë 27.8.2007 – 3.000 euro; datë 13.8.2008 – 3.000 euro; datë 15.8.2008 – 16 euro; datë 3.10.2008 – 3.000 euro; datë 21.1.2009 – 5.000 euro; datë 15.7.2009 – 3.004 euro; datë 9.10.2009 – 6.000 euro.

<sup>83</sup> Email datë 20.4.2023.

<sup>84</sup> Pjesë e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”.

**6.15.** Komisioni çmon se një qarkullim në intervalin 6.000.000 – 8.000.000 lekë nga aktiviteti i personit fizik për një periudhë 3-vjeçare i mbulon shumat e depozituara në llogaritë bankare, pa konsideruar këtu që tërheqjet e kryera mund të jenë injektuar sërish në sistemin bankar.

**6.16.** Lidhur me përdorimin e shumës 3.930 euro të tërhequr nga ana e saj, subjekti shpjegon se nuk kujton tërheqjet e kryera nga ajo apo shumat specifike në këtë depozitë, por sqaron se ato janë urdhëruar nga tezja e saj për nevoja të saj apo të familjarëve, të cilëve ua ka dorëzuar menjëherë këto shuma dhe, duke qenë se ka kryer vetëm veprimin e tërheqjes së tyre dhe nuk kanë qenë të lidhura me shpenzimet apo të ardhurat e saj, nuk kujton arsyet specifike të përdorimit të tyre.

**6.17.** Lidhur me përdorimin e shumës së tërhequr nga tezja e saj në vitin 2013, subjekti sqaron se shtëpia në Oslo, Norvegji, është blerë me kredi nga ana e tezes dhe bashkëshortit. Vlera në total e shtëpisë ka qenë në shumën 1.790.000 NOK dhe nga ana e tyre është marrë kredi shuma prej 1.500.000 NOK. Pjesa tjetër e çmimit të blerjes së shtëpisë është paguar në datën 15.11.2013 me shumën e tërhequr nga tezja në korrik 2013 nga depozita e mësipërme, si dhe kursime të tjera të tyre. Për vërtetimin e deklaramit, subjekti ka paraqitur dokumentacionin përkatës<sup>85</sup>.

**6.18.** Referuar dokumenteve të paraqitura, rezulton se sipas kontratës së blerjes të datës 31.10.2013 (e përkthyer në shqip, e panoterizuar) shtetasit M. Tz. dhe Y. Xh. kanë blerë pasurinë e ndodhur në “\*\*\*, nr. \*\*\*, nr. \*\*\*, në komunën e \*\*\*” kundrejt shumës 1.790.000 NOK. Subjekti ka paraqitur edhe dokument nga BN Bank ASA në gjuhën norvegjeze, ku pasqyrohet vlera 1.500.000 NOK.

**6.19.** Sa më lart, Komisioni çmon se: (i) subjekti i rivlerësimit e ka shpjeguar administrimin e shumës në DIPP-në e vitit 2010; (ii) subjekti i rivlerësimit e ka fituar të drejtën e përdorimit në këtë llogari që në kohën që ka qenë studente në vitin 2005; (iii) subjekti i rivlerësimit ka kryer transaksione në këtë llogari, pasi mbajtësja e llogarisë/tezja e subjektit ishte larguar nga Shqipëria<sup>86</sup>; (iv) të ardhurat vjetore të qarkulluara nga aktiviteti i bashkëshortit të tezes janë më të larta se shumat e depozituara; (v) subjekti depozitoi prova për të vërtetuar deklaramin e saj se tezja ka blerë apartament në \*\*\*, Norvegji, për rrjedhojë nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit lidhur me këto transaksione.

**6.20. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me administrimin nga subjekti i rivlerësimit të depozitave në shumën 19.930 euro në emër të shtetas M. Xh. (tezja), që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

## **7. Transaksion i kryer në Alpha Bank, dega Vlorë, në shumën 3.000 euro**

**7.1.** Në DIPP-në e vitit 2007, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave fizikë dhe juridikë”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Detyrim financiar nga K. M., transaksion i pasqyruar dhe i kryer nga Alpha Bank, Vlorë*”. Gjendja e detyrimit e mbetur e pashlyer në 31 dhjetor, vlera 3.000 euro”. Më pas, në DIPP-të e viteve pasuese, subjekti nuk ka bërë deklarime të tjera lidhur me këtë vlerë.

<sup>85</sup> Kopje të kontratës për blerjen e shtëpisë në gjuhën norvegjeze; kopje të përkthyer në shqip të datës 31.10.2013; dokumente të bankës BN Bank ASA në gjuhën norvegjeze.

<sup>86</sup> Referuar sistemit TIMS, rezulton se shtetasi Y. Xh. (bashkëshorti i shtetas M. Xh.) ka dalë nga territori shqiptar në datën 25.3.2010 dhe është rikthyer në datën 5.7.2011 (për shtetas M. Xh. të dhënat në sistemin TIMS nuk janë të plota).

**7.2.** Në përgjigje të pyetësorit standard<sup>87</sup>, subjekti ka deklaruar: “...Për arsye familjare, në vitin 2007, nusja e dajos K. M., i ka kërkuar vjehrrës së saj, pra gjyshes sime V. M., shumën prej 3.000 euro. Në atë kohë, K. jetonte në Greqi, ndërkohë që gjyshja ime jetonte në Shqipëri. Gjyshja më ka autorizuar dhe vënë në dispozicion shumën prej 3.000 euro, të cilën unë ia kam nisur znj. K. M. nëpërmjet Alpha Bank. Në këtë marrëdhënie unë kam kryer vetëm procedurën e nisjes nëpërmjet bankës së kësaj shume, ndërkohë që nuk kam pasur asnjë të drejtë për disponimin e saj”.

**7.3.** Më pas, në përgjigje të pyetësorit nr. 1<sup>88</sup>, subjekti ka sqaruar se ka kryer vetëm dërgesën, duke mos pasur asnjë kontribut apo të drejtë për përdorimin apo disponimin e kësaj shume, e cila i është dërguar familjes së dajës në Greqi, për ta ndihmuar në blerjen e një automjeti. Më tej, subjekti shpjegon se ky fakt është pasqyruar në DIPP-në e vitit përkatës, me qëllim transparencën e plotë dhe duke e konsideruar të qartë se kjo shumë nuk përfaqësonte një detyrim ndaj saj. Për ta vërtetuar këtë deklaram, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur kopje të dokumentit të datës 4.9.2007 “Transfertë në nisje të lirë nga arka online” të Alpha Bank, si dhe kopje të deklaratës së datës 26.12.2022 të shtetasës K. M..

**7.4.** Referuar dokumentit “Transfertë në nisje të lirë nga arka online” të Alpha Bank, rezulton se subjekti ka kryer një transfertë ndërkombëtare nga arka *online*, pra jo nëpërmjet depozitimit në ndonjë llogari personale, në datën 4.9.2007, tek llogaria e shtetasës K. M. në Alpha Bank, Athinë, në shumën 3.000 euro, me përshkrim “Trf. në nisje nga znj. Elvana Cicolli për”.

**7.5.** Në deklaratën e datës 26.12.2022, shtetasja K. M. konfirmon deklaratimet e subjektit, duke theksuar se subjekti nuk ka asnjë kontribut në vlerën e transferuar, pasi kjo shumë kishte si burim kursimet e vjehrrës.

**7.6.** Komisioni verifikoi të dhënat e sistemit TIMS, nga ku rezultoi se shtetasja K. M. ka dalë nga territori shqiptar në datën 5.1.2007 dhe ka hyrë në datën 29.1.2008, pra jetonte jashtë Shqipërisë, ndërsa shtetasja V. M./gjyshja e subjektit ka qenë në Shqipëri në momentin e kryerjes së transfertës, në datën 4.9.2007<sup>89</sup>, të dhëna këto që mbështesin deklaratimin e subjektit.

**7.7. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me këtë transaksion, që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

## **8. Gjendje cash në shumën 1.500 USD përpara fillimit të detyrës**

**8.1.** Në deklaratën përpara fillimit të detyrës të datës 3.11.2006, subjekti ka deklaruar: “Gjendje cash e përfituar nga tërheqja e depozitës prej 1.500 USD tek Banka Raiffeisen”. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

**8.2.** Nga informacioni i përcjellë nga Raiffeisen Bank<sup>90</sup>, konstatohet se në datën 27.4.2006 subjekti ka depozituar një shumë prej 3.000 USD, nga të cilat 1.500 USD i ka tërhequr në datën 29.5.2006, ndërsa 1.505 USD i ka kaluar në depozitë. Në datën 25.8.2006, kjo depozitë është maturuar dhe, më tej, në datën 3.10.2006, subjekti ka tërhequr shumën 1.515,12 USD.

<sup>87</sup> Email datë 24.7.2020.

<sup>88</sup> Email datë 5.1.2023.

<sup>89</sup> Hyrje në datën 14.5.2007, dalje në datën 24.10.2007.

<sup>90</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 14.8.2020.

**8.3.** Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1<sup>91</sup> i kërkoi subjektit të deklaronte burimin e krijimit të kësaj depozite. Në përgjigje<sup>92</sup>, subjekti deklaroi se të vetmet të ardhura të përfituara nga ana e saj përpara fillimit të detyrës përbëhen nga bursa e përfituar nga Shkolla e Magjistraturës, si dhe disa dhurata të vogla në vlerë monetare nga familjarët e saj (gjyshërit dhe tezja) me rastin e fillimit të Shkollës së Magjistraturës dhe me qëllim përballimin e shpenzimeve të jetesës.

**8.4.** Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 1.10.2004 – 27.4.2006 lidhur me depozitimin e shumës 3.000 USD, nga ku rezulton një balancë pozitive, si në tabelën vijuese:

**Tabela nr. 1 - Analiza financiare për depozitimin e shumës 3.000 USD**

Përshkrim	Vlerë
Depozitimi 3.000 USD në Raiffeisen Bank <sup>93</sup>	296,460
Gjendje e likuiditeteve në bankë <sup>94</sup>	20,233
<b>Total ndryshimi i likuiditeteve</b>	<b>316,693</b>
Të ardhura subjekti nga Shkolla e Magjistraturës <sup>95</sup>	697,950
<b>Total të ardhura</b>	<b>697,950</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT <sup>96</sup>	169,542
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS	47,007
Shpenzime qiraje <sup>97</sup>	80,000
<b>Total shpenzime</b>	<b>296,549</b>
<b>Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)</b>	<b>84,708</b>

**8.5.** Sa më lart, Komisioni konstaton se subjekti ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për depozitimin e shumës 3.000 USD dhe, për rrjedhojë, edhe për gjendjen e likuiditeteve *cash* në vlerën 1.500 USD, të deklaruar në deklaratën përpara fillimit të detyrës.

**8.6.** Më tej, po me anë të pyetësorit nr. 1, i kërkoi subjektit të deklaronte nëse kjo shumë ishte përdorur, pasi nuk ishin deklaruar pakësime në deklaratat vijuese dhe, nëse po, të specifikonte periudhën dhe destinacionin e përdorimit. Në përgjigje, subjekti deklaroi se, me sa kujtonte, kjo shumë është përdorur për të përballuar shpenzimet e përditshme dhe pagesën e qirasë për banesën ku jetonte së bashku me disa shoqe të periudhës së shkollës së lartë. Gjithashtu, kjo shumë mund të ketë shërbyer si burim për krijimin e depozitës në Bankën Popullore<sup>98</sup>.

**8.7.** Nga analizimi i rrethanave të mësipërme, Komisioni çmon se subjekti ka deklaruar saktë dhe ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e shumës 1.500 USD.

**8.8. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me deklarimin e gjendjes *cash* në shumën 1.500 USD përpara fillimit të detyrës, që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

<sup>91</sup> Email datë 15.12.2022.

<sup>92</sup> Email datë 5.1.2023; protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2023.

<sup>93</sup> Vlerësuar me kursin e këmbimit në datën e depozitimit – 1 USD = 99,82 lekë.

<sup>94</sup> Gjendje e llogarisë në lekë pranë Raiffeisen Bank.

<sup>95</sup> Për periudhën 1.10.2004, referuar vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 18.10.2016, nga Shkolla e Magjistraturës; për periudhën 1.1.2006 – 27.4.2006 referuar kreditimeve në Raiffeisen Bank.

<sup>96</sup> Për llogaritë për 3 muaj të vitit 2004, për vitin 2005 dhe 4 muaj të vitit 2006.

<sup>97</sup> Për periudhën 2000 – 2005 subjekti ka deklaruar qëndrimin në Qytet Studenti, ndërsa gjatë periudhës 2005 – 2006 ka jetuar në një shtëpi me qira, së bashku me shoqet e fakultetit.

<sup>98</sup> Përgjigje e pyetjes nr. 2.

## 9. Depozitë në shumën 100.000 lekë në vitin 2006

**9.1.** Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Depozitë me nr. \*\*\* në datën 4.6.2006, në Bankën Popullore, dega Tirana 1, me vlerë 100.000 lekë*”. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit sipas parashikimit të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003. Më pas, në DIPP-në e vitit 2007, subjekti deklaroi: “*Mbyllja e librezës me nr. \*\*\* të Bankës Popullore, datë 27.11.2007. Vlera: 103.615 lekë*”.

**9.2.** Nga informacioni i përcjellë nga Banka Popullore (sot OTP)<sup>99</sup> konstatohet se në datën 4.12.2006 subjekti ka depozituar shumën 100.000 lekë, duke e kaluar në depozitë me afat 1-vjeçar. Kjo depozitë është maturuar në datën 27.11.2007 dhe po në këtë datë është tërhequr nga subjekti shuma 103.600 lekë (principal dhe interesa).

**9.3.** Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1<sup>100</sup> i kërkoi subjektit të deklaronte burimin e krijimit të shumës së depozituar. Në përgjigje<sup>101</sup>, subjekti deklaroi se burimi i shumës së lartpërmendur janë të ardhurat e saj në atë periudhë, si dhe paga e përfituar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për periudhën tetor – dhjetor 2006. Gjithashtu, deklaroi se për shkak të kohës së hershme të kësaj depozite mendon se burim tjetër mund të ketë qenë edhe gjendja *cash* e përfituar nga tërheqja e depozitës prej 1.500 USD në Raiffeisen Bank.

**9.4.** Në vijim, Komisioni kreu analizën financiare lidhur me depozitimin e shumës 100.000 lekë, nga ku rezultoi një balancë pozitive si në tabelën vijuese.

**Tabela nr. 2 - Analiza financiare për depozitimin e shumës 100.000 lekë**

Përshkrim	Vlerë
Depozitimi 100.000 në OTP Bank	100,000
Shtim i likuiditeteve në bankë <sup>102</sup>	-61,804
Pakësim i likuiditeteve <i>cash</i> (1.500 USD)	-148,230
<b>Total ndryshimi i likuiditeteve</b>	<b>-110,034</b>
Të ardhura subjekti nga pagat <sup>103</sup>	181,977
<b>Total të ardhura</b>	<b>181,977</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT <sup>104</sup>	27,389
Shpenzime qiraje <sup>105</sup>	15,000
<b>Total shpenzime</b>	<b>42,389</b>
<b>Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)</b>	<b>249,622</b>

**9.5.** Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti ka deklaruar saktë dhe ka pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e depozitës.

**9.6. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me depozitimin e shumës 100.000 lekë në vitin 2006, që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

<sup>99</sup> Shkresë nr. \*\*\*, datë 14.8.2020.

<sup>100</sup> Email datë 15.12.2022.

<sup>101</sup> Email datë 5.1.2023; protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2023.

<sup>102</sup> Diferenca e gjendjes së llogarive bankare të datës 31.12.2006 me atë të datës 4.10.2006 (përveç depozitës në vlerën 100.000 lekë pranë OTP Bank).

<sup>103</sup> Vërtetim për pagën neto nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>104</sup> Përlllogaritur për 3 muaj.

<sup>105</sup> Subjekti ka deklaruar: “*Në këtë periudhë, pra prej tetorit 2006 deri në korrik 2007 kam banuar në një banesë me qira të ndodhur në një pallat në rrugën që lidh Rrugën e \*\*\* me Rrugën e \*\*\*. Në këtë banesë kam banuar me disa shoqe të universitetit dhe pagesa e saj, me sa mbaj mend, ka qenë 25.000 lekë/muaj. Pagesa personale ka qenë 5.000 lekë/muaj*”.

## 10. Pasuritë e fituara nga bashkëjetuesi/shtetasi A. Sh.

**10.1.** Nga hetimi administrativ rezultoi se subjekti ka bashkëjetuar me shtetasin A. Sh. gjatë periudhës nëntor 2013 – maj 2016, bazuar kjo në analizimin e deklaratave periodike vjetore, ku u konstatua se bashkëjetuesi i subjektit ka plotësuar deklaratat periodike vjetore në cilësinë e personit të lidhur si bashkëjetues i subjektit, për vitet 2013, 2014 dhe 2015 dhe, më tej, bazuar edhe në deklarinimin në pyetësorin standard, ku subjekti ka deklaruar bashkëjetesën me shtetasin A. Sh. në periudhën nëntor 2013 – maj 2016. Sa më lart, periudha e bashkëjetesës ka qenë nga data 25.11.2013<sup>106</sup> – deri në datën 1.5.2016<sup>107</sup>.

**10.2.** Në këto kushte, Komisioni hetoi dhe analizoi pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e ish-bashkëjetuesit të subjektit.

**10.3.** Nga analizimi i DIPP-së së parë të paraqitur nga bashkëjetuesi i subjektit në vitin 2013, Komisioni konstaton se ai nuk ka deklaruar pasuritë në pronësi të tij në atë moment, sipas parashikimit të neneve 2, pikat 8 dhe 22<sup>108</sup> të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012<sup>109</sup>.

**10.4.** Më tej, nga analizimi i DIPP-ve vijuese, konstatohet se bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar:

### 10.5. Bashkëpronar i pasurisë ullishtë me sipërfaqe 4.200 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Tiranë

**10.5.1.** Në DIPP-në e vitit 2015, bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar: *“Sipërfaqe prej 2.100 m<sup>2</sup> e pasurisë prej 4.200 m<sup>2</sup>, tokë arë që ndodhet në \*\*\*, z. k. \*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, volumi \*\*\*, f. \*\*\*. Përfutur në bazë të kontratës së dhurimit me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.11.2015, me dhurues shtetasit M. Q., Sh. Sh., O. Q.. Shkaku i dhurimit – marrëdhënie miqësore dhe personale me dhuruesin”*.

**10.5.2.** Nga dokumentacioni i administruar nga ASHK Tirana Rurale 1<sup>110</sup>, rezulton se shtetasi A. Sh. figuron bashkëpronar me shtetasin K. A. në pasurinë e llojit ullishtë, me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me sip. 4.200 m<sup>2</sup>, me adresë \*\*\*, Tiranë.

**10.5.3.** Referuar dokumenteve të origjinës së regjistrimit, rezulton se me kontratën e dhurimit nr. \*\*\*, datë 24.11.2015, shtetasit M. Q., Sh. Sh., O. Q. u kanë dhuruar shtetasve K. A., A. Sh. pasurinë e mësipërme dhe në kontratë pasqyrohet se pranuesit e dhurimit e kanë pranuar. Gjithashtu, rezulton se shtetasi M. Q. pasurinë e mësipërme e ka fituar në bazë të AMTP-së nr. \*\*\*, në cilësinë e anëtarit të familjes bujqësore, sipas parashikimeve të ligjit nr. 7501/1991.

**10.5.4.** Sipas dokumenteve të ZVRPP-së, rezulton se kjo pasuri në momentin e tjetërsimit, bazuar në çmimet e referencës, është vlerësuar në shumën 1.818.600 lekë dhe, pasi është

<sup>106</sup> Sipas deklarinimit të subjektit, bashkëjetesa ka filluar në momentin e lindjes së vajzës, në datën 25.11.2013.

<sup>107</sup> Referuar kontratës së qirasë së datës 1.5.2016, ku afati i kontratës parashikohet të jetë për një periudhë prej 1 viti, duke filluar nga data 1.5.2016 deri në datën 1.5.2017, si dhe deklarinimit të subjektit në DIPP/2016. Gjithashtu, në DIPP-në e vitit 2016, subjekti ka deklaruar: *“Pagesë qira për banesë maj – dhjetor 2016”*, të shoqëruar me shënimin “8 muaj x 20.000 lekë = 160.000 lekë”.

<sup>108</sup> Neni 22 – Deklarimi i pjesëtarëve të familjes: *“Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklarim. Anëtar i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara.”*

<sup>109</sup> Apartament me sip. 120.69 m<sup>2</sup>, Tiranë, kontratë shitjeje datë 17.9.2005, trajtuar në paragrafin 4.15 dhe apartamenti me sip. 76 m<sup>2</sup>, kontratë shitjeje datë 3.6.2009, Vlorë, trajtuar në pikën 1212.

<sup>110</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2020.

Ilogaritur vlera e saj sipas kontratës paraardhëse në shumën 1.683.888 lekë, nga ana e shtetasit A. Sh. është paguar tatimi në vlerën 20.206 lekë.

**10.5.5.** Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1<sup>111</sup> i kërkoi subjektit të deklarojë marrëdhënien e bashkëjetuesit me dhuruesit, si dhe të përshkruajë në mënyrë specifike arsyet e dhurimit dhe marrëdhënien e bashkëjetuesit të saj me shtetasin K. A., i cili gjithashtu figuron si pranues i dhurimit. Në përgjigje<sup>112</sup>, subjekti deklaroi se mes tyre ka marrëdhënie shoqërore, të cilat kanë filluar për shkak të ndihmës pa pagesë të ofruar nga ana e bashkëjetuesit të saj për probleme të ndryshme ligjore të kësaj familjeje. Për këtë arsye, kjo familje ka vendosur që këtë sipërfaqe toke të mos e shesë, por t'ua dhurojë. Ndërsa për marrëdhënien e bashkëjetuesit me shtetasin K. A. sqaron se ata janë shokë fëmijërie me njëri-tjetrin dhe kanë përfunduar shkollën e mesme në Vlorë. Shtetasi K. A., sqaron subjekti, është me profesion inxhinier informatik, ka studiuar dhe banon në qytetin \*\*\*, Itali, është krijues i platformës \*\*\* në Shqipëri, si dhe është administrator i një restoranti të suksesshëm në qytetin ku banon. Më tej, shpjegon se në të nuk është kryer asnjë investim.

**10.5.6.** Më tej, me anë të pyetësorit nr. 3<sup>113</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë koordinatat në *Google Maps* të pasurisë së mësipërme, si dhe të specifikojë llojet e konsulencave ligjore që bashkëjetuesi u ka dhënë dhuruesve dhe nëse disponon dokumentacionin provues që ta paraqesë atë. Në përgjigje<sup>114</sup>, subjekti ka paraqitur një mendim teknik nga ekspert topograf, në të cilin pasqyrohen edhe koordinatat e pronës. Më pas, ndërsa sqaron edhe një herë marrëdhënien e miqësisë ndërmjet bashkëjetuesit me dhuruesit e pronës, shpjegon se bashkëjetuesi dhe z. K. A. kanë insistuar që kjo sipërfaqe toke të shitej, duke qenë se ky ka qenë qëllimi i tyre, por edhe për shkak të vlerës së saj të përballeshme. Një situatë e tillë nuk është pranuar nga pala dhuruese, e cila ka shprehur në këtë mënyrë mirënjohjen dhe dëshirën e vetme që të vijojë marrëdhënia miqësore me bashkëjetuesin dhe z. K. A.. Në vijim, sqaron se sipërfaqja e tokës së dhuruar bashkëjetuesit është në masën 2.100 m<sup>2</sup>, me vlerë 909.300 lekë dhe në të nuk është bërë asnjë investim. Në lidhje me llojin e konsulencës ligjore sqaron se ka qenë në formën e këshillimit juridik për problematikat ligjore të kësaj familjeje, për të cilat nuk ka qenë i nevojshëm investimi apo paraqitja e mosmarrëveshjeve në gjykatë, pasi janë zgjidhur me ndërmjetësim.

**10.5.7.** Nga verifikimi i koordinatave të vëna në dispozicion nga subjekti në sistemin *Google Maps* sipas viteve të ndryshme, nuk konstatohet që në pasurinë “ullishtë” në bashkëpronësi të bashkëjetuesit të subjektit me shtetasin K. A. të jetë kryer ndonjë investim.

**10.5.8.** Duke marrë në konsideratë faktin që personi i lidhur/bashkëjetuesi i subjektit e ka përfituar pasurinë e mësipërme gjatë bashkëjetesës, Komisioni analizoi legjislacionin përkatës, nëse pasuria e mësipërme prezumohet si e përbashkët me subjektin, si më poshtë:

**10.5.9.** Kodi i Familjes, në ndryshim nga martesa, për të cilën parashikon rregullimin ligjor të pasurisë ndërmjet bashkëshortëve, në kushtet e mungesës së kontratës për këtë qëllim, duke e prezumuar të përbashkët<sup>115</sup>, nuk ka asnjë parashikim për rregullimin e bashkësisë ligjore të pasurisë së fituar nga bashkëjetuesit gjatë bashkëjetesës faktike ndërmjet tyre. Dispozita e

<sup>111</sup> Email datë 15.12.2022.

<sup>112</sup> Email datë 5.1.2023 (përgjigje pyetjeve shtesë nr. 18).

<sup>113</sup> Email datë 28.3.2023.

<sup>114</sup> Email datë 31.3.2023.

<sup>115</sup> Kodi i Familjes, neni 76: “Pasuria e bashkëshortëve prezumohet si e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak”.



vetme që rregullon pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa, është neni 164 i Kodit të Familjes, që përcakton: “*Personat bashkëjetues mund të lidhin marrëveshje para noterit, ku përcaktojnë pasojat që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë gjatë bashkëjetesës*”. Për pasojë, rregullimi i regjimit pasuror ndërmjet bashkëjetuesve bëhet vetëm mbi bazën e përputhjes së vullnetit të tyre kontraktor, në referim të neneve 660 dhe 663 të Kodit Civil<sup>116</sup>. Megjithatë, pavarësisht se nga njëra anë për bashkëjetesën nuk janë të zbatueshme dispozitat që rregullojnë regjimin pasuror të bashkësisë ligjore të martesës, nga ana tjetër mungesa e marrëveshjes noteriale për rregullimin e regjimit pasuror ndërmjet bashkëjetuesve në interpretim të kundërt të nenit 164 të Kodit të Familjes nuk mund të shërbejë si një kriter përjashtues i të drejtave pasurore të bashkëjetuesit, i cili vërteton kontributin e tij në krijimin e pasurive të vendosura gjatë bashkëjetesës<sup>117</sup>.

**10.5.10.** Nga analizimi i rrethanave konkrete rezulton se: (i) subjekti nuk ka deklaruar rregullimin me kontratë të veçantë të pasojave që rrjedhin nga bashkëjetesa lidhur me fëmijët dhe pasurinë e fituar gjatë bashkëjetesës, sipas parashikimeve të nenit 164 të Kodit të Familjes; (ii) pasuria e mësipërme i është dhuruar bashkëjetuesit të subjektit dhe nuk është e blerë nga ai me të ardhurat e tij apo të familjes; (iii) subjekti ka deklaruar se kjo pasuri i është dhuruar bashkëjetuesit për shkak të ndihmës ligjore pa pagesë të ofruar nga ana e tij dhe nuk ka pretenduar të drejta reale mbi këtë pasuri. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se pasuria tokë arë me sip. 4.200 m<sup>2</sup>, \*\*\*, Tiranë, është pasuri e bashkëjetuesit të subjektit dhe nuk prezumohet apo vërtetohet kontributi i subjektit të rivlerësimit në këtë pasuri për shkak të bashkëjetesës.

**10.5.11.** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit M. Q., Sh. Sh., O. Q. dhe K. A. dhe rezultoi se subjekti nuk ndodhej në kushtet e konfliktit të interesit<sup>118</sup>.

**10.5.12.** Nga analizimi i fakteve të mësipërme rezulton se: (i) bashkëjetuesi i subjektit ka ushtruar aktivitetin si person fizik me objekt shërbime juridike në periudhën 12.9.2007 – 8.9.2020<sup>119</sup>; (ii) pasuria e përfituar nga bashkëjetuesi i subjektit është individuale dhe subjekti nuk prezumohet bashkëpronar sipas ligjit; (iii) nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit me dhuruesit.

**10.5.13. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me pasurinë e llojit ullishtë me sip. 2.100 m<sup>2</sup>, me vendndodhje \*\*\*, Tiranë, të përfituar nga bashkëjetuesi i subjektit, pasuri që ndikon apo ka lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

## **10.6. Automjet tip “Volkswagen”, me targë \*\*\*, vit prodhimi 2005**

**10.6.1.** Në DIPP-në e vitit 2015, bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar: “*Blerje e makinës Volkswagen me nr. shasie \*\*\*. Çmimi 800 euro dhe detyrim dogane 54.355 lekë*”. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit, sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 3 të neneve 4, 22, të ligjit nr. 9049/2003, të ndryshuar.

**10.6.2.** Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1<sup>120</sup> i kërkoi subjektit të deklarojë burimin e krijimit, si dhe të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues lidhur me fitimin e pronësisë. Në

<sup>116</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 23.3.2023, i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

<sup>117</sup> Po aty.

<sup>118</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2023, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; shkresë nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>119</sup> <https://qkb.gov.al/kerko/kerko-ne-regjistrin-tregtar/kerko-per-subjekt/>

<sup>120</sup> Email datë 15.12.2022.

përgjigje<sup>121</sup>, subjekti deklaroi se burim për blerjen e këtij automjeti kanë qenë të ardhurat e realizuara prej bashkëjetuesit, si dhe paraqiti dokumentacion provues lidhur me pronësinë e këtij automjeti<sup>122</sup>.

**10.6.3.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga subjekti, të administruar nga DPSHTRR-ja<sup>123</sup> dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave<sup>124</sup>, rezulton se shtetasi A. Sh. në datën 9.4.2015 ka blerë në Gjermani nga shtetasi I. P. automjetin tip “Volkswagen Golf”, vit prodhimi 2005, me çmim 800 euro<sup>125</sup>. Sipas deklaratës doganore \*\*\*, datë 22.4.2015, shtetasi A. Sh. figuron importues i këtij automjeti dhe ka paguar detyrimet doganore në vlerën 85.350 lekë<sup>126</sup>.

**10.6.4.** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasin I. P. dhe nuk rezultoi që subjekti të ishte në kushtet e konfliktit të interesit<sup>127</sup>.

### **10.7. Automjet tip “Volkswagen Passat”, me targë \*\*\*, vit prodhimi 2007**

**10.7.1.** Në DIPP-në e vitit 2015, bashkëjetuesi i subjektit ka deklaruar: “*Blerje e makinës “Volkswagen Passat”. Çmimi 3.900 euro dhe detyrim dogane 26.804 lekë*”. Nuk ka deklaruar burimin e krijimit sipas parashikimit të pikës 2 të nenit 3 dhe nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003.

**10.7.2.** Komisioni me anë të pyetësorit nr. 1<sup>128</sup> i kërkoi subjektit të deklarojë burimin e krijimit, si dhe të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues lidhur me fitimin e pronësisë. Në përgjigje<sup>129</sup>, subjekti deklaroi se burim për blerjen e këtij automjeti kanë qenë të ardhurat e realizuara prej bashkëjetuesit. Subjekti paraqiti dokumentacion provues lidhur me pronësinë e këtij automjeti<sup>130</sup>.

**10.7.3.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga subjekti, të administruar nga DPSHTRR-ja<sup>131</sup> dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave<sup>132</sup>, konkretisht referuar deklaratës doganore \*\*\*, datë 6.5.2015, rezulton se shtetasi A. Sh.<sup>133</sup> ka importuar nga Italia automjetin tip “Volkswagen Passat”, vit prodhimi 2007, ku shuma totale e pasqyruar në rubrikën “monedha dhe shuma totale në faturë” është vendosur 250.000 lekë, ndërsa detyrimi doganor është paguar në shumën 134.585 lekë.

**10.7.4.** Komisioni konstaton se në dokumentacionin e përcjellë nga subjekti dhe nga DPSHTRR-ja<sup>134</sup> nuk ndodhet fatura e blerjes së automjetit. Në këto kushte, për të përcaktuar koston totale të këtij automjeti, Komisioni u bazua në deklarimin e kryer nga vetë bashkëjetuesi i subjektit në DIPP-në e vitit 2015, në vlerën 3.900 euro.

---

<sup>121</sup> Përgjigje pyetjeve shtesë nr. 18.

<sup>122</sup> Deklaratë doganore datë 22.4.2015; mandat i Credins Bank, datë 22.1.2015; urdhër çlirimi datë 22.1.2015; kontratë shitjeje, datë 9.4.2015; certifikatë regjistrimi, leje qarkullimi, certifikatë pronësie e mjetit.

<sup>123</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2023 (nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2023 në Komision).

<sup>124</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

<sup>125</sup> Faturë nr. \*\*\*, datë 9.4.2015.

<sup>126</sup> Pagesë e kryer në datën 22.4.2015 pranë Credins Bank.

<sup>127</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2023, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>128</sup> Email datë 15.12.2022.

<sup>129</sup> Përgjigje pyetjeve shtesë nr.18.

<sup>130</sup> Deklaratë doganore, datë 6.5.2015; urdhër çlirimi, datë 7.5.2015; certifikatë regjistrimi; leje qarkullimi gjermane; certifikatë kontrolli fizik; policë sigurimi; certifikatë pronësie e mjetit.

<sup>131</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2023.

<sup>132</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.12.2022.

<sup>133</sup> Figuron njëkohësisht edhe si eksportues, edhe si importues.

<sup>134</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2023.

## Analiza financiare për blerjen e dy automjeteve

**10.7.5.** Komisioni konstaton se subjekti dhe bashkëjetuesi nuk kanë deklaruar likuiditete *cash* në DIPP-të vjetore. Nëse do të ishin krijuar kursime *cash* jashtë sistemit bankar, ato duhet të ishin deklaruar në DIPP-në e vitit përkatës në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar, konkretisht referuar nenit 4, shkronja “d”, që parashikon se *subjektet detyrohen të deklarojnë “vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj, si dhe referuar nenit 7, pika 1, që parashikon se në deklarimin periodik, jepen vetëm ndryshimet e ndodhura në pasuritë, detyrimet financiare dhe interesat privatë.*

**10.7.6.** Për këtë arsye, Komisioni kreu analizën financiare për të verifikuar burimet e ligjshme financiare për blerjen e automjetit me targë \*\*\*, vlerë 197.622 lekë<sup>135</sup> dhe për blerjen e automjetit me targë \*\*\*, me vlerë 681.911 lekë<sup>136</sup>. Në këtë analizë u përfshinë të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe bashkëjetuesit, pasi në pyetësonin standard subjekti ka deklaruar se gjatë periudhës së bashkëjetesës shpenzimet e jetesës janë përballuar nga paga dhe të ardhurat e përfituara gjatë asaj periudhe, duke u kushtëzuar edhe nga shpenzimet e vajzës.

**Tabela nr. 3 - Analiza financiare për periudhën 1.1.2015 – 7.5.2015**

Përshkrim	Vlerë
Automjet tip “Volkswagen”, targë ***, bashkëjetuesi	197,622
Automjet tip “Volkswagen Passat”, targë ***, bashkëjetuesi	681,911
Ndryshim i likuiditeteve në bankë <sup>137</sup>	45,376
<b>Total pasuri</b>	<b>924,909</b>
Të ardhura subjekti nga pagat <sup>138</sup>	416,579
Të ardhura bashkëjetuesi nga pagat si pedagog <sup>139</sup>	361,292
Të ardhura bashkëjetuesi nga honoraret <sup>140</sup>	8,500
<b>Total të ardhura</b>	<b>786,371</b>
Shpenzime jetese sipas ILDKPKI - INSTAT <sup>141</sup>	237,172
Shpenzime për udhëtime nga sistemi TIMS <sup>142</sup>	54,372
Shpenzime për shlyerjen e kredisë pranë Union Bank <sup>143</sup>	100,124
Shpenzime për shlyerjen e kredisë pranë Raiffeisen Bank <sup>144</sup>	74,636
<b>Total shpenzime</b>	<b>466,304</b>
<b>Balanca e fondeve (të ardhura - ndryshim likuiditete - shpenzime)</b>	<b>-604,841</b>

**10.7.7.** Nga faktet e analizuara më sipër, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime të tjera në lidhje me konstatimin se: *Subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve të ligjshme financiare në datën 7.5.2015, në vlerën 604.841 lekë për blerjen e dy automjeteve.*

<sup>135</sup> Çmimi prej 800 euro, i vlerësuar me kursin e këmbimit të paraqitur në deklaratën doganore, 1 euro = 140.34 lekë dhe shpenzime doganore në vlerën 85.350 lekë.

<sup>136</sup> Çmimi prej 3.900 euro, i vlerësuar me kursin e këmbimit të paraqitur në deklaratën doganore, 1 euro = 140,34 lekë dhe shpenzime doganore në vlerën 134.585 lekë.

<sup>137</sup> Diferenca e gjendjes së llogarive bankare të datës 7.5.2015 me atë të datës 31.12.2014 (subjekti dhe bashkëjetuesi).

<sup>138</sup> Pagat e kredituara në llogarinë pranë BKT-së gjatë periudhës 1.1.2015 – 7.5.2015.

<sup>139</sup> Pagat e kredituara në llogarinë pranë BKT-së gjatë periudhës 1.1.2015 – 7.5.2015.

<sup>140</sup> Kredituar në llogarinë pranë BKT-së në datën 15.4.2015.

<sup>141</sup> Shpenzimet e jetesës të përlllogaritura për 4.23 muaj për 3 persona.

<sup>142</sup> Shpenzimet e udhëtimit gjatë periudhës 1.1.2015 – 7.5.2015.

<sup>143</sup> Shuma e pagesave të kryera për shlyerjen e kredisë për periudhën 1.1.2015 – 7.5.2015.

<sup>144</sup> Shuma e pagesave të kryera për shlyerjen e kredisë për periudhën 1.1.2015 – 7.5.2015.

**10.7.8.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>145</sup>, subjekti i rivlerësimit fillimisht kërkoi që analiza financiare të kryhet për periudhën 1.1.2015 – 7.5.2015 dhe jo për periudhën 1.1.2015 – 22.4.2015, siç ka vepruar Komisioni.

**10.7.9.** Më tej, subjekti shpjegoi se analiza financiare duhet të marrë në konsideratë disa rrethana, të cilat ndikojnë në uljen e shpenzimeve dhe, rrjedhimisht, në përlllogaritjen e shumës së konsideruar mungesë të burimeve të ligjshme financiare, konkretisht:

a) Në çmimin e automjetit me targë \*\*\*, me vlerë 3.900 euro, është përfshirë edhe pagesa e doganës, referuar deklaramit të bashkëjetuesit në DIPP-në e vitit 2015 dhe shpjegimit të tij e, për rrjedhojë, vlera e automjetit duhet përlllogaritur në 547.326 lekë, çka do të sillte reduktimin e balancës së fondeve në vlerën 470.256 lekë.

b) Në datën 31.12.2014, gjendja e likuiditeteve në banesë nuk ka qenë 0 (zero), por ka qenë e tillë për të përballuar nevojat e familjes dhe në veçanti fëmijës së mitur. Në atë periudhë, në banesë ka qenë gjendje shuma e pashpenzuar e kredisë konsumatore prej 500.000 lekësh, e marrë në gusht 2013, me qëllim përballimin e shpenzimeve lidhur me ndërhyrjen kirurgjikale për ardhjen në jetë të vajzës. Pjesa e mbetur e pashpenzuar nga kjo shumë është mbajtur në banesë për përballimin e nevojave familjare dhe nuk është deklaruar si gjendje *cash*, pasi është menduar që me deklaramin e kësaj kredie është ezauruar edhe deklarimi si likuiditet *cash*. Në këto kushte, subjekti kërkoi që këto vlera të evidentohen si mundësi kursimi dhe të merren në konsideratë si gjendje të ardhurash të ligjshme në banesë.

c) Në përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, duhet të merret parasysh fakti se vajza e subjektit ka qenë rreth 18-muajsh dhe vlera e shpenzimeve të përlllogaritura duhet të jetë e tillë që të pasqyrojë shpenzimet faktike për këtë moshë.

d) Gjatë kësaj periudhe, në përballimin e shpenzimeve të jetesës si familje e re dhe me një fëmijë të mitur, janë nga prindërit e tyre, të cilët kanë kontribuar edhe me përballimin e shpenzimeve të nevojshme për vajzën duke ulur ndjeshëm shpenzimet e tyre.

### **Arsyetimi ligjor në lidhje me ligjin e zbatueshëm**

**10.8.** Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklarimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar *Vetting* 2017; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ky institucion; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, prapësimet dhe provat e dërguara në përgjigje të barrës së provës, si dhe deklarimet në seancë dëgjimore, arsyeton si më poshtë:

**10.9.** Për sa i përket pretendimit të subjektit lidhur me periudhën për të cilën është kryer analiza financiare, Komisioni thekson se përlllogaritjet janë kryer duke analizuar të dhënat deri në datën 7.5.2015, siç është sqaruar në emërtimin e tabelës përkatëse dhe në shpjegimet e secilit element të saj<sup>146</sup>.

**10.10.** Lidhur me pretendimin e subjektit se në DIPP-në e vitit 2015, çmimi i deklaruar nga bashkëjetuesi për blerjen e automjetit tip “Volkswagen” me targë \*\*\*, në shumën 3.900 euro

<sup>145</sup> Email datë 16.5.2023.

<sup>146</sup> Shihni *footnote* për secilin element përbërës. Përshkrimi në paragrafin nr. 10.8.206 të relacionit mbi rezultatet e hetimit kyesisht është lapsus.

është përfshirë edhe pagesa e doganës, Komisioni arsyeton se objekt i hetimit dhe i vlerësimit të pasurisë ndaj subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit janë edhe deklaratat e pasurisë të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja. Neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përcakton që deklaratimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitur më parë tek ILDKPKI-ja, mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji. Këto deklaratat, së bashku me provat e tjera, vlerësohen në tërësi me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë.

**10.11.** Në rastin konkret, rezulton se në DIPP-në e vitit 2015, bashkëjetuesi ka deklaruar specifikisht “*çmimi 3.900 euro dhe detyrim dogane 26.804 lekë*”, pra është më se i qartë deklarimi për sa i përket çmimit të blerjes së automjetit me targë \*\*\* dhe detyrimit përkatës doganor të tij.

**10.12.** Për pasojë, Komisioni vlerëson së ky pretendim i subjektit nuk është i bazuar dhe në analizën financiare mbeti e pandryshuar vlera me të cilën është paraqitur kostoja totale e automjetit me targë \*\*\*.

**10.13.** Lidhur me pretendimin e subjektit mbi gjendjen *cash* të disponuar në fund të vitit 2014, kryesisht nga pjesa e mbetur e pashpenzuar e kredisë konsumatore prej 500.000 lekësh, e marrë prej saj në gusht të vitit 2013, Komisioni arsyeton se mbështetur në parashikimet e nenit 4, shkronja “d”<sup>147</sup> e ligjit nr. 9049/2003, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin të deklaronte gjendjen reale të likuiditeteve *cash* deri në datën 31.12.2014.

**10.14.** Për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, kursimet në formën e likuiditetit *cash* jashtë sistemit bankar, shtesat dhe pakësimet e tyre, merren parasysh nga trupi gjyqësor, sipas deklaratimeve të subjektit dhe personave të lidhur me të, në deklaratat periodike/vjetore, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi<sup>148</sup>.

**10.15.** Për sa kohë që nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur të kenë deklaruar kursime *cash* apo posedim të likuiditeteve *cash* në deklaratat e interesave privatë të viteve të mëparshme, pretendimi i subjektit për gjendjen *cash*, të disponuar në fund të vitit 2014 dhe të përdorur në vitin 2015, mbetet në nivel deklarativ.

**10.16.** Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës, Komisioni vëren se shpenzimet bazike që përlllogariten sipas INSTAT-it janë mbështetur mbi një mesatare të përgjithshme dhe ato referohen në mungesë të dokumentacionit si dyshemeja nën të cilën nuk mund të argumentohet, përveçse mbi prova shkresore<sup>149</sup>. Për këtë arsye, vlera e shpenzimeve të jetesës mbeti e pandryshuar në analizën financiare.

**10.17.** Pretendimi i subjektit lidhur me ndihmën e marrë nga prindërit gjatë vitit 2015 u vlerësua i pabazuar dhe nuk u mor në konsideratë nga Komisioni, për sa kohë ky pretendim u ngrit për herë të parë gjatë prapësimeve dhe në DIPP-në përkatëse nuk është kryer asnjë deklaram lidhur me këtë ndihmë.

**10.18. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme në datën 7.5.2015, në vlerën 604.841 lekë për blerjen e dy automjeteve.

<sup>147</sup> Subjekti ka pasur detyrimin për të deklaruar “[...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në *cash* jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj”.

<sup>148</sup> Vendimet (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18 të pg. 27; (JR) nr. 19/2019, në pg. 84; (JR) nr. 20/2019, në pg. 59 dhe (JR) nr. 29/2019, në pg. 31, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

<sup>149</sup> Vendim nr. 08-2021 (JR), datë 9.3.2021.

## KONSTATIME TË TJERA PËR BASHKËJETUESIN/SHTETASIN A. SH.

### 11. Kontratë porosie nr. \*\*\*, datë 21.9.2013

**11.1.** Gjatë hetimit administrativ, Komisioni konstatoi se në Regjistrin Noterial Shqiptar<sup>150</sup> figuronte kontrata e porosisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 21.9.2013, me palë A. Sh. dhe R. I., e lidhur pranë noteres F. Sh..

**11.2.** Komisioni e administroi nga noterja F. Sh.<sup>151</sup> kontratën e mësipërme dhe rezultoi se ndërmjet shtetasit R. I., i cili vepronte si përfaqësues i shtetasve N. I., A. B., F. Gj., K. V. dhe A. Sh. është lidhur kontrata e porosisë nr. \*\*\*, datë 21.9.2013, ku parashikohet se shtetasit e mësipërm kanë zgjedhur avokatin A. Sh. që t'i shërbejë në lidhje me mbrojtjen ligjore dhe përfaqësimin në disa procese gjyqësore civile që kanë lidhje me njohjen, kthimin dhe kompensimin e pronave të shtetasit A. B., me vendndodhje në Vlorë dhe si pagesa për shërbimin avokator për këto çështje gjyqësore, avokati A. Sh. do të përfitojë 4.000 m<sup>2</sup> truall, z. k. \*\*\*, \*\*\*, Vlorë. Kontrata parashikon se: “...hyn në fuqi pas nënshkrimit të saj nga palët dhe është e vlefshme deri në përfundimin e proceseve gjyqësore dhe regjistrimin e vendimeve në ZVRPP Vlorë”.

**11.3.** Në kushtet kur bashkëjetuesi nuk e ka deklaruar këtë kontratë porosie në DIPP-në e vitit 2013, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 1<sup>152</sup>, i kërkoi subjektit të paraqesë kopje të kontratës së porosisë dhe dokumentacionin që provon pagesën e çmimit të blerjes. Në përgjigje<sup>153</sup>, subjekti paraqiti kopje të kësaj kontrate dhe nga këqyrja e saj, Komisioni konstatoi se ajo mbante të njëjtat elemente (nr. rep/kol), ndërkohë që data ishte 21.9.2012 dhe jo 21.9.2013<sup>154</sup>. Megjithatë, prokura nr. \*\*\*, përcjellë nga noterja F. Sh. bashkëlidhur kësaj kontrate mban datën 21.9.2013, çka do të thotë se edhe data e pasqyruar në kontratën e shitjes duhet të ketë qenë 21.9.2013.

**11.4.** Lidhur me përmbajtjen e kontratës subjekti sqaron se bashkëjetuesi ka ushtruar profesionin e avokatit, i regjistruar prej datës 12.9.2007 në organet tatimore, dhe se kjo kontratë është lidhur mes palëve me qëllim përfaqësimin në gjykim. Për shkak të vështirësive financiare të palëve të përfaqësuara është vlerësuar një mënyrë shpërblimi për përfaqësimin si ajo e përcaktuar në këtë kontratë, lejuar rregullisht nga ligji për profesionin e avokatit. Kjo marrëdhënie shërbimi përfaqësimi ligjor, vijon shpjegimin subjekti, nuk rezulton të jetë ekzekutuar mes palëve dhe bashkëjetuesi nuk ka vijuar përfaqësimin e këtyre palëve në proceset e tyre gjyqësore dhe, për pasojë, kontrata ka humbur efektet e saj në heshtje për shkak të mungesës së ofrimit të shërbimit. Prej datës 2.7.2020 bashkëjetuesi ushtron një funksion publik dhe nga ana e tij është pezulluar ushtrimi i aktivitetit pranë QKB-së, përfundoi subjekti. Për vërtetimin e këtij deklarami subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues<sup>155</sup>.

**11.5.** Referuar dokumentacionit të paraqitur nga subjekti, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vënë në dispozicion të subjektit vendimet gjyqësore ku figurojnë si palë shtetasit R. I., N. I., A. B., F. Gj. dhe K. V., me palë të paditur AKKP Tiranë, ku konstatohet

<sup>150</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.8.2020, e Ministrisë së Drejtësisë.

<sup>151</sup> Shkresa e dates 2.2.2023

<sup>152</sup> Email datë 15.12.2022.

<sup>153</sup> Përgjigje pyetjeve shtesë nr. 18.

<sup>154</sup> Kjo kontratë u administrua edhe nga notere F. Sh., përcjellë pranë Komisionit në datën 3.2.2023.

<sup>155</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2022, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, bashkëlidhur së cilës janë vendimet nr. \*\*\*, datë 25.2.2010, nr. \*\*\*, datë 26.7.2011, nr. \*\*\*, datë 17.2.2014, nr. \*\*\*, datë 2.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë; shkresa e datës 21.12.2022 e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

se në vendimet gjyqësore<sup>156</sup> shtetasit e mësipërm në gjykim nuk janë përfaqësuar nga shtetasi A. Sh.. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur edhe shkresën e datës 21.12.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila informon se që prej vitit 2012 e në vijim nuk rezulton të jetë gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse R. I., N. I., A. B., F. Gj. dhe K. V. e të paditur AKKP Tiranë.

**11.6.** Komisioni hetoi lidhur me konfliktin e interesit të subjektit me shtetasit R. I., N. I., A. B. dhe K. V. dhe nuk u konstatua të ishte në kushtet e konfliktit të interesit<sup>157</sup>.

**11.7.** Nga analizimi i fakteve të mësipërme rezulton se: (i) kontrata e porosisë është lidhur në datën 21.9.2013 përpara bashkëjetesës së deklaruar me shtetasin A. Sh.<sup>158</sup>; (ii) subjekti ka paraqitur dokumentacionin provues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Vlorë që vërtetojnë se shtetasit e mësipërm (porositësit) në proceset gjyqësore lidhur me anulimin/shfuqizimin e vendimeve të AKKP-së nuk janë përfaqësuar nga shtetasi A. Sh., por nga një avokat tjetër. Për pasojë, Komisioni çmon se subjekti ka paraqitur dokumentacionin justifikues që provon se kontrata e porosisë nr. \*\*\*, datë 21.9.2013 nuk është ekzekutuar.

**11.8. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 21.9.2013, të nënshkruar nga bashkëjetuesi i subjektit që ndikon apo ka lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

## **12. Apartament me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, në Vlorë, blerë në datën 3.6.2009**

**12.1.** Nga dokumentacioni i administruar nga BKT-ja<sup>159</sup>, personi i lidhur/bashkëjetuesi rezulton dorëzanës në kontratën e kredisë nr. \*\*\*, datë 1.6.2011, lidhur ndërmjet kësaj banke dhe shtetasve A. M. dhe J. M..

**12.2.** Bashkëjetuesi ka qenë në cilësinë e hipotekuesit<sup>160</sup>, duke vendosur si kolateral pasurinë apartament me sip. 76 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, i ndodhur në Vlorë. Kjo pronë është hipotekuar në favor të BKT-së për të siguruar kthimin e kredisë së marrë nga kredimarrësit, në vlerën totale prej 2.930.000 lekësh.

**12.3.** Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin multifunksional të ASHK-së, rezulton se me kontratën nr. \*\*\*, datë 3.6.2009, shtetasi A. Sh. ka blerë apartamentin e sipërcituar nga shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., me çmim 3.400.000 lekë, i likuiduar tërësisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale.

**12.4.** Me anë të pyetësorit nr. 3<sup>161</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit të paraqesë vërtetim nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë që gjatë periudhës 14.11.2007 – 16.7.2013, kur ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë kësaj gjykate, nuk ka gjykuar çështje civile/penale me palë shoqëritë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe “\*\*\*\*” sh.p.k., si dhe me ortakët e administratorët e tyre, Gj. B. dhe L. Ll.. Subjekti paraqiti shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2023, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor

---

<sup>156</sup> Nr. \*\*\*, datë 25.2.2010, nr. \*\*\*, datë 26.7.2011, nr. \*\*\*, datë 17.2.2014, nr. \*\*\*, datë 2.12.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>157</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.2.2023, e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; shkresa nr. \*\*\* prot., datë 28.3.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>158</sup> Në përgjigje të pyetësorit standard ka deklaruar bashkëjetesën në periudhën nëntor 2013 – maj 2016.

<sup>159</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 17.8.2020.

<sup>160</sup> Kontratë hipotekimi nr. \*\*\*, datë 1.6.2011.

<sup>161</sup> Email datë 28.3.2023.

Vlorë, në të cilën kjo gjykatë i ka kthyer përgjigje subjektit se nuk ka gjykuar çështje me këto subjekte. Ky informacion u administrua dhe nga Komisioni<sup>162</sup>.

**12.5.** Sa më sipër, vërtetohet se shtetasi A. Sh. e ka fituar këtë pasuri në vitin 2009, vit në të cilin ky shtetas ende nuk e kishte statusin e bashkëjetuesit të subjektit, por në kushtet kur subjekti ka deklaruar në DIPP-të e viteve 2009 – 2012 adresë banimi “\*\*\* Tiranë”, banesë në pronësi të bashkëjetuesit<sup>163</sup>, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 4<sup>164</sup>, i kërkoi subjektit të rivlerësimin të paraqesë dokumentacion justifikues për të ardhurat që kanë shërbyer për pagesën e çmimit prej 3.400.000 lekësh<sup>165</sup>.

**12.6.** Në përgjigje<sup>166</sup>, subjekti paraqiti dokumentacion lidhur me të ardhurat e bashkëjetuesit dhe prindërve të tij<sup>167</sup> dhe sqaroi se e vetmja pasuri e prindërve të bashkëjetuesit ndër vite ka qenë një shtëpi e përfituar në vitin 1993 në qytetin e Vlorës nëpërmjet procedurës së privatizimit.

**12.7.** Pas analizimit të dokumentacionit të administruar, Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 2000<sup>168</sup> – 3.6.2009<sup>169</sup>, bashkëjetuesin dhe prindërit e tij, analizë në të cilën u konsideruan: (i) të ardhurat nga punësimi i bashkëjetuesit<sup>170</sup>; (ii) të ardhurat nga punësimi i babait të bashkëjetuesit<sup>171</sup>; (iii) të ardhurat e nënës së bashkëjetuesit nga pensioni<sup>172</sup> dhe nga punësimi<sup>173</sup>; (iv) shpenzime jetese për 3 persona; (v) blerja e apartamentit në Tiranë; (vi) blerja e apartamentit në Vlorë.

**12.8.** Nga analiza financiare rezultoi se bashkëjetuesi dhe prindërit e tij kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e të dy apartamenteve, në Vlorë dhe Tiranë e, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika lidhur me këtë pasuri.

**12.9.** Lidhur me aspektin deklarativ, Komisioni konstaton se bashkëjetuesi nuk e ka deklaruar këtë pasuri në DIPP-në e vitit 2013 (deklarata e parë e paraqitur në cilësinë e personit të lidhur), sipas parashikimit të nenit 2, pika 8 dhe nenit 22<sup>174</sup> të ligjit nr. 9049/2003, i ndryshuar me ligjin nr. 85/2012.

---

<sup>162</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2023, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

<sup>163</sup> Në pyetësorin standard ka deklaruar se përkon me vendndodhjen e apartamentit në pronësi të bashkëjetuesit.

<sup>164</sup> Email datë 5.4.2023.

<sup>165</sup> Në deklaratën përpara fillimit të detyrës së vitit 2020, lidhur me këtë pasuri, shtetasi A. Sh. ka deklaruar si burim krijimi të ardhurat familjare ndër vite.

<sup>166</sup> Email datë 20.4.2023.

<sup>167</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, i Fakultetit të Drejtësisë për z. A. Sh.; vërtetim për bazën e vlerësuar të ISSH-së, datë 10.4.2023, për z. A. Sh., të vulosur elektronikisht; ekstrakt nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve e datës 10.4.2023 nga platforma e-albania; ekstrakt historik nga regjistri tregtar për subjektin A. Sh.; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2020, nga ISSH Vlorë për znj. M. Sh.; vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020, nga ISSH Vlorë për z. M. Sh.

<sup>168</sup> Vit nga i cili disponohen të dhëna të sakta nga INSTAT-i për shpenzimet e jetesës.

<sup>169</sup> Data e blerjes së apartamentit në Vlorë.

<sup>170</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2020, lëshuar nga Fakulteti i Drejtësisë, të ardhurat neto nga pagat për periudhën 2004 – 3.6.2009 (2.936.144 lekë).

<sup>171</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Vlorë, të ardhurat neto nga pagat për periudhën 2000 – 3.6.2009 (8.062.055 lekë).

<sup>172</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 8.9.2020, lëshuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore Vlorë, të ardhurat nga pensioni për periudhën 3.4.2006 – 3.6.2009 (421.382 lekë).

<sup>173</sup> (i) Të ardhurat nga pagat neto për periudhën 1.4.2007 – 3.6.2009, u bazuan në vërtetimet për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë (764.807 lekë); (ii) të ardhurat nga pagat neto për periudhën 2000 – 2006 u bazuan në të dhënat e tabelës me emërtim “Logaritja e pensionit M. Sh.”, duke i rregulluar (pjesëtuar) me koeficientin 1.69, nga ku rezultoi një vlerë prej 1.070.450 lekësh. Të ardhurat nga paga, të pasqyruara në tabelën e përlogaritjes për efekt të pensionit, janë më të larta se ato të bazuar në dokumentacionin mbështetës që disponohet për periudhën 2007 e në vijim, e për këtë arsye, Komisioni saktësoi të ardhurat për periudhën 2000 – 2006 me të njëjtin koeficient.

<sup>174</sup> Neni 22 – Deklarimi i pjesëtarëve të familjes: *Kur pasuria e pjesëtarëve të familjes është e ndarë dhe e regjistruar si e tillë në organet e administratës shtetërore ose gjyqësore, deklarimi paraqitet veçmas nga çdo anëtar i familjes, me pasuri të*



**12.10. Në përfundim,** Komisioni vlerëson se nuk konstatohen problematika lidhur me pasurinë apartament me sip. 76 m<sup>2</sup>, në Vlorë, të blerë nga bashkëjetuesi i subjektit në datën 3.6.2009, që ndikon apo ka lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.

### 13. Analiza financiare

**13.1.** Komisioni kreu analizën financiare duke konsideruar pasuritë, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet për subjektin e rivlerësimit për periudhën tetor 2004 – dhjetor 2016, duke përfshirë në këtë analizë edhe bashkëjetuesin për periudhën 25.11.2013 – 1.5.2016, si edhe vajzën e tyre për periudhën nëntor 2013 – dhjetor 2016.

**13.2.** Referuar informacionit të përcjellë nga DPGJC-ja<sup>175</sup>, si dhe certifikatës personale dhe familjare<sup>176</sup> të paraqitur nga subjekti, rezulton se subjekti i rivlerësimit është ndarë nga trangu familjar në datën 19.12.2006.

**13.3.** Analiza financiare paraqitet e përmbledhur në vijim dhe e detajuar në Aneksin nr. 1 – analiza financiare e detajuar dhe Aneksi nr. 2 – metodika e analizës financiare.

**Tabela nr. 4 – Analiza financiare për periudhën 2004 – 2016**

Periudha	Pasuri	Ndryshim likuiditete cash	Ndryshim likuiditete bankë	Të ardhurat	Detyrimet	Shpenzime	Diferenca për shpenzime
1.10.2004 - 3.10.2006	0	148,230	77,993	936,090	0	367,198	<b>342,669</b>
4.10.2006 - 31.12.2006	0	-148,230	38,196	181,977	0	42,389	<b>249,622</b>
2007	0	0	-133,886	785,232	0	209,072	<b>710,046</b>
2008	0	0	32,242	906,350	0	136,620	<b>737,488</b>
2009	0	0	80,716	968,813	0	159,939	<b>728,158</b>
2010	0	0	-92,005	1,045,472	0	234,338	<b>903,139</b>
2011	0	0	-828	1,083,798	0	147,684	<b>936,942</b>
2012	0	0	52,331	1,000,970	0	173,858	<b>774,781</b>
2013	0	0	131,727	962,106	500,000	785,412	<b>544,967</b>
2014	0	0	-171,741	1,406,083	0	1,264,145	<b>313,679</b>
2015	879,533	0	-12,955	2,160,211	0	1,197,724	<b>95,910</b>
2016	0	0	-2,088	1,364,694	0	802,228	<b>564,554</b>
<b>TOTAL</b>	<b>879,533</b>	<b>-</b>	<b>- 297</b>	<b>12,801,796</b>	<b>500,000</b>	<b>5,520,608</b>	<b>6,901,953</b>

**13.4.** Sa më lart, nga analiza financiare vjetore u konstatuan balanca pozitive në fund të çdo viti kalendarik e, për rrjedhojë, subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për përbalimin e shpenzimeve në secilin vit kalendarik (përveç rezultatit të arritur në paragrafin 10.18 të këtij vendimi).

regjistruar në emër të vet dhe i bashkëlidhet deklaratës së personit që ka detyrimin për deklaram. Anëtar i familjes dhe personi i lidhur me subjektin deklarues mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë dhe saktësinë e të dhënave të deklaruara.

<sup>175</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.3.2023.

<sup>176</sup> Me procesverbalin nr. \*\*\* sipas certifikatës së lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr. \*\*\*, Vlorë, e datës 7.7.2020.

## **Përfundimet e Komisionit lidhur me vlerësimin e pasurisë**

### **13.5. Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin në këto përfundime:**

*Lidhur me pasuritë e deklaruara në deklaratën Vetting 2017: (i) huapërdorje automjeti tip “Ford”, në pronësi të babait të subjektit/P. Ç.; (ii) posedim i pasurisë me qira, një banesë 1+1 me adresë, pallat pranë rezidencës \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, vërtetësia e të cilit mbështetet në dokumentacionin justifikues.*

*Lidhur me adresat e banimit: (i) deklarimi i subjektit të rivlerësimit është i mbështetur në dokumentacionin justifikues; (ii) nuk konstatohen rrethana apo të dhëna që lidhen me gëzimin e ndonjë të drejte tjetër reale nga ajo e banimit mbi pasuritë e deklaruara si adresa banimi nga subjekti i rivlerësimit.*

*Lidhur me administrimin e: (i) depozitës në emër të gjyshes V. M., pranë NBG Bank (sot ABI Bank); (ii) depozitave në emër të familjares M. Xh. (tezja), nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.*

*Lidhur me transaksionin e kryer në Alpha Bank, dega Vlorë, në shumën 3.000 euro, nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.*

*Lidhur me: (i) gjendjen cash në shumën 1.500 USD përpara fillimit të detyrës; (ii) depozitën në shumën 100.000 lekë në vitin 2006, nuk konstatohen problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.*

### **Për pasuritë e fituara nga bashkëjetuesi gjatë bashkëjetesës (nëntor 2013 – maj 2016)**

*Lidhur me pasurinë ullishtë me sip. 4.200 m<sup>2</sup>, \*\*\*, Tiranë nuk konstatohen problematika që ndikojnë apo ka lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.*

*Lidhur me pasuritë: (i) automjet tip “Volkswagen”, me targë \*\*\*, vit prodhimi 2005; (ii) automjet tip “Volkswagen Passat”, me targë \*\*\*, vit prodhimi 2007; subjekti dhe personi i lidhur kanë pasur mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në datën 7.5.2015, në vlerën 604.841 lekë për blerjen e dy automjeteve.*

*Lidhur me kontratën e porosisë nr. \*\*\*, datë 21.9.2013, për kryerje e shërbimeve avokatore nuk konstatohen problematika që ndikojnë apo kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të subjektit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016.*

**13.6.** Në përfundim, bazuar në sa më lart për të gjitha pasuritë e deklaruara të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur (ish-bashkëjetuesit), trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të pasurisë, arrin të përfundimin se subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli ka arritur nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë, sipas shkronjës “a” të pikës 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, duke pasur parasysh se mungesa e burimeve të ligjshme në vlerën totale prej 604.841 lekësh, në vitin 2015, për blerjen e dy automjeteve, e vetme, nuk mund të përbëjnë shkak të mjaftueshëm për të dhënë masën disiplinore të shkarkimit nga detyra.

**13.7. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.**

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**1. Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar** ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 5.8.2020, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.8.2020, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

**2.** Sipas raportit, subjekti i rivlerësimit, znj. Elvana Çiçolli: (a) ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar; (b) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (c) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**3.** AKSIK-ja me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 30.5.2022, informon se nuk u administruan të dhëna shtesë lidhur me subjektin dhe, si pasojë, nuk ndryshon konstatimi fillestar për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

**4.** Pavarësisht raportit të dërguar nga AKSIK-ja, Komisioni ka kryer hetim administrativ, prej të cilit rezulton se konstatimet e Grupit të Punës për kontrollin e figurës janë të sakta.

**5.** Bazuar në faktet e sipërpërmendura, Komisioni vlerëson se: (a) subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratën për kontrollin e figurës në kohën e përcaktuar nga ligji nr. 84/2016; (b) nuk ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar; (c) nuk ka bërë deklaram të pamjaftueshëm në lidhje me kontrollin e figurës, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

**6. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Elvana Çiçolli, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.**

## **C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**1.** Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

**2.** Këshilli i Lartë Gjyqësor si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në

Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**3.** Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) aftësive profesionale;
- b) aftësive organizative;
- c) etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale;
- ç) aftësive personale dhe angazhimit profesional.

**4.** Raporti është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit bashkë me 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit; (ii) 5 dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënat nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**5.** Nga shqyrtimi i të dhënave në dosjen personale konstatohet se subjekti i rivlerësimit në periudhën nëntor 2007 – nëntor 2013 ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në periudhën nëntor 2013 – shtator 2014, ka qenë me leje lindjeje dhe nga tetori 2014 deri më sot është gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

### **Aftësitë profesionale**

#### *Njohuritë ligjore*

Subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara është konstatuar se identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret, njeh dhe zbaton parimet procedurale gjatë gjykimit.

#### *Arsyetimi ligjor*

Subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli ka aftësi të mira në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj janë të qarta, të kuptueshme, qëndrimi i mbajtur lidhur me zgjidhjen në themel të çështjes jepet i argumentuar. Respekton rregullat e drejtshkrimit në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor. Struktura e vendimeve përfundimtare është e qëndrueshme dhe e standardizuar. Niveli i arsyetimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor.

### **Hetimi i Komisionit**

**6.** Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja, Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me 3 dokumentet e përzgjedhura nga subjekti dhe me 5 dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për dosjet 1, 3 dhe 4 të shortuara, si vijon:

**7. Lidhur me dosjen nr. 1,** që i përket çështjes administrative nr. \*\*\* akti, datë 7.11.2014 regjistrimi, me palë: paditëse A. C.; i paditur Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, me objekt “Shfuqizim urdhri, detyrimin e ZQRPP-së të regjistrojë dëshminë e trashëgimisë testamentare”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Arsyetimi i subjektit në vendimin nr. \*\*\*, datë 4.3.2015, se padia është paraqitur tej afatit të parashikuar në ligj është bërë jo në përputhje me nenin 18 të ligjit nr.*

49/2012, pasi në llogaritjen e afatit të parashkrimit të padisë i është referuar datës së nxjerrjes së aktit administrativ dhe jo datës së njoftimit të tij duke sjellë si pasojë cenimin e të drejtës t'i drejtohet gjykatës për të mbrojtur një të drejtë ose një interes të ligjshëm.

**8.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>177</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se fakti që paditësi ka depozituar shkresën e datës 8.10.2014 nuk provon që ka marrë dijëni për aktin në këtë datë, pasi ai mund të ripajiset me kopje të aktit administrativ sa herë që i drejtohet organit administrativ. Në vijim, shpjegon se në urdhrin nr. \*\*\*, datë 9.4.2014, parashikohet se *një kopje e këtij urdhri dhe një kopje e njehsuar e dosjes nga ZVRPP-ja i dërgohet kërkuarit, personave të interesuar...*” dhe, si pasojë, organi administrativ ka qenë i detyruar për njoftimin e aktit të datës 9.4.2014. Ndërkohë, vijon shpjegimin subjekti, pala paditëse ka paraqitur një aplikim të ri në datën 1.10.2014, në mënyrë që të rivendoste veten në afat për t’iu drejtuar gjykatës me kërkesëpadi brenda afatit 45-ditor. Më pas shpjegon se vendimi nuk është ankimuar dhe ka marrë formë të prerë në datën 29.6.2015.

**9. Analiza e Komisionit** – subjekti i rivlerësimit shpjegoi bindshëm arsyet që kanë çuar subjektin në marrjen e këtij vendimi. Fakti që paditësi ka paraqitur përsëri aplikim të ri për rivendosjen në afat brenda 45 ditëve, ka rivendosur të drejtën e tij për t’iu drejtuar gjykatës, si dhe nuk ka ankimuar vendimin e subjektit të rivlerësimit. Pra, nuk është cenuar e drejta e palës paditëse për të investuar gjykatën. Në këto kushte, nuk konstatohen problematika në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit.

**10. Lidhur me dosjen nr. 3**, që i përket çështjes administrative nr. \*\*\* akti, datë 16.3.2015 regjistrimi, që u përket palëve: paditës K. V.; i paditur Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë; me objekt shfuqizimin e aktit administrativ dhe dëmshpërblimin sipas dispozitave të Kodit të Punës, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti në arsyetimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 12.6.2015, nuk ka analizuar ligjshmërinë e vendimit të Drejtorisë Rajonale Arsimore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës të paditësit në funksion të zgjidhjes së pasojave sipas dispozitave të Kodit të Punës.*

**11.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>178</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se në vendim ka arsyetuar në bazë të pretendimeve të palëve në procesin gjyqësor dhe ajo ka vlerësuar se sjellja e paditësit për shpërndarjen e bluzave me logon e një partie politike ka qenë absolutisht e papranueshme. Më pas arsyeton se pavarësisht shkeljes procedurale që vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është bërë në shkelje të procedurës prej palës së paditur, ka çmuar se është rasti të zbatohet neni 40/4, i ligjit nr. 49/2012, që parashikon se gjykata vendos rrëzimin e padisë kur vlerëson se pavarësisht shkeljeve procedurale të konstatuara të veprimtarisë administrative, pasojat do të ishin të njëjta.

**12. Analiza e Komisionit** – nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se paditësi K. V. ka filluar marrëdhëniet e punës pranë shkollës 9-vjeçare “\*\*\*”, duke filluar nga data 5.4.2002 në detyrën mësues. Gjatë një aktiviteti sportiv paditësi u ka shpërndarë bluza nxënësve të klasës së pestë, ku në to ka qenë e stampuar në pjesën e përparme fotoja e mësuesit K. V., si dhe logoja e një partie politike. Pala e paditur Drejtoria Arsimore Rajonale, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.2.2015, ka vendosur ndërprerjen e marrëdhënies së punës me paditësin me motivacionin: *“Thyerje të rëndë të etikës në punë, nëpërmjet shfrytëzimit të*

<sup>177</sup> Email datë 16.5.2023.

<sup>178</sup> Email datë 16.5.2023.

*nxënësve të shkollës në funksion të propagandimit të imazhit të tij personal*". Në këto kushte, paditësi i është drejtuar gjykatës administrative të shkallës së parë për zgjidhjen e konfliktit të lindur. Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.6.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë me arsyetimin se zgjidhja e marrëdhënies së punës është bërë për shkaqe të justifikuara duke arsyetuar, pasi përdorimi i bluzave ku ka qenë e stampuar fotografia e tij nuk ka asnjë kuptim dhe asnjë lidhje me procesin arsimor. Mësuesi ka përdorur autoritetin e tij ndaj nxënësve për të promovuar imazhin personal në kundërshtim me parimet që duhet të udhëheqin procesin arsimor dhe marrëdhënien nxënës-mësues.

**13.** Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 29.6.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, pranimin pjesërisht të padisë duke detyruar palën e paditur të dëmshpërblejë palën e paditur për zgjidhje të menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës me 12 paga, duke i shtuar dhe shpërblime për mosrespektimin e procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës me dy paga mujore, mosrespektimin e afatit të njoftimit të zgjidhjes së kontratës së punës me tre paga mujore, si dhe shpërblimin për vjetërsi në punë me 6.5 paga mujore. Në vendim, Gjykata e Apelit, ndërmjet të tjerave, ka arsyetuar se akti administrativ për zgjidhjen e kontratës së punës është absolutisht i pavlefshëm, pasi ky akt është marrë nga drejtori i Drejtorisë Rajonale Arsimore jashtë kompetencave të tij e, në këto kushte, pala e paditur duhet të detyrohet të dëmshpërblejë paditësin për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe në mungesë të procedurës së kërkuar nga dispozitat e Kodit të Punës.

**14.** Komisioni, duke marrë në konsideratë jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë<sup>179</sup>, e cila e ka trajtuar zgjidhjen e kontratës së punës si konflikt që rrjedh nga marrëdhënia e punës dhe jo si konflikt administrativ, pra punëmarrësi nuk mund të ngrejë padi për goditjen e aktit administrativ, por mund të ngrejë padi për kërkimin e pasojave që rrjedhin nga zgjidhja e kontratës së punës, çmon se në rastin konkret subjekti ka përcaktuar në mënyrë të qartë natyrën e mosmarrëveshjes, e cila është një mosmarrëveshje që lind nga marrëdhëniet e punës, duke bërë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve dhe pasi ka çmuar provat, në zbatim të neneve 5, 16 dhe 29 të Kodit të Procedurës Civile dhe bindjes së brendshme ka marrë vendimin përkatës.

**15. Në përfundim,** Komisioni nuk konstaton problematika që lidhen me kriteret e vlerësimit profesional të parashikuar në nenin 72 të ligjit nr. 96/2016.

**16. Lidhur me dosjen nr. 4,** që i përket çështjes administrative nr. \*\*\* akti, datë 8.10.2015 regjistrimi, me palë: paditës shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.; i paditur \*\*\*, me objekt “Pagim detyrimi kontraktor dhe kamatëvonesat”, Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti i rivlerësimit për konstatimin se *subjekti ka marrë vendimin gjyqësor “për rrëzimin pjesërisht të padisë lidhur me pagimin e kamatëvonesave” duke mos vlerësuar shkakun ligjor që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë sipas jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.*

**17.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>180</sup> subjekti i rivlerësimit pasi citon nenet 450 dhe 541 të Kodit Civil, që parashikojnë konceptin e kamatës dhe të kushtit penal, shpjegon se kamata kërkohet prej kreditorit ndaj të cilit nuk është paguar detyrimi, ndërsa kushti penal kërkohet nga autoriteti kontraktor (në rastin e gjykimit administrativ) ndaj personit që nuk përmbush në

<sup>179</sup> Vendimi unifikues nr. 7, datë 1.6.2011.

<sup>180</sup> Email datë 16.5.2023.

afat detyrimin. Më pas, shpjegon se pala paditëse e ka pasur të paqartë se çfarë i kërkon gjykatës duke pretenduar në kërkesëpadi kamatën mbi detyrimin monetar të pashlyer, por duke iu referuar në mënyrë të gabuar penalitetit të parashikuar në kontratë. Për sa më sipër, vijon shpjegimin subjekti, trupi gjykues nuk mund ta interpretonte kërkimin e paraqitur prej palës paditëse sipas parashikimit të nenit 16 të Kodit të Procedurës Civile.

**18. Analiza e Komisionit** – nga shqyrtimi i akteve të dosjes gjyqësore rezulton se pala paditëse ka realizuar në favor të palës së paditur shërbimet e parashikuara në: (i) kontratën nr. \*\*\*, datë 19.9.2011, me objekt “Shtrirja e linjës së furnizimit me energji elektrike të dedikuara për aparatura elektro-mjekësore” për shumën 1.530.300 lekë, duke lëshuar faturën tatimore; (ii) kontratën nr.\*\*\*, datë 11.7.2013, “Riparim e mirëmbajtje kabina elektrike dhe motogjeneratore në QSUT”, në shumën 2.064.660 lekë, duke lëshuar faturën tatimore; (iii) blerjen e vogël (punime) sipas faturës tatimore të shitjes nr. \*\*\*, datë 3.10.2011, dhe procesit të kolaudimit duke lëshuar faturën tatimore në shumën 473.160 lekë. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se shërbimet janë realizuar dhe janë pranuar pa kundërshtime prej palës së paditur. Pas kalimit të afatit ligjor dhe bërjes së kërkueshme të detyrimeve kontraktuale, pala paditëse i ka kërkuar palës së paditur vazhdimisht kryerjen e pagesave respektive. Në kushtet e mospërmbushjes së detyrimit shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Administrative Tiranë, duke kërkuar detyrimin e palës së paditur t’i paguajë dëmin kontraktor, si dhe kamatëvonesat.

**19.** Çështja e mësipërme është gjykuar me trup gjykues të përbërë nga 3 gjyqtarë<sup>181</sup> dhe, në përfundim, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 28.12.2015, ka vendosur pranimin pjesërisht të padisë duke detyruar palën e paditur të përmbushë detyrimin kontraktor në shumën 3.823.140 lekë dhe rrëzimin e pjesës tjetër të padisë lidhur me kërkimin e kamatëvonesave. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.1.2020.

**20.** Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. 3, datë 29.3.2012, arsyetojnë se shkak i padisë është kombinimi i faktit cenes dhe i së drejtës subjektive mbi të cilën bazohet padia e që ka lidhje me marrëdhënien juridike, që është themeli i pretendimit të paraqitur me kërkesëpadi në gjykatë. Shkak i padisë nuk duhet ngatërruar me të ashtuquajturën “bazë ligjore” apo referenca ligjore që ndeshet në kërkesëpadi. Shkak i padisë përbëhet nga dy elemente: (i) e drejta subjektive, e cila gjen burimin e saj tek e drejta objektive; dhe (ii) gjendja e faktit kundër kësaj të drejte (*causa petendi*). Më pas, Kolegjet arrijnë në konkluzionin unifikues se “Mund të ndodhë që paditësi të referojë gabimisht dispozitat ligjore, porse nga leximi i kërkesëpadisë del e qartë e drejta që ai kërkon të mbrojë. Në këtë rast gjykata duhet të zgjidhë çështjen konform shkakut që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, duke bërë lidhjen midis fakteve që pretendohen prej paditësit se kanë ngjarë dhe të drejtave apo interesave që ai pretendon se i janë cenuar”.

**21.** Në rastin konkret, paditësi ka kërkuar përmbushjen e detyrimit kontraktor dhe kamatëvonesat, duke e bazuar këtë kërkim në nenin 450 të Kodit Civil, që parashikon kamatat e arrira, llogaritjen e tyre dhe detyrimin e debitorit për pagimin e tyre. Në vijim të këtij arsyetimi, paditësi, bazuar në pretendimin që palët në kontratë janë të barabarta, kërkon që kamatëvonesat të llogariten sipas parashikimit që kontrata i bën llogaritjes së kushtit penal.

---

<sup>181</sup> Elvana Çiçolli (kryesuese), A. A. dhe S. Gj. (anëtarë).

Pavarësisht këtij kërkimi, gjykata, bazuar në nenin 16 të Kodit të Procedurës Civile, nuk i merr si të mirëqena shpjegimet e paditësit në lidhje me zbatimin e ligjit për çështjen konkrete, por si njohëse e ligjit e zgjidh vetë mosmarrëveshjen, sipas formimit dhe bindjes së saj të brendshme, bazuar në kriteret që parashikon Kushtetuta, Kodi i Procedurës Civile dhe ligjet e veçanta. Referenca e gabuar e paditësit për mënyrën e llogaritjes së kamatëvonesës nuk e pengon gjykatën që këtë mangësi, këtë “rregullim”, pra edhe “cilësim të saktë” juridik të “fakteve” ta bënte gjatë shqyrtimit të çështjes.

**22.** Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në vendimin nr. \*\*\*, datë 12.12.2012, ndërmjet të tjerave, arsyeton se gjykata nuk shkel, përkundrazi, zbaton me korrektësi ligjin procedural e material, nëse vendos mbi bazën e dispozitave ligjore të ndryshme nga ato të formuluar në parashtrimin e palës, mjafton që të ketë qëndruar në arsyetimin e saj brenda objektit dhe shkakut ligjor të padisë, si elemente esenciale pa të cilat nuk fillon dhe as mund të kuptohet ekzistenca e gjykimit civil.

**23.** Bazuar në arsyetimin më lart, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin gjyqësor “Për rrëzimin pjesërisht të padisë lidhur me pagimin e kamatëvonesave”, duke mos vlerësuar shkakun ligjor që rezulton nga shqyrtimi në tërësi i kërkesëpadisë, sipas jurisprudencës së Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, si një nga indikatorët e vlerësimit të aftësive profesionale. Kjo mangësi e marrë e vetme nuk mund të përbëjë shkak për ta konsideruar subjektin të paaftë profesionalisht.

### **Aftësitë organizative**

#### *Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë*

**24.** Subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë (8.10.2013– 4.11.2013), si dhe detyrën e gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (4.11.2013 – 8.10.2016). Për periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, gjyqtarja Elvana Çiçolli ka deklaruar se i janë caktuar për gjykim 1562 çështje. Sipas të dhënave statistikore rezulton se ka përfunduar gjithsej 1130 çështje, nga të cilat 680 çështje administrative themeli, 88 çështje marrëdhënie pune dhe 362 çështje të tjera, kërkesa pa palë kundërshtar<sup>182</sup>. Nga të dhënat statistikore konstatohet se ajo ka pasur ngarkesë sasiore, që përbën më tepër se dyfishin e standardit minimal<sup>183</sup>.

#### *Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore*

**25.** Subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli ka shfaqur aftësi shumë të mira për të kryer procedurat gjyqësore. I kushton rëndësi veprimeve përgatitore dhe e përfundon gjykimin me 1-3 seanca gjyqësore. I kushton rëndësi edhe dokumentimit të veprimeve të kryera, si dhe shprehet me urdhra dhe vendime të ndërmjetme mbi kërkesat e palëve. Ndjek me rigorozitet radhën e veprimeve procedurale, siç përcaktohet nga ligji, deri në shpalljen e vendimit përfundimtar.

<sup>182</sup> Në periudhën nëntor 2013 – tetor 2014, ka qenë me leje lindjeje, pra gjatë kësaj periudhe ajo nuk ka punuar.

<sup>183</sup> Sipas pikës 3, shkronja “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, në aspektin sasior, gjyqtari administrativ shkallës së parë, duhet të jetë në cilësinë e relatorit në jo më pak se 150 gjykime çështjesh, që kanë të bëjnë me mosmarrëveshje administrative. Ky rregull nënkupton një ngarkesë sasiore prej jo më pak se 300 gjykimesh çështjesh të tilla për 2 vjet.



### *Aftësia për të administruar dosjet*

**26.** Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short nuk janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet dhe për të mbikëqyrur saktësinë dhe plotësinë e akteve që përfshihen në të. Aktet gjyqësore janë të rregullta nga pikëpamja formale. Radhitja e akteve në dosje nuk paraqet vështirësi për identifikimin dhe shfrytëzimin e tyre nga të interesuarit.

### **Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale**

#### *Etika në punë*

**27.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarës Elvana Çiçolli. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt.

#### *Integriteti*

**28.** Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

#### *Paanësia*

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Elvana Çiçolli. Për vetë subjektin e rivlerësimit, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej dokumenteve ligjore dhe dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në dokumentet ligjore dhe në aktet e dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

### **Aftësitë personale dhe angazhimi profesional**

#### *Aftësitë e komunikimit*

**29.** Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara në procesverbalin gjyqësor, por edhe në ato procese ku është realizuar regjistrimi i seancave në audio, është konstatuar se gjyqtarja Elvana Çiçolli komunikon me etikë me palët ndërgjyqëse, qoftë në seancat përgatitore, qoftë në seancat gjyqësore. Gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë.

#### *Aftësia për të bashkëpunuar*

**30.** Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike, mbi aftësinë e subjektit Elvana Çiçolli për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

#### *Gatishmëria për t'u angazhuar*

**31.** Gjyqtarja Elvana Çiçolli i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ajo ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 7 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (*shihni* të dhënat tek trajnimet në 3 vitet e fundit) për një periudhë trevjeçare. Këto të dhëna tregojnë se ajo ka marrë pjesë në 11

ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ajo ka marrë pjesë, ka një lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit administrativ. Gjithashtu, znj. Çiçolli rezultoi e regjistruar fituese në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës, në ciklin e tretë të studimeve të Doktoraturës pranë Departamentit të së Drejtës Penale.

### **Të dhëna nga burimet arkivore të KLGJ-së**

**32.** Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultoi se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Elvana Çiçolli janë paraqitur gjithsej 6 ankesa (2 në vitin 2014, 2 në vitin 2015 dhe 2 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së.

**33.** Tre ankesa (1 e vitit 2014, 1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta. Këto ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon:

- 1 ankesë e vitit 2014, verifikuar për mosrespektim formal ligji, i është tërhequr vëmendja me shkrim gjyqtares;
- 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për vonesë në arsyetimin e vendimit gjyqësor, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje;
- 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për zvarritje gjykimi, i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik.

**34.** Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Elvana Çiçolli, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është paraqitur asnjë kërkesë për procedim disiplinor nga Ministria e Drejtësisë apo të jetë marrë ndonjë masë disiplinore nga ish- KLD-ja.

### **Hetimi i Komisionit në raport me ankesat e paraqitura në KLD dhe Ministrinë e Drejtësisë**

**35.** Referuar nenit 77 të ligjit nr. 96/2016, një nga burimet e vlerësimit të magjistratit janë të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, Komisioni administroi nga KLGJ-ja<sup>184</sup> ankesat e paraqitura në KLD ndaj subjektit Elvana Çiçolli, për periudhën 1.1.2006 – 1.9. 2020 dhe ankesat e paraqitura në Ministrinë e Drejtësisë<sup>185</sup>. Pas analizimit të tyre u konstatuan problematika dhe u kërkuan shpjegime për ankesat si vijon:

### **Ankesat e trajtuara nga KLD-ja**

**36.** Lidhur me ankesën e shtetasit E. K., i cili ka akuzuar subjektin e rivlerësimit për sjellje joprofesionale dhe joetike në marrjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 26.1.2016, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 26.1.2016, për kthimin e akteve, për shkak se pala paditëse nuk ka paguar tarifën gjyqësore të vlerës së padisë, pa hetuar më parë faktin nëse pala paditëse ndodhej në kushtet e pamundësisë financiare, duke cenuar të drejtën e aksesit në gjykatë të paditësit, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.*

**37.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>186</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se gjykata i ka dhënë mundësi palës paditëse për disa seanca të provojë se ka qenë në kushtet e përjashtimit nga taksa gjyqësore dhe në vendim është arsyetuar se gjykata e rrëzoi këtë kërkesë në respektim

<sup>184</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2020.

<sup>185</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 7.8.2020.

<sup>186</sup> Email datë 16.5.2023.

të vendimit të datës 27.2.2013, të Gjykatës Kushtetuese. Me tej, shpjegon se në kohën e gjykimit në fuqi ishte ligji nr. 10039/2008, “Për ndihmën juridike” dhe nuk rezultoi që pala paditëse t’i ishte drejtuar me kërkesë Komisionit për Ndihmën Juridike për të përfituar nga ndihma juridike falas. Gjithashtu, shpjegon se neni 105 i Kodit të Procedurës Civile ishte i paqartë, pasi nuk specifikonte kriteret për përjashtimin e paditësit nga shpenzimet gjyqësore dhe për shkak të këtyre mangësive veprimtaria e gjyqtarëve ka qenë objekt auditimi nga KLD-ja, e cila kur ka konstatuar gabime në llogaritjen e taksës gjyqësore apo në rastet e përjashtimit nga shpenzimet gjyqësore gjyqtarët janë ngarkuar me përgjegjësi financiare.

**38.** Nga hetimi i Komisionit rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja administrative me palë: paditës E. K., E. A., S. R.; të paditur Komuna \*\*\*, \*\*\*, pranë Prefekturës Tiranë, ZVRPP Tiranë, me objekt “Detyrimin për pajisjen me AMTP dhe detyrimin e të paditurve të dëmshpërblejnë paditësin për dëmin e shkaktuar”. Nga shqyrtimi i procesverbaleve të seancave gjyqësore rezulton se pala paditëse, pasi është njohur me aktin e ekspertimit, në seancën gjyqësore të datës 21.12.2015, ka kërkuar llogaritjen e dëmit që i është shkaktuar paditësi për një periudhë 36-mujore, që sipas llogaritjeve të saj i takon vlera 17.266.286 lekë. Pas këtij pretendimi gjykata ka vendosur lënien kohë palës paditëse për pagesën e tarifës gjyqësore (1% të vlerës së dëmit). Më pas, në seancën e datës 15.1.2016, avokatja e palës paditëse ka parashtruar se klientët e saj janë nga komuniteti rom dhe nuk kanë mundësi financiare për të paguar taksën gjyqësore, si dhe ka kërkuar kohë për të paraqitur kërkesën për pakësimin e padisë, duke hequr dorë nga kërkimi për pagimin e dëmeve, kërkesë që është pranuar nga gjykata. Në vijim, në procesverbalin e seancës së datës 26.1.2016, pasqyrohet se përfaqësuesja e palës paditëse ka paraqitur kërkesën paraprake me shkrim se paditësit janë në pamundësi për të paguar taksën gjyqësore. Pas paraqitjes së kësaj kërkesë subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.1.2016, ka vendosur kthimin e akteve të çështjes, me arsyetimin se paditësi nuk ka paguar taksat mbi aktet, konkretisht taksën mbi vlerën e padisë.

**39.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk e ka orientuar, si dhe nuk i ka dhënë kohë palës paditëse të paraqesë dokumentacionin e nevojshëm për të provuar se është në pamundësi pagimi, por menjëherë pas deklarimit të saj që nuk ka mundësi financiare ka vendosur kthimin e padisë dhe akteve, duke u gjendur në kushtet e pikës 2 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

**40.** *Lidhur me ankesën e Agjencisë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve, e cila akuzon subjektin e rivlerësimit se ka vendosur sigurimin e padisë në shkelje të neneve 28 e 29 të ligjit nr. 49/2012 dhe me vendimin unifikues nr. 10/2004, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti, në vendimin e datës 9.8.2017, për marrjen e masës së sigurimit e padisë, nuk ka analizuar dhe argumentuar interesat e palës së paditur, si dhe nuk ka vlerësuar proporcionalitetin ndërmjet interesave të palës paditëse me interesin publik, sipas parashikimit të nenit 29 të ligjit nr. 49/2012.**

**41.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>187</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në arsyetimin e vendimit janë analizuar të gjitha kushtet dhe kriteret për proporcionalitetin e caktimit të masës së sigurimit të padisë. Në vendim, vijon subjekti, kam arsyetuar se përdorimi i fondeve publike me efektivitet është interes i drejtpërdrejtë i publikut. Është pikërisht ky shkak për të cilin unë

---

<sup>187</sup> Email datë 16.5.2023.

kam disponuar me vendim për pranim të kërkesës për marrje të masës së sigurimit të padisë, duke konsideruar se oferta më e ulët është ajo që përmbush kriterin e respektimit të interesit publik për rikonstruksionin e një vepre publike me koston më të ulët të mundshme dhe mendon që koncepti i interesit publik nuk duhet të përdoret si justifikim i paligjshmërisë me nevojën që ka komuniteti për investime. Më pas sqaron se fakti që gjykatat më të larta nuk e kanë konsideruar të drejtë vendimin, ka të bëjë me bindjen e brendshme të gjyqtarëve që kanë marrë në shqyrtim çështjen.

**42.** Nga hetimi i Komisionit rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja me palë: kërkues Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë \*\*\* sh.p.k., \*\*\*\* sh.p.k., \*\*\*\* sh.p.k., \*\*\*\* sh.p.k., \*\*\*\* sh.p.k.; person i tretë Komisioni i Prokurimit Publik, \*\*, shoqëria \*\*\*\* sh.p.k., me objekt “Sigurimi i padisë, pezullimi i zbatimit të ekzekutimit të kontratës nr. \*\*, datë 4.8.2017, mes shoqërisë \*\*\*\* sh.p.k. dhe \*\*, me objekt “Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit të qytetit të Përmetit”. Në gjykim është provuar se në datën 24.4.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike procedura e prokurimit, me objekt “Rehabilitim i rrjetit të ujësjellësit të qytetit të Përmetit”, në të cilën ka marrë pjesë edhe pala kërkuese. Në përfundim të procedurës, pala kërkuese është skualifikuar për shkaqe të ndryshme. Kërkuesit kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka njoftuar për mospranimin e ankesës. Në vijim, pala kërkuese ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i cili gjithashtu ka vendosur të mos e pranojë ankesën. Në këto kushte, kërkuesit i janë drejtuar gjykatës, fillimisht me kërkesë për sigurimin e padisë dhe më pas kanë paraqitur padi, me objekt “Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik dhe anulimin e kontratës së sipërmarrjes të lidhur ndërmjet \*\*\*-së dhe operatorit ekonomik \*\*\*\* sh.p.k.”

**43.** Rezulton se kërkesa për sigurimin e padisë është gjykuar nga subjekti i rivlerësimit, ndërsa padia është gjykuar nga një tjetër trupë gjyqësore. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin, nr. s’ka, datë 9.8.2017, ka vendosur pranimin e kërkesës, pezullimin e zbatimit dhe ekzekutimit të kontratës të lidhur mes shoqërive \*\*\*\* dhe \*\*\* -së. **Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr.\*\*, datë 20.10.2017, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe rrëzimin e kërkesës për sigurimin e padisë. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. \*\*, datë 10.6.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga pala kërkuese.**

**44.** Në përfundim, arsyetimi i subjektit nuk bazohet në jurisprudencën e krijuar lidhur me këtë çështje, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Gjithsesi, kjo mangësi e subjektit nuk mund të përbëjë e vetme shkak për paaftësi profesionale.

#### **Ankesat e trajtuara nga Ministria e Drejtësisë**

**45.** Lidhur me ankesën e shtetasit F. K., i cili ka pretenduar se me vendimin nr. \*\*, datë 13.6.2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar parimin e “gjësë së gjykuar”, si dhe të drejtën e një procesi të rregullt gjyqësor, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, për konstatimin se: (i) *Subjekti ka marrë vendimin nr. \*\*, datë 20.6.2016 duke mos vlerësuar formimin e ndërgjyqësisë, sipas parashikimeve të neneve 90, 191, 192, 193 e 195 të Kodit të Procedurës Civile, duke sjellë si pasojë: (a) mohimin e të drejtës së disponimit mbi objektin e padisë të personit të tretë; (b) cenimin e të drejtës së disponimit të pronësisë të personit të tretë, pa qenë ky i fundit palë në gjykim;* (ii) *Subjekti i rivlerësimit ka marrë vendimin nr. \*\*, datë 13.6.2016 duke mos vlerësuar formimin e ndërgjyqësisë, sipas parashikimeve të neneve 90, 191, 192, 193 e 195 të Kodit të Procedurës Civile, duke sjellë si pasojë: (a) mohimin e të drejtës së disponimit mbi objektin e padisë të personit të tretë; (b) cenimin e të drejtës së disponimit të pronësisë të personit të tretë, pa qenë ky i fundit palë në gjykim;*

*datë 20.6.2016, për detyrimin e ZVRPP-së të pasqyrojë në regjistrat dhe kartelat përkatëse shfuqizimin e veprimeve të saj për lëshimin e certifikatës së pronësisë të datës 20.6.2016, duke mos vlerësuar legjitimitetin e palës paditëse lidhur me këtë kërkim, sipas parashikimeve të nenit 15 të ligjit nr. 49/2012.*

**46.** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>188</sup>, subjekti i rivlerësimit ka dhënë këto shpjegime: *Lidhur me konstatimin e pikës (i)*, sqaron se mes gjykimit civil dhe atij administrativ ka ndryshime thelbësore, një prej të cilave është pikërisht pozita procedurale e palëve ndërgjyqëse. Ndryshe nga gjykimi civil ku mosmarrëveshja qëndron mes dy palëve private në gjykimin administrativ, mosmarrëveshja lidhet me veprimin apo aktin administrativ të një organi publik. Në këtë këndvështrim, organi publik ka cilësinë e palës së paditur. Ndërkohë, subjekti që ka qenë përfitues nga procedura administrative merr pjesë në gjykimin administrativ në cilësinë e personit të tretë dhe jo të palës së paditur.

**47.** *Lidhur me konstatimin e pikës (ii)*, sqaron se në këtë gjykim pala paditëse ka pretenduar paligjshmëri të veprimeve të kryera prej palës së paditur dhe zgjidhjen e pasojave, duke pasqyruar gjendjen reale të regjistrave të ZVRPP-së Tiranë. Pavarësisht pasqyrimeve në regjistrin e ZVRPP-së Tiranë, pala paditëse legjitimohej në këtë kërkim për shkak të posedimit të ligjshëm të banesës nga ana e tij që prej vitit 1989. Pala paditëse paralelisht me këtë gjykim zhvillonte edhe gjykimin për kërkesëpadinë e datës 13.1.2015, nëpërmjet së cilës kishte kërkuar njohjen e tij si bashkëpronar në 37% të pronës.

**48.** Nga hetimi i Komisionit rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja administrative me palë: paditës H. R. etj., i paditur ZVRPP Tiranë, ZQRPP; person i tretë F. K., me objekt “Pavlefshmëri absolute e aktit administrativ, certifikatë për vërtetim pronësie. Detyrimin e ZVRPP-së Tiranë dhe ZQRPP-së si organ epror të shpallë absolutisht të pavlefshëm dhe të fshijë nga fleta e regjistrit hipotekor regjistrimin e paligjshëm të pasurisë nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*”. Në gjykim është provuar që paditësit, që nga viti 1989 kanë banuar si qiramarrës në një banesë shtetërore, në të cilën gjatë vitit 1990, me shpenzimet e tyre, kanë bërë disa shtesa. Me vendimin nr. \*\*\*, të KKKP-së, Bashkia Tiranë, kjo pronë i është kthyer pa shpërblim trashëgimtarëve të shtetasit Xh. K., pasi raporti i vlerës së shtesave ndaj vlerës së plotë të objektit është 11.7%. Paditësit i janë drejtuar me padi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke kërkuar anulimin e vendimit të KKKP-së, me argumentin se vlera e shpenzimeve për shtesat e bëra në ndërtesë është mbi 60%. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.4.1997, e ka rrëzuar padinë. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 8.10.1997, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke vendosur pranimin e pjesshëm të kërkesëpadisë, ndryshuar pikën e dytë të vendimit të KKKP-së lidhur me vlerën e shpenzimeve të kryera nga paditësit, si dhe duke i njohur atyre 37%, baras me vlerën 286.890 lekë në raport me ndërtesën e ish-pronarit. Ky vendim i Gjykatës së Apelit është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë.

**49.** Në vitin 2008 familja K. i drejtohet Zyrës Përmbartimore Tiranë për të detyruar ZVRPP-në të bënte regjistrimin e pronës së fituar, si dhe kanë derdhur në Raiffeisen Bank shumën 286.890 lekë në favor të familjes R., e cila nuk ka pranuar ta tërheqë. Në datën 20.4.2010, ZVRPP-ja Tiranë ka lëshuar certifikatën e pronësisë në favor të trashëgimtarëve të shtetasit

---

<sup>188</sup> Email datë 16.5.2023.

Xh. K., për pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, me pjesë takuese 100%. Në këto kushte, pala paditëse i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, duke kërkuar anulimin e certifikatës së pronësisë, si një akt absolutisht të pavlefshëm, si dhe detyrimin e palës së paditur, ZVRPP Tiranë, të regjistrojë vendimin nr. \*\*\*/1997 të Gjykatës së Apelit Tiranë, duke i njohur bashkëpronësinë në pjesën 37%, pasi pagesa është bërë nga personi i tretë, familja K., pas përfundimit të afatit 1-vjeçar të parashikuar në Udhëzimin nr. \*\*\*, datë 21.6.1993, të Këshillit të Ministrave.

**50.** Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.6.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, konstatimin e paligjshmërisë së veprimit administrativ të ZVRPP-së Tiranë për lëshimin e certifikatës për vërtetim pronësie nr. \*\*\*, datë 20.4.2010, për pasurinë nr. \*\*\*, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z. k. \*\*\*, në emër të personave të tretë, si një akt në tejkalim të kompetencave të parashikuara në ligj.

**51.** Në përfundim të analizimit të shpjegime të subjektit, në raport me shkaqet e ngritura në ankesën e shtetasit F. K., por edhe ligjit të zbatueshëm për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara në rivlerësimin e kësaj çështjeje nuk janë aq serioze sa do ta çonin Komisionin në vlerësimin e subjektit si të paaftë nga ana profesionale.

## **DENONCIME**

**52.** Në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Elvana Çiçolli janë administruar disa denoncime nga publiku.

**53.** Lidhur me denoncimet nga publiku, administruar në Komision, si vijon: (1) nr. \*\*\* prot., datë 24.5.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 27.5.2022, përcjellë nga Kolegji, nga shtetasi B. T. (2 denoncime); (2) nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2020, nga shtetasi S. H.; (3) nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2018, nga shtetasi R. F.; (4) nr. \*\*\* prot., datë 11.9.2018, nga shtetasi P. P.; (5) nr. \*\*\*, datë 29.10.2018, nr. \*\*\* prot., datë 18.12.2017 dhe nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2020, nga shtetasja S. B.; (3 denoncime); (6) nr. \*\*\* prot., datë 28.5.2018, nga shtetasi U. H.; (7) nr. \*\*\* prot., datë 30.3.2018, nga shtetasi Sh. M.; (8) nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2018, nga shtetasi M. D.; (9) nr. \*\*\* prot., datë 9.6.2018, nga shtetasja Y. D.; (10) nr. \*\*\* prot., datë 20.8.2018, nga shtetasi A. B.; (11) nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 13.2.2020, nga shtetasit Xh. dhe H. K.; (12) nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2018, nga shtetasi A. Q.; (13) nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 21.8.2019, të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare (AMF); (14) nr. \*\*\* prot., datë 31.7.2018, nga shtetasi A. P.; (15) nr. \*\*\* prot., datë 9.7.2020, nga shtetasi J. Q.; (16) nr. \*\*\* prot., datë 30.8.2018, nga shtetasi A. M.; (17) nr. \*\*\*, datë 2.5.2018, nga shtetasi A. B.,

– Komisioni, pas analizimit të denoncimeve më lart, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, dokumentacionin e administruar bashkë me denoncimet, si dhe dosjeve të administruara nga gjykata, arrin në konkluzionin se nga këto denoncime nuk kanë rezultuar fakte ose rrethana të cilat mund të përbëjnë provë lidhur me kriteret e rivlerësimit, sipas nenit E të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, si dhe ligjit nr. 96/2016.

**54. Ndërkohë që Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit të rivlerësimit lidhur me denoncimet e administruara në Komision, si vijon:**

**54.1** Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 3.9.2020, të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, e cila akuzon subjektin se ka gjykuar një çështje të gjykuar

më parë dhe se kërkesëpadia ishte jashtë të gjitha afateve kohore, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti nuk ka treguar kujdesin e duhur në gjykimin e çështjes administrative nr. \*\*\* akti, datë 11.2020, pasi ka zhvilluar gjykimin në situatën e gjyqvarësisë (litispëndencës), sipas parashikimit të nenit 58 të Kodit të Procedurës Civile.*

**54.2** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>189</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se kërkesëpadia objekt gjykimi nuk ka qenë e njëjtë me kërkesëpadinë e gjykuar më parë, pasi objekti dhe ndërgjyqësia nuk është e njëjtë. Në gjykimet e mëparshme është kërkuar shfuqizimi i aktit administrativ (pra është pretenduar paligjshmëria), ndërkohë që nëpërmjet kërkesëpadiës së gjykuar prej saj pretendohet pavlefshmëria absolute e aktit administrativ. Pra, shkak ligjor i kësaj kërkesëpadie është i ndryshëm nga ai i parashtruar në gjykimet e mëparshme. Gjithashtu, sqaron se rastin konkret nga ana e saj janë vlerësuar vetëm pretendimet për pavlefshmëri absolute të aktit administrativ, duke iu përmbajtur shkakut ligjor të kërkesëpadiës.

**54.3** Nga shqyrtimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 20.7.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, rezulton se subjekti ka gjykuar çështjen administrative me palë: paditës E. M.; i paditur DPPP, me objekt “Konstatimi i pavlefshmërisë absolute të vendimit nr. \*\*\*, datë 7.11.2019, të DPPP-së”. Në gjykim është vërtetuar se paditësja ushtron profesionin e noterit në qytetin e Tiranës dhe pala e paditur ka realizuar pranë zyrës noteriale të saj inspektimin lidhur me respektimin e kuadrit ligjor për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftën kundër financimit të terrorizmit. Nga verifikimi i dokumentacionit është konstatuar se janë nënshkruar dy deklarata noteriale, në harkun kohor të 10 ditëve, ndërmjet shtetasve A. I. (huamarrësi) dhe P. Gj. (huadhënës), në të cilat pasqyrohet se shtetasi P. Gj. i ka dhënë hua shtetasve A. I. një shumë, në total 120.000 euro. Pala e paditur ka konstatuar se është anashkaluar mosha e re e shtetasit huadhënës në lidhje me burimin e fondeve të vlerës së lartë në *cash*, noterës nuk i ka bërë përshtypje afati i ngushtë i parashikuar për kthimin e detyrimit nga shtetasja A. I., duke mos zbatuar kërkesat ligjore për ushtrimin e masave të vigjilencës së duhur mbi analizimin e transaksioneve dhe njohuritë mbi burimin e fondeve dhe raportimi i aktivitetit të dyshimtë (RAD) është kryer nga noterja jashtë afateve të përcaktuara në ligji. Në përfundim të inspektimit, pala e paditur ka marrë vendimin nr. \*\*\* prot., datë 7.11.2019, për dënimin e paditëses në masën 300.000 lekë, për mosrespektim të ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008. Paditësja, duke mos qenë dakord, ka paraqitur kërkesëpadinë objekt gjykimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**54.4** Në gjykim, DPPP-ja ka pretenduar se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja administrative me të njëjtët palë, me objekt “Shfuqizimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 7.11.2019, të DPPP-së, nga një tjetër trupë gjykuese”, ku në përfundim të gjykimit gjykata, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.2.2020, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadiës si të pabazuar në ligj.

**54.5** Në përfundim të analizimit të pretendimeve të denoncuesit, shpjegimeve të subjekti në raport me jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, subjekti i rivlerësimit, për të vlerësuar objektin e padisë, ishte e nevojshme të shikonte kërkesëpadinë në përmbajtje të saj, të gjitha shtjellimet e kërkimet e paditësit dhe jo vetëm pjesa hyrëse e kërkesëpadiës, sikundër pretendon subjekti. Pavarësisht se formalisht të dy paditë kanë objekt të ndryshëm,

---

<sup>189</sup> Email datë 16.5.2023.

nga krahasimi i pretendimeve të palës paditëse të pasqyruar në të dy vendimet gjyqësore rezulton se kjo palë ka ngritur të njëjtat pretendime që kanë lidhje me ligjshmërinë e aktit të DPPP-së, që kanë të bëjnë me pavlefshmërinë relative. Kjo pasaktësi e subjektit gjendet në kushtet e pikës 2 të nenit 72 të ligjit nr. 84/2016.

**54.6 Në lidhje me denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 11.11.2020, të shtetasit R. H.<sup>190</sup> dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.6.2020 e nr. \*\*\* prot., datë 24.6.2020, të shtetasit Z. T.<sup>191</sup>, që kanë lidhje me gjykimin e mosmarrëveshjeve në fushën e pronësisë industriale, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit, për konstatimin se: *Subjekti nuk ka vlerësuar pozitën dhe legjitimitetin e personit të tretë në gjykim, sipas parashikimeve në nenet 90, 191, 192, 193 e 195 të Kodit të Procedurës Civile*<sup>192</sup>.**

**54.7** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>193</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se mes gjykimit civil dhe atij administrativ ka ndryshime thelbësore, një prej të cilave është pikërisht pozita procedurale e palëve ndërgjyqëse. Ndryshe nga gjykimi civil ku mosmarrëveshja qëndron mes dy palëve private në gjykimin administrativ, mosmarrëveshja lidhet me veprimin apo aktin administrativ të një organi publik. Në këtë këndvështrim, organi publik ka cilësinë e palës së paditur. Ndërkohë, subjekti që ka qenë përfitues nga procedura administrative, e cila është kundërshtuar gjyqësisht, merr pjesë në gjykimin administrativ në cilësinë e personit të tretë dhe jo të palës së paditur. Pikërisht për këtë arsye është vlerësuar si e përshtatshme pozita procedurale e personit të tretë.

**54.8** Gjithashtu, shpjegon se praktika e Gjykatës Administrative e Apelit Tiranë dhe e Kolegjit Civil e Administrativ të Gjykatës së Lartë<sup>194</sup> nuk ka qenë e konsoliduar, duke sjellë probleme në praktikën e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe, së fundmi, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 11.5.2023<sup>195</sup>, ka vendosur të kalojë për njësim çështjen lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme pasive dhe llojin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në rast të konstatimit të parregullsisë në ndërtimin e ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme.

**54.9** Referuar rrethanave të kësaj çështjeje, Komisioni vlerëson se vendimi objekt shqyrtimi i subjektit të rivlerësimit është zgjidhur nga ky i fundit bazuar në interpretimin dhe logjikën e subjektit të rivlerësimit të lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme pasive, kështu që duke pasur parasysh faktin se deri në atë moment nuk ka pasur një vendim unifikues të Gjykatës Lartë dhe, për këtë arsye, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. \*\*\*, datë

<sup>190</sup> Bashkëlidhur ankimit, denoncuesi ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 6.4.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>191</sup> Bashkëlidhur ankesës ka paraqitur vendimin nr. \*\*\*, datë 15.12.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>192</sup> Lidhur me denoncimin nr. \*\*\*: “*Subjekti ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 23.2.2018, duke vendosur deklarimin e pavlefshëm dhe çregjistrimin e markës me në pronësi të personit të tretë, duke mos vlerësuar pozitën dhe legjitimitetin e tij në gjykim sipas parashikimeve në nenet 90, 191, 192, 193 e 195 të Kodit të Procedurës Civile*”.

<sup>193</sup> Email datë 16.5.2023.

<sup>194</sup> Vendimet nr. \*\*\* dhe nr. (\*\*\*) , datë 20.9.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë.

<sup>195</sup> Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur: “*Referuar fakteve të mësipërme dhe shkaqeve të rekursit të paraqitur kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Kolegji konstaton se në çështje të ngjashme me atë objekt gjykimi, ka pasur qëndrime të ndryshme të trupave të Kolegjit Administrativ lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme pasive dhe llojin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në rast të konstatimit të parregullsisë në ndërtimin e ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme. Në këtë kontekst, Kolegji çmon të nevojshme nisjen e procedurës së njësimi të praktikës gjyqësore. Në referim të nenit 62/a(2) të ligjit nr. 49/2012 “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar), vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Administrativ për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, përcakton edhe çështjet e shtruara për njësim...”.*



11.5.2023<sup>196</sup>, ka vendosur të kalojë për njësim çështjen lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme pasive dhe llojin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në rast të konstatimit të parregullsisë në ndërtimin e ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme, tregon se interpretimi i bërë nga subjekti në vendimet objekt shqyrtimi nuk mund të vlerësohet nga institucionet e rivlerësimit në kuadër të aftësive gjyqësore të tij. Kjo për shkak se vlerësimi i aftësive gjyqësore të subjektit duhet të realizohet pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e gjyqtarit, në përputhje me pikën 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ndodhet në kushtet e pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016, është i drejtë.

**54.10 Në përfundim**, Komisioni vlerëson se ky vendim i marrë nga subjekti nuk përfshihet në një nga kategoritë e shkeljeve, sipas nenit 72 të ligjit nr. 96/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk konstatohen problematika të cilat lidhen me procesin e rivlerësimit, sipas kërkesave të ligjit nr. 84/2016.

**54.11 Në lidhje me denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 23.9.2020 dhe nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2020** të shtetasit A. D.<sup>197</sup>, i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për zhvillimin e procesit gjyqësor pa avokat mbrojtës, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit të rivlerësimit për konstatimin se: *Subjekti në vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2020 nuk ka arsyetuar pse në rastin konkret ka zbatuar legjislacionin e përgjithshëm dhe jo ligjet specifike që rregullojnë fushën e legalizimit të objekteve pa leje dhe të inspektimit të ndërtimit për zgjidhjen e çështjes.*

**54.12** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>198</sup>, subjekti i rivlerësimit shpjegon se ka arritur në këtë konkluzion, pasqyruar në vendim, pasi organi publik në vendimmarrjen e tij nuk i është referuar ligjit nr. 9482/2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, por është bazuar në ligjin nr. 9780, datë 6.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, ligjin nr. 107/2014, “Për planifikimin e territorit” dhe VKM-në Nr. 894, datë 4.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit” dhe, për pasojë, gjykata verifikon bazueshmërinë në ligj të aktit administrativ, bazuar në referencën ligjore që bën vetë organi administrativ. Po kështu, vijon subjekti, gjatë gjykimit pala e paditur nuk ka paraqitur prova apo prapësime lidhur me mosmarrëveshjen objekt gjykimi dhe, për pasojë, vendimi i saj është bazuar në nenin 26 të ligjit nr. 49/2012.

**54.13** Gjithashtu, shpjegon se ankesa e shtetasit A. D. është trajtuar nga ILD-ja, e cila, me vendimin nr. \*\*\* prot., datë 29.6.2020, ka vendosur arkivimin e ankesës, pasi nuk janë gjetur shkelje procedurale.

**54.14** Nga hetimi administrativ rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja me palë: paditës J. N., Q. N., L. N.; i paditur \*\*\*, me objekt “Paligjshmëria e vendimit të për prishje objekti dhe vendimit për dënimin me gjobë”. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se shtetasi Kito Nakuci ka ndërtuar një objekt shtëpi banimi në

---

<sup>196</sup> Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë është shprehur: “Referuar fakteve të mësipërme dhe shkaqeve të rekursit të paraqitur kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Kolegji konstaton se në çështje të ngjashme me atë objekt gjykimi, ka pasur qëndrime të ndryshme të trupave të Kolegjit Administrativ lidhur me ndërgjyqësinë e detyrueshme pasive dhe llojin e vendimmarrjes së Gjykatës së Lartë në rast të konstatimit të parregullsisë në ndërtimin e ndërgjyqësisë pasive të detyrueshme. Në këtë kontekst, Kolegji çmon të nevojshme nisjen e procedurës së njësimi të praktikës gjyqësore. Në referim të nenit 62/a(2) të ligjit nr. 49/2012, “Për Gjykatat Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative” (i ndryshuar), vendimi i ndërmjetëm i Kolegjit Administrativ për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, përcakton edhe çështjet e shtruara për njësim...”.

<sup>197</sup> Bashkëlidhur ka paraqitur kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 13.7.2020, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe dokumentacionin përkatës.

<sup>198</sup> Email datë 16.5.2023.

Njësinë Administrative Nr. \*\*\*. Në zbatim të ligjit nr. 9304/2004, “Për legalizimin dhe urbanizimin e banesave informale”, ka dorëzuar aktin e vetëdeklarimit për ndërtim pa leje. Ky shtetas ka ndërruar jetë dhe dëshmia e trashëgimisë është depozituar në Drejtorinë e ALUIZN-it, Tirana Veri. Pas depozitimit të dokumentacionit, kërkuesit kanë qenë në pritje të miratimit të lejes së legalizimit dhe pajisjen me dokumentin e pronësisë, por në datën 27.2.2020 janë vënë në dijeni nga inspektori i IMT Bashkia Tiranë për urdhrin nr. \*\*\*, datë 4.10.2019, të ASHK-së për mospërfshirjen në proces legalizimi të objektit dhe për vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2020, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 6.2.2020, “Për dënimin me gjobë” në masën 500.000 lekë. Pas marrjes dijeni të këtyre vendimeve, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas objektit të pasqyruar më sipër. Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2020, ka vendosur pranimin e padisë, shfuqizimin e vendimeve të IMT-së për dënimin me gjobë dhe për prishje objekti.

**54.15** Në përfundim, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara kanë lidhje me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe me logjikën e subjektit, të cilat sipas pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2017 nuk janë kompetencë e organeve të rivlerësimit. Në të njëjtin konkluzion ka dalë ILD-ja, i cili ka vendosur arkivimin e çështjes, pasi pretendimet e ankuesit kanë të bëjnë me zgjidhjen në themel të çështjes.

**54.16 Në lidhje me denoncimet nr. \*\*\* prot., datë 7.10.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 8.10.2022**, të shtetasit H. Th., i cili denoncon subjektin për kryerjen e shkeljeve të rënda kushtetuese dhe ligjore në dhënien e vendimit nr. \*\*\*, datë 21.10.2021, si dhe në vendimin nr. \*\*\*, datë 19.9.2018, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Subjekti ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2021, për mospranimin e padisë së palës paditëse duke mos analizuar situatën faktike të çështjes në gjykim, ligjin për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, ligjin e posaçëm të sigurimeve shoqërore dhe jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, në përcaktimin e juridiksionit për shqyrtimin e çështjes.*

**54.17** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>199</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se gjatë gjykimit nuk është parashtruar kërkimi për shfuqizim apo pavlefshmërinë e vendimit nr. \*\*\*, datë 15.6.2021, të Komisionit Rajonal të Ankimit. Për pasojë, pretendimet për pavlefshmëri të këtyre akteve në përmbajtje të shpjegimeve janë konsideruar si tej objektit të kërkesëpadisë dhe nuk mund të shqyrtohen nga ana e Gjykatës. Lidhur me mosrespektimin e praktikës së Gjykatës së Lartë sqaron se kjo praktikë ka qenë e paqëndrueshme, duke pasur parasysh se me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.1.2018, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, po në rastin e z. H. Th.<sup>200</sup>. Më pas shpjegon se në rastin konkret, pavarësisht se ligji nuk parashikon një detyrim specifik, pala paditëse i është drejtuar vullnetarisht organit publik duke lejuar palën e paditur të disponojë me një akt administrativ dhe, në këto kushte, pala paditëse për të rivendosur në vend të drejtën e tij mund t’i drejtohej gjykatës vetëm duke kundërshtuar këtë akt administrativ sipas parashikimeve të legjislacionit të posaçëm, i cili ka parashikuar procedurën dhe hallkat përkatëse, që paditësi nuk i ka ndjekur.

<sup>199</sup> Email datë 16.5.2023.

<sup>200</sup> “Ky Kolegj thekson se neni 86 i ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, ka përcaktuar rrugën që duhet të ndiqet ndaj ankimit administrativ, por kur jemi përpara rastit, kur pala e paditur DRSSH është shprehur me vendim themeli ndaj kërkesave të subjektit të interesuar. Pra, që të ndiqet rruga e ankimit administrativ duhet që pala e paditur në funksion të veprimtarisë së tij si organ publik duhet të shprehet me vendim përfundimtar, duke i pranuar apo jo kërkesat e palës paditëse.

**54.18** Gjithashtu, subjekti shpjegon se gjatë gjykimit ka kërkuar heqjen dorë nga gjykimi i çështjes në tri raste, kërkesa të cilat nuk janë pranuar nga ana e Kryetarit të Gjykatës<sup>201</sup>. Më pas, shpjegon se paditësi ka paraqitur ankesë në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë dhe në të gjitha institucionet e Republikës së Shqipërisë. ILD-ja ka marrë në shqyrtim këto pretendime dhe me vendimet e datave 21.1.2022 dhe 8.4.2022 ka vendosur arkivimin e ankesave. Kundër këtyre vendimeve denoncuesi ka paraqitur ankim dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. \*\*\*, datë 20.4.2022, ka vendosur refuzimin e ankimit.

**54.19** Nga hetimi administrativ<sup>202</sup> rezulton se denoncuesi, në cilësinë e palës paditëse, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me kërkesëpadinë me objekt “Detyrimi i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore të ndryshojë aktet administrative (vendimet) të saj për caktimin e pensionit të pleqërisë etj.”. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se paditësi, pasi ka mbushur moshën në datën 4.5.2016, i është drejtuar DRSSH-së Tiranë me kërkesë për pension pleqërie, duke dorëzuar librezën e punës të lëshuar nga Komanda e Forcave Tokësore, ku janë pasqyruar periudhat e shërbimit nga viti 1969 deri në vitin 2005. Dega e Përfitimeve pranë DRSSH-së Tiranë, pasi ka shqyrtuar dokumentacionin e ndodhur në dosje, ka bërë lidhjen e pensionit të pleqërisë, duke i caktuar pension pleqërie me vjetërsi totale 42 vite e 2 muaj, me masë fillestare 29.597 lekë. Në vijim, paditësi ka kërkuar disa herë rishikimin e pensionit, pasi nuk ishte dakord me masën e tij. Bazuar në kërkesat e paditësit, DRSSH-ja Tiranë ka ndryshuar disa herë koeficientët e zhvillimit të pagës, duke ndryshuar edhe masën e pensionit të paditësit. Paditësi, duke mos qenë dakord me qëndrimin e Degës së Përfitimeve, i është drejtuar me kërkesë Komisionit Qendror të Ankimit, i cili me shkresën e datës 12.4.2021 e ka sqaruar paditësin se pa marrë një përgjigje nga Komisioni Rajonal i Ankimit nuk mund t’i shqyrtohet dosja. Me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2021, Komisioni Rajonal i Ankimit ka vendosur rrëzimin e kërkesës së paditësit dhe lënien në fuqi të përgjigjes së dhënë nga Dega e Përfitimeve. Paditësi nuk e ka kundërshtuar këtë vendim në Komisionin Qendror të Apelimit, por në datën 24.5.2021 i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti i rivlerësimit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.10.2021, ka vendosur mospranimin e padisë me arsyetimin se në rastin konkret pala paditëse nuk ka ndjekur rrugën administrative në mënyrën e parashikuar nga ligji.

**54.20** Në përfundim, Komisioni vlerëson se problematikat e konstatuara kanë lidhje me korrektësinë e vendimit dhe themelin e çështjes, si dhe me logjikën e subjektit, gjë e cila sipas pikës 4 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2017 nuk është kompetencë e organeve të rivlerësimit. Në të njëjtin konkluzion kanë dalë ILD-ja dhe KLGJ-ja, të cilat kanë vendosur arkivimin e çështjes.

**54.21 Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 14.8.2018, të shtetasit P. Q.,** i cili akuzon subjektin e rivlerësimit për dhënien e një vendimi të pabazuar në prova dhe fakte, Komisioni i kërkoj subjektit të rivlerësimit shpjegime lidhur me interpretimin e nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>203</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se akti normativ nr. 3, datë 1.3.2012, “Për lirimin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”, i miratuar me ligjin nr. 82/2012, datë

<sup>201</sup> Bashkëlidhur tri kërkesat për përjashtim dhe vendimi nr. \*\*\*, datë 19.10.2021.

<sup>202</sup> Komisioni administroi nga sistemi elektronik *gjykata.gov.al* kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 21.10.2021, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>203</sup> Email datë 16.5.2023

13.9.2012, përbën titull ekzekutiv. Për pasojë, akti “Njoftim konfirmimi, titulli ekzekutiv”, i Entit Kombëtar të Banesave nuk mund të konsiderohet më akt administrativ për sa kohë është kthyer në titull ekzekutiv. Nga momenti që akti administrativ është kthyer në titull ekzekutiv ai mund të kundërshtohet gjyqësisht vetëm sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile. Në këtë këndvështrim, vijon subjekti i rivlerësimit, padia duhej rrëzuar, si një padi e cila nuk mund të ngrihej për mbrojtjen apo rivendosjen e të drejtave të ligjshme, të pretenduara nga paditësit.

**54.22** Nga hetimi administrativ<sup>204</sup> rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja administrative me palë: paditës P. Q. dhe A. Q.; të paditur Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së, N. N.; person i tretë Zyra Përmbartimore Private “\*\*\*\*”, me objekt “Shfuqizimi i aktit administrativ nr. \*\*\*, datë 16.1.2017, “Njoftim konfirmim titulli ekzekutiv” të EKB-së, etj.”. Në gjykim është vërtetuar se pala e paditur N. Nj., bazuar në vendimin nr. \*\*\*, datë 29. 9.1995, të ish-KKP Tiranë, është bashkëpronar i apartamenti me sip. 60.79 m<sup>2</sup>, në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë. Kjo pronë ka qenë në posedim të paditësve, të cilët kanë kundërshtuar në gjykatë vendimin nr. \*\*\*, datë 29.9.1995, të ish-KKP Tiranë. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 17.12.2012, ka vendosur “Rrëzimin e kërkesëpadisë”, ndërsa Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.11.2014, ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së rrethit dhe kthimin për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë, i padituri N. Nj. dhe bashkëpronarët e tjerë kanë paraqitur rekurs përpara Gjykatës së Lartë<sup>205</sup>. Ndërkohë Drejtoria e Përgjithshme e EKB-së ka urdhëruar lëshimin e titullit ekzekutiv për lirimin e menjëhershëm të pronës nga paditësi në favor të bashkëpronarëve Nj., e cila është pasuar me lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë. Më pas, shoqëria përmbartimore “\*\*\*\*” i është drejtuar familjes së paditësit me shkresë, duke e vënë në dijeni se brenda 10 ditësh duhet të lirojë dhe dorëzojë banesën që ka në posedim e, më pas, shoqëria përmbartimore ka vendosur kalimin në “ekzekutim të detyrueshëm”. Kundër aktit të EKB-së paditësi ka paraqitur padi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë sipas objektit të pasqyruar më sipër.

**54.23** Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2017, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se pala e paditur, EKB, ka iniciuar procedurat në përputhje me ligjin dhe se kërkesëpadia është e pambështetur nga pikëpamja procedurale, pasi njoftimi i EKB-së përbën titull ekzekutiv sipas aktit normativ nr. \*\*\*, datë 1.3.2012 dhe e vetmja rrugë procedurale e palës paditëse për mbrojtjen e të drejtave subjektive është ngritja e padisë për pavlefshmërinë e titullit ekzekutiv, kjo mbështetur në paragrafin e parë të nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile.

**54.24** Gjykata e Lartë<sup>206</sup> në praktikën e saj ka arsyetuar se në rastin kur titulli ekzekutiv është një akt administrativ duhet të mbahen parasysht veçantitë që burojnë nga natyra administrative e aktit, mënyra dhe procedura e nxjerrjes dhe kundërshtimit të aktit administrativ. Nëse akti administrativ që përbën titull ekzekutiv apo aktet administrative që i paraprijnë titullit ekzekutiv janë formësuar, shqyrtuar dhe konfirmuar rregullisht, titulli ekzekutiv mund të

<sup>204</sup>Komisioni administroi nga sistemi elektronik *gjykata.gov.al* kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 21.7.2017, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>205</sup> Nga verifikimi në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë me vendimin nr. \*\*\*, datë 27.1.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit.

<sup>206</sup> Vendimet nr. \*\*\*, datë 16.2.2012; nr. \*\*\*, datë 6.7.2012; nr. \*\*\*, datë 5.3.2013; nr. \*\*\*, datë 17.10.2013 etj. të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

kundërshtohet sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile vetëm për pavlefshmëri absolute të aktit, për mungesë apo pavlefshmëri të njoftimit të aktit subjektiv debitor, për parashkrim të detyrimit, për identifikim të gabuar të subjektiv debitor, për identifikim të gabuar të sendeve që i nënshtrohen ekzekutimit..., si edhe për rastet kur masa e detyrimit (debisë) të caktuar në aktin administrativ që ekzekutohet më pas është pakësuar ose shuar si pasojë e disponimeve përkatëse mbi atë detyrim që përmbahen në akte e vendime të tjera administrative apo gjyqësore.

**54.25** Në vijim, ka vlerësuar që titulli ekzekutiv nuk mund të kundërshtohet sipas nenit 609 të Kodit të Procedurës Civile për fakte e rrethana të ngjara në kohën e dhënies së aktit administrativ, por vetëm për rrethana që kanë ndodhur pas nxjerrjes së aktit, me përjashtim të rastit kur kërkohet pavlefshmëria absolute. Nëse në gjykim kërkohet pavlefshmëria e titullit ekzekutiv, ky kërkim nuk mund të ngrihet mbi pretendime të bazuara në motive që i përkasin pavlefshmërisë relative të aktit administrativ, sikurse janë ato që lidhen me kundërshtime mbi dobishmërinë apo ligjshmërinë (formën dhe themelin) e aktit administrativ që ekzekutohet (akti origjinal i detyrimit). Në rastin konkret, pala paditëse ka pretenduar se akti “Njoftim Konfirmim Titulli-Ekzekutiv” i EKB-së është një akt administrativ i paligjshëm, duke ngritur pretendime për pavlefshmërinë relative të aktit administrativ, sikurse janë ato që lidhen me ligjshmërinë e tij. Për pasojë, arsyetimi i subjektivit nuk mbështetet në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë.

**54.26** Në përfundim të analizimit të pretendimeve të denoncuesit, shpjegimeve të subjektivit në raport me jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, subjekti i rivlerësimit nuk ka interpretuar nenin 609 të Kodit të Procedurës Civile sipas praktikës së Gjykatës së Lartë. Kjo pasaktësi e subjektivit gjendet në kushtet e pikës 2 të nenit 72 të ligjit nr. 84/2016.

**54.27 Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 18.6.2018, të shtetasit J. J.,** i cili akuzon subjektivin e rivlerësimit se për dhënien e një vendimi të padrejtë, Komisioni i kërkoi subjektivit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Vendimi i subjektivit për kthimin e padisë me të meta për shkak se nuk janë paguar shpenzimet për kryerjen e aktit të ekspertimit nuk mbështetet në nenin 105 të Kodi të Procedurës Civile, duke sjellë si pasojë zvarritje të gjykimit.*

**54.28** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>207</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se gjatë hetimit gjyqësor në lidhje me pasurinë e palës paditëse rezultoi dy planvendosje, të cilat kanë pasqyruar pronën në mënyra të ndryshme dhe me sipërfaqe të ndryshme dhe për të zgjidhur mosmarrëveshjen ka qenë e domosdoshme kryerja e një akti ekspertimi topografik. Pala paditëse, vijon subjekti, ka pretenduar se nuk ka arsye për të kryer një akt ekspertimi duke qenë se në gjykimin e mëparshëm është kryer një i tillë, i cili duhet të vlerësohet nga ana e gjykatës. Duke qenë se gjykimi nuk mund të bazohet në akte provuese të krijuara në gjykime të mëparshme, ka disponuar me vendim të ndërmjetëm për kryerjen e një akti ekspertimi të ri duke i përcaktuar detyrat ekspertit dhe detyrimi për të përballuar shpenzimet gjatë gjykimit i takon palës paditëse. Përderisa paditësi ka refuzuar t’i japë mundësi gjykatës që të ballafaqohet mendimin e ekspertit me provat e tjera të paraqitura nga paditësi, ka vlerësuar se padia është e paplotë dhe në kuptim të nenit 154/a, paragrafi i fundit e ka kthyer padinë me gjithë aktet e tjera.

---

<sup>207</sup> Email datë 16.5.2023.

**54.29** Nga hetimi administrativ<sup>208</sup> rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja administrative me palë: paditës J. J.; i paditur ZVRPP Tiranë; person i tretë ZQRPP, P. K., R. K. etj., me objekt “Detyrimi i ZVRPP-së Tiranë të pajisë paditësin me certifikatë pronësie”. Nga hetimi gjyqësor është vërtetuar se sipas kontratës së shitjes nr. \*\*\*, datë 16. 6.1995, paditësi ka blerë nga shtetasi R. K. truallin me sip. 266 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë. Për këtë pronë paditësi është pajisur nga ZVRPP-ja Tiranë me certifikatën e pasurisë së datës 20.12.2011, në të cilën është shënuar sipërfaqja 154 m<sup>2</sup>. Duke mos qenë dakord me të dhënat e pasqyruara në certifikatën e pronësisë, paditësi ka paraqitur kërkesën pranë ZVRPP-së Tiranë dhe ZQRPP-së për të bërë korrigjimet përkatëse. Në kushtet kur këto institucione nuk i kanë dhënë zgjidhje pretendimeve të tij, paditësi i është drejtuar me padi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**54.30** Fillimisht, çështja është marrë në shqyrtim nga gjyqtari A. S., i cili është përjashtuar nga gjykimi e, më pas, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit. Gjatë gjykimit nga gjyqtari A. S. është realizuar një akt ekspertimi që u kërkua të vlerësohet si i tillë edhe në gjykimin e rifilluar pas përjashtimit të tij. Subjekti i rivlerësimit ka çmuar se nuk mund të vlerësojë aktin e ekspertimit të realizuar në gjykimin e mëparshëm, duke qenë se rifillimi i gjykimit anulon të gjitha veprimet procedurale dhe ka disponuar me vendim për kryerjen e një akti ekspertimi, duke i parashtruar ekspertit detyrat përkatëse. Në kushtet kur nuk ishte paguar akti i ekspertimit, subjekti i rivlerësimit, duke çmuar se akti i ekspertimit përbën një provë të rëndësishme për provueshmërinë e fakteve dhe duke e konsideruar të metë, ka vendosur kthimin e akteve. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.4.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe kthimin e çështjes për vazhdimin e gjykimit<sup>209</sup>.

**54.31** Nga analizimi i vendimit të subjektit në raport me ligjin e zbatueshëm, subjekti nuk mund të vendoste kthimin e padisë me të meta se nuk janë paguar shpenzimet për kryerjen e aktit të ekspertimit, por në bazë të nenit 105/2 të Kodit të Procedurës Civile mund të vazhdonte gjykimin duke marrë vendim për nxjerrjen e detyrueshme të këtij shpenzimi. Sipas nenit 105/1 të Kodit të Procedurës Civile, subjekti mund të urdhëronte që shpenzimet për pagimin e vlerës së aktit të dytë të parapaguheshin nga palët e treta etj., të cilët kishin kërkuar kryerjen e një akti të ri ekspertimi sipas pretendimit të tyre.

**54.32** Në këto kushte, Komisioni vlerëson se vendimi i subjektit për kthimin e padisë me të meta për shkak se nuk janë paguar shpenzimet për kryerjen e aktit të ekspertimit nuk mbështetet në nenin 105 të Kodi të Procedurës Civile, duke u gjendur në kushtet e pikës 2 të nenit 72 të ligjit nr. 84/2016.

**54.33** Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2020, të shtetasit F. H., i cili akuzon subjektin e rivlerësimit se ka marrë vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2015, në shkelje flagrante të Kodit Civil, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: *Subjekti nuk ka arsyetuar në mënyrë të qartë lidhur me mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë, pasi ka vijuar gjykimin në themel të çështjes duke mos vlerësuar faktin që ndërgjyqësia e rregullt është një ndër parakushtet procedurale për vlefshmërinë e procesit gjyqësor civil dhe administrativ dhe sjell si pasojë pushimin e gjykimit.*

<sup>208</sup>Komisioni administroi nga sistemi elektronik [gjykata.gov.al](http://gjykata.gov.al) kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 9.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

<sup>209</sup> Nga verifikimi në faqen elektronike të Gjykatës së Lartë nuk rezulton që kjo çështje të jetë për gjykim në këtë gjykatë.

**54.34** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>210</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se duke qenë se pala e cenuar ka qenë e thirrur në cilësinë e personit të tretë Gjykata nuk mund të procedonte me vendim për pushim të gjyqimit dhe neni 161 i Kodit të Procedurës Civile nuk parashikohet si mundësi disponimi e gjykatës pushimi i gjyqimit. Kjo dispozitë është ndryshuar në vitin 2017, duke parashikuar detyrimin e gjykatës për të vendosur pushimin e gjyqimit.

**54.35** Nga shqyrtimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 5.10.2015<sup>211</sup>, rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja administrative me palë: paditës F. H.; i paditur Drejtoria e ALUIZNI-t, Tiranë; person i tretë S. D., me objekt “Pezullimi i procedurave për legalizimin e një ndërtimi pa leje nga ana e personit të tretë deri në zgjidhjen e mosmarrëveshjes për raportet e pronësisë (për pushimin e cenimit të pronësisë)”. Nga hetimi gjyqësor ka rezultuar se paditësi është pronar i një shtëpie për të cilën është pajisur nga ZVRPP-ja me certifikatë pronësie të lëshuar në datën 14.11.2014. Paditësi ka pretenduar se prona e tij kufizohet me shtëpinë e personit të tretë, me të cilën prej kohësh janë në konflikt duke paraqitur vërtetimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që vërteton zhvillimin e gjyqimit me objekt pushimin e cenimit të pronësisë. Gjithashtu është provuar se paditësi i është drejtuar palës së paditur me kërkesë për pezullimin e procedurës së legalizimit derisa konflikti të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Pala e paditur i ka kthyer përgjigje se konflikti midis tij dhe familjes D. nuk është për raportet e pronësisë në objektin informal. Në këto kushte, paditësi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me kërkesëpadinë objekt gjykimi.

**54.36** Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 5.10.2015, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë, duke arsyetuar se në rastin konkret nuk gjenden në kushtet e nenit 26 të ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” i ndryshuar, pasi konflikti nuk ka të bëjë me raportet e pronësisë në objekt dhe as nuk përfshin persona që pretendojnë të drejta pronësie mbi parcelën ndërtimore.

**54.37** Në përfundim të analizimit të denoncimit, shpjegimeve të subjektit dhe ligjin e zbatueshëm, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka arsyetuar në mënyrë të qartë lidhur me mosformimin e rregullt të ndërgjyqësisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 72 të ligjit nr. 96/2016.

**54.38** Në lidhje me denoncimin nr. \*\*\* prot., datë 4.2.2020, të shtetasve A. Rr. etj., të cilët akuzojnë subjektin e rivlerësimit për shkelje të rënda procedurale dhe për hetim të njëanshëm në marrjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 21.6.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit shpjegime për konstatimin se: (i) *Vendimi i subjektit për mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë nuk është i mbështetur në nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile, në ligjin nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë pasi: a. nuk ka vlerësuar nëse kërkimi i kundërpadisë ka lidhje me atë të padisë ose midis tyre mund të bëhet kompensim; b. ligji nr. 33/2012, të drejtën e ankimit administrativ ndaj vendimeve të regjistruarit e ka lënë në zgjedhjen e palës ankuese dhe nuk shprehet për detyrimin e kësaj pale të ndjekë më parë rrugën e ankimit administrativ.* (ii) *Subjekti nuk ka vlerësuar formimin e*

<sup>210</sup> Email datë 16.5.2023.

<sup>211</sup> Të administruar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.9.2020, të KLGJ-së.

*rregullt të ndërgjyqësisë pasi në gjykim, në cilësinë e palës së paditur, nuk janë thirrur të gjithë bashkëpronarët (9 gjithsej).*

**54.39** Në përgjigje të rezultateve të hetimit<sup>212</sup> subjekti i rivlerësimit shpjegon se për sa i përket mospranimit për shqyrtim të kundërpadisë, praktika e Gjykatës së Lartë dhe e Kolegjit Administrativ ka qenë e tillë që ka konsideruar kusht të domosdoshëm ezaurimin e rrugës administrative dhe, për pasojë, në këto kushte është vendosur rrëzimi i kërkesës për shqyrtimin e kundërpadisë. Kjo vendimmarrje nuk i mohon palës të drejtën t’i drejtohet gjykatës, pasi të ketë ezauruar rrugën administrative. Në lidhje me ndërgjyqësinë shpjegon se i është referuar kartelës së pasurisë të paraqitur në gjykim nga pala paditëse dhe në gjykim janë thirrur të gjithë bashkëpronarët që kanë rezultuar të pasqyruar në kartelë dhe ka qenë në padijeni të personave të tjerë bashkëpronarë sipas pretendimeve të denoncuesit. Në vijim, shpjegon se palët e paditura nuk kanë paraqitur në gjykim pretendime për persona të tjerë bashkëpronarë.

**54.40** Nga hetimi administrativ<sup>213</sup> rezulton se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është gjykuar çështja administrative me palë: paditës R. Rr.; i paditur ZVRPP Krujë; person i tretë A. Rr., Xh. L. etj., me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ të regjistrimit etj. Paditësi R. Rr. është pajisur me certifikatë pronësie për pasurinë me sip. 3072 m<sup>2</sup>, për të cilën është lëshuar certifikata e pronësisë në datën 10.2.2010. ZVRPP Krujë ka regjistruar në datën 25.11.1998, mbi skajin juglindor të pasurisë së paditësit, pasurinë e llojit truall, me sipërfaqe 200 m<sup>2</sup>, nga e cila 50 m<sup>2</sup> ndërtesë, në emër të trashëgimtarëve të shtetasit A. Rr. (personave të tretë), të cilët janë pajisur me certifikatën e pronësisë në datën 15.2.2017. Pas aplikimit në ZVRPP-në Krujë, pala paditëse është informuar lidhur me mbivendosjen mes pasurisë së tij dhe pasurisë së personave të tretë. Me shkresën e datës 12.12.2017, ZVRPP Krujë ka orientuar palët e interesuara të ndjekin procedurën ligjore për zgjidhjen e problematikave të pretenduara. Në vijim, pala paditëse i është drejtuar me kërkesëpadinë objekt gjykimi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti, me vendimin nr. \*\*\*, datë 26.6.2019, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, konstatimin e paligjshmërisë së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në pronësi të personave të tretë, detyrimin e Drejtorisë Vendore të ASHK Krujë të fshijë regjistrimin e pasurisë në emër të personave të tretë, si dhe të kryejë korrigjimin në sistemin e pasurive të paluajtshme.

**54.41** Lidhur me mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë, Komisioni çmon se subjekti nuk ka dhënë shpjegime të mjaftueshme pasi Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin nr. 1, datë 16.11.2010, kanë arritur në përfundimin unifikues: *“Ndjekja e rrugës administrative (të apelimit administrativ) për zgjidhjen e mosmarrëveshjes administrative përpara se subjekti t’i drejtohet gjykatës, është e detyrueshme vetëm nëse ligji që rregullon marrëdhëniet juridike dhe veprimtarinë administrative të fushës përkatëse parashikon shprehimisht se ndaj aktit administrativ mund të ushtrohet ankim administrativ, si dhe tregon organin apo organet konkrete administrative tek të cilët eventualisht, sipas hierarkisë, duhet të drejtohet apelimi administrativ”*.

**54.42** Në kuptim të vendimit unifikues, referuar rastit konkret, detyrueshmëria e ankimit administrativ përcaktohet nga ligji i posaçëm i regjistrimit të pasurive të paluajtshme nr. \*\*\*/2012 dhe jo nga dispozitat e përgjithshme procedurale të përcaktuara në ligjin nr. 49/2012.

<sup>212</sup> Email datë 16.5.2023.

<sup>213</sup> Komisioni administroi nga sistemi elektronik *gjykata.gov.al* kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 26.6.2019, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.



Gjykata e Lartë<sup>214</sup> në praktikën e saj ka bërë interpretimin e dispozitave të ligjit nr. 33/2012, duke arritur në konkluzionin se në asnjë dispozitë të këtij ligji nuk parashikohet detyrueshmëria e ankimit administrativ përpara se pala e interesuar t'i drejtohet gjykatës me padi për kundërshtimin e akteve, veprimeve apo mosveprimeve të ZQRPP-së dhe ZVRPP-ve.

**54.43** Në përfundim të analizimit të pretendimeve të denoncuesit, shpjegimeve të subjektit në raport me jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, Komisioni arrin në përfundimin se vendimi i subjektit për mospranimin për shqyrtim të kundërpadisë nuk është i mbështetur në nenin 160 të Kodit të Procedurës Civile, në ligjin nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme” dhe në jurisprudencën e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke u gjendur në kushtet e pikës 2 të nenit 72 të ligjit nr. 84/2016.

**54.44** Pas seancës gjyqësore të datës 23.5.2023, pranë Komisionit u paraqit denoncimi nr. \*\*\* prot., datë 23.5.2023, i shtetasit E. B.. Denoncuesi nuk i ka bashkëlidhur ankimit vendimin gjyqësor. Si pasojë, Komisioni vlerësoi se nuk ka të dhëna për hetime të mëtejshme, sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

**54.45** Gjatë seancës dëgjimore para trupit gjykues, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit lidhur me denoncimet deklaroi se: “ [...] se ngarkesa ime në punë ka qenë ngarkesë e konsiderueshme sikurse ju kam vënë në dispozicion çështjet për çdo vit dhe jo vetëm e imja, por e çdo kolegu dhe këtë ua kam bërë të ditur duke pasur parasysh numrin e ankesave që për mua është një numër që nuk do ta kisha menduar kurrë, por duke pasur parasysh numrin e çështjeve që unë kam zgjidhur, unë me veten time bëj një analizë të faktit që sigurisht kur në 80% të çështjeve që unë zgjidh me përafërsi 80% janë rrëzime kërkesëpadie sigurisht që dhe po themi qëndrimi i qytetarëve mund të jetë i tillë që sikurse ai që kanë parashtruar edhe në ankesat ndaj meje, me këtë nuk dua të justifikoj asnjë lloj vendimmarrje timen, vendimmarrjet e mia janë bazuar në dispozitat ligjore materiale dhe procedurale, të cilat unë ua kam parashtruar, në shpjegimet e mia unë besoj që kam qenë shteruese, kam arsyetuar dhe në ligjin procedural dhe material dhe ju siguroj se në asnjë rast nuk ka pasur dashakeqësi apo pakujdesi apo neglizhencë nga ana ime në trajtimin e një çështjeje të qytetarëve përpara meje. [...]”.

**54.46** Në vlerësimin tërësor të kriterit profesional, Komisioni, bazuar në arsyetimin për çdo pasaktësi më vete, duke u bazuar në gjetjet e Komisionit, shpjegimet e subjektit me shkrim dhe në seancë dëgjimore, si dhe në ligjin e zbatueshëm, arsyeton se:

**54.47** Gjykata Kushtetuese, në vendimin e saj nr. 2, datë 18.1.2017, në pikën 54, ndër të tjera, shprehet se: “[...] Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, Gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL-AD (2016)036 të Komisionit të Venecias) [...]”.

**54.48** Në analizë të 8 denoncimeve nga publiku dhe shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit në raport me ligjin e zbatueshëm për vlerësimin e aftësive profesionale, Komisioni arrin në

<sup>214</sup> Vendimet: nr. \*\*\*, datë 8.1.2013; nr. \*\*\*, datë 19.3.2013; nr. \*\*\*, datë 25.4.2013; nr. \*\*\*, datë 2.5.2013; nr. \*\*\*, datë 17.9.2015 të Kolegjit Civil; vendimi nr. \*\*\*, datë 23.11.2017, i Kolegjit Administrativ etj.

përfundimin se pasaktësitë në drejtim të arsytimit dhe njohurive ligjore për 5 çështjet e trajtuara më lart qëndrojnë, duke u ndodhur në kushtet e pikave 2 dhe 3 të nenit 72 të ligjit nr. 84/2016, por referuar shpjegimeve të subjektit, si dhe vendimit nr. 2, datë 18.1.2017, të Gjykatës Kushtetuese, ato nuk mund të përbëjnë shkak për vlerësimin negativ, për aq kohë sa nuk janë gabime thelbësore dhe serioze, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e subjektit si të paaftë profesionalisht.

**55.** Trupi gjykues, bazuar në jurisprudencën e Gjykatës së Kushtetuese, si dhe duke marrë në konsideratë: (i) numrin e çështjeve të analizuara ku janë konstatuar mangësi në aspektin e aftësive profesionale në raport me çështjet e ndjekura nga subjekti i rivlerësimit për periudhën e rivlerësimi 8.10.2013 – 8.10.2016 (1562 çështje); (ii) mangësitë e konstatuara si më lart nuk janë të një niveli të tillë që të konsiderohen gabime thelbësore dhe serioze dhe as të përsëritura në mënyrë të vazhdueshme, që të përfaqësojnë defekte të rëndësishme për njohuritë profesionale; (iii) nuk rezulton që veprimet e subjektit të rivlerësimit mund të kenë qenë të qëllimshme – vlerëson se pasaktësitë e pasqyruara në kriterin e rivlerësimit të aftësive profesionale nuk plotësojnë kushtin e parashikuar nga pika 4 e nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, që subjekti i rivlerësimit të konsiderohet “i papërshtatshëm”, si dhe atë të pikës 5 të nenit 61 të po të të njëjtit ligj, që të jenë të tilla sa të cenojnë të vetme besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë.

**56. Pra, në përfundim të analizimit të kontrollit të aftësive profesionale, subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues sipas kërkesave të shkronjës “c” të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.**

**57. Në përfundim,** trupi gjykues i Komisionit, në vlerësimin tërësor të kriterit të rivlerësimit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli është “e aftë”, pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

## **KONKLuzion Përfundimtar**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në provat që disponon për vlerësimin e pasurisë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në bindjen e brendshme, vendosi që subjekti i rivlerësimit Elvana Çiçolli, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të konfirmohet në detyrë.

## **Për këto arsye,**

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, shkronjën “a” të pikës 1 të nenit 58 dhe pikën 1 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Elvana Çiçolli, gjyqtare pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.  
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 25.5.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Alma FASKAJ**  
**Kryesuese**

**Etleda ÇIFTJA**  
**Relatore**

**Suela ZHEGU**  
**Anëtare**

*Sekretare gjyqësore*  
*Resilda Bilaj*